



FAQE 2

Monitorimi i zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW) në Kosovë

Botues: Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Drejtores e hulumtimit: Luljeta Vuniqi

Udhëheqëse e hulumtimit: Luljeta Demolli

Asistente e hulumtimit: Erëmirë Krasniqi


Redaktimi Teknik, Dizajni dhe Shtypi: Delja e Zezë (DZG | info@dzgonline.com)

© 2008 Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Të gjitha të drejtat e rezervuara

[www.kgscenter.org](http://www.kgscenter.org)

Ky hulumtim është financuar nga: Fondi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM) <http://www.unifem.org/> <http://www.unifem.org/>



PËRMBAJTJA

---

4	Mirënjohje
5	Metodologjia
6	Akronimet dhe Shkurtesat
7	Përmbledhja e konkluzioneve kryesore
10	Hyrja
15	Neni 1
19	Neni 2
29	Neni 3
30	Neni 4
31	Neni 5
33	Neni 6
40	Neni 7
47	Neni 8
47	Neni 9
50	Neni 10
55	Neni 11
71	Neni 12
77	Neni 13
80	Neni 14
83	Neni 15
85	Neni 16
95	Rekomandimet
103	Lista e të intervistuarve

---

## MIRËNJOHJE



Luljeta Vuniqi Drejtoreshë ekzekutive në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore në mënyrë të posaçme e falënderon UNIFEM-in (Fondin Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara për Gratë) për përkrahjen financiare.

Bashkëpunimi i ngushtë me Osnat Lubranin (drejtoreshë e programit rajonal të UNIFEM-it për Evropën Qendrore dhe Lindore), Flora Macula (menaxhere vendore e programit të UNIFEM-it në Kosovë), ka bërë që projekti të planifikohet në dinamikën e paraparë në të gjitha fazat e tij dhe Erika Kvapillovën (zyrtare e Programit Kombëtar të UNIFEM-it).

Për përkrahje të vazhdueshme dhe këshilla profesionale falënderon Besim Kajtazin (ekspertë ligjor për çështje gjinore), për analizën e ligjeve Lynne Alice (profesoreshë në Universitetin e Dekan, Australi) për ndihmë në intervistimin e përfaqësuesve të disa organizatave ndërkombëtare në Kosovë.

Njëherit, falënderon edhe anëtarët e stafit të QKSGJ'së Luljeta Demollin, udhëheqëse e hulumtimit, Erëmirë Krasniqin asistente e hulumtimit, Driton Parduzin, Sibel Halimin, Shpresa Agushin, Albulena Metajn, Artan Krasniqin, Florie Xhemajlin, Laura Berishën kontributi i të cilëve ka qenë shumë i rëndësishëm për këtë raport.

## METODOLOGJIA

Ky raport i analizon nenet e CEDAW. Secila analizë e këtyre neneve është e përbërë prej dy pjesëve. Pjesa e parë është një analizë dhe pasqyrë e ligjeve të Kosovës lidhur me atë se sa përputhen ato me nenet e CEDAW, ndërsa pjesa e dytë paraqet analizën e të dhënave, të marrura nga institucionet dhe OJQ-të e ndryshme në Kosovës.

QKSGJ ka përdor informatat e mbledhura për të hartuar metodologjinë hulumtuese, për monitorimin e shkallës së implementimit të CEDAW në Kosovë. Teksti i Konventës CEDAW, në gjuhën shqipe i cili është përdorur në raport është marrë nga gazeta zyrtare e UNMIK-ut<sup>1</sup>. Kjo metodologji është krijuar asisoj që të mund të shërbejë si themel për punët monitoruese në të ardhmen; metodologjia e njëjtte mund të shfrytëzohet për monitorime të rregullta edhe nga ana e qeverisë.

Hulumtimi: Duke e përdorë metodologjinë, QKSGJ ka hulumtuar shkallën e implementimit të deritanishëm të CEDAW në Kosovë. Si burim i informatave janë përdorur ligjet, programet e mekanizmave të qeverisë, ekspertë e fushave të ndryshme, aktivistet e të drejtave të grave, statistikat, studime dhe materiale të tjera të shkruara. Instrumentet metodologjik që janë përdorur janë: analiza përmbajtjesore, intervista e gjysmë standardizuar dhe diskutimi në grup.

Rekomandimet janë finalizuar në bashkëpunim me përfaqësuesit e institucioneve dhe shoqërisë civile gjatë një takimi pune me grupin e ekspertëve.

Në raport janë analizuar 16 nenet e Konventës CEDAW në kontekstin kosovar, të cilat përbëjnë pjesën substanciale të saj.

Ky raport u finalizua më 5 maj 2008 dhe përmban të dhëna lidhur me çështjet gjinore në Kosovë deri më 30 dhjetor 2007.

Qëndrimet dhe analizat e bëra në këtë raport janë të QKSGJ dhe nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht vështrimet e UNIFEM-it, Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose të ndonjë organizate të saj ndërlidhëse.

---

1 Unofficial version, 19 June 2003. [http://www.unmikonline.org/albanian/regulations/index\\_alb.htm](http://www.unmikonline.org/albanian/regulations/index_alb.htm)

## AKRONIMET DHE SHKURTESAT

ABGJ	Agjensioni për Barazi Gjinore
AVUK	Agjencioni i Veterinarisë dhe i Ushqimit të Kosovës
DASHC	Departamenti i Administratës të Shërbimit Civil
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisë
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KFOS	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
KIP	Programin e Iniciativës Kosovare
KLMDNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
KOGJ	Klinika Obstetrike-Gjinekologjike
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RAE	Romë, Ashkali dhe Egjiptian
RRGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
RZHNJK	Raporti i Zhvillimit Njerëzor të Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
UNAIDS	Joint United Nations Programme on HIV/AIDS
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNFPA	United Nations Fund for Population Activities
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNIFEM	Fondi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara për Gratë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZKM	Zyra e Kryeministrit

## PËRMBLEDHJA E KONKLUZIONEVE KRYESORE

- Përforcimi i mekanizmave të Konventës bazohet në sistemin e raportimit, është e domosdoshme që OJQ-të ta shfrytëzojnë këtë mekanizëm për ta evidentuar shkallën e përgjegjësisë së strukturave qeveritare. Organizatat Joqeveritare kanë një rol të rëndësishëm, që përmes avokimit dhe monitorimit të implementimit të traktatit nga ana e qeverive të tyre përkatëse, ta shndërrojnë Konventën në një instrument për fuqizimin e grave në shoqëri.
- Raportimi i përfaqësuesve qeveritarë dhe vlerësimet e arritjeve të qeverive përkatëse nga ana e tyre shpesh është i mangët dhe ka tendencë që t'i minimizojë problemet dhe t'i zmadhojë arritjet. Për këtë arsye, Komiteti i CEDAW kërkon nga qeveritë që t'i marrin parasysh edhe qëndrimet e OJQ-ve gjatë përgatitjes së raportit qeveritar.
- "Raportimi në hije" i OJQ-ve në sesionet e CEDAW, siguron depërtim të rëndësishëm në gjendjen dhe shkallën e përpjekjeve të qeverisë që t'i promovojë dhe mbrojë të drejtat e grave.
- Korniza ligjore e Kosovës, veçanërisht Plani Kombëtar për Arritjen e Barazisë Gjinore, konsiderohet si një nga kornizat më të përparuara dhe më gjithëpërfshirëse në rajon. Megjithatë, ka pasur shumë pak përpjekje për të monitoruar nivelin e zbatimit të ligjeve të miratuara dhe të mekanizmave të vendosur.
- Një analizë e hollësishme për shkallën e zbatimit të CEDAW në Kosovë do të shërbente si informacion themelor për rekomandimet lidhur me hapat e ardhshëm në këtë aspekt dhe do të mund të shfrytëzohej si bazë mbi të cilën do të ndërtoheshin përpjekjet e ardhshme monitoruese, pas vendosjes së statusit politik të Kosovës.
- Duke pasur parasysh rrethanat në të cilat aktualisht gjendet Kosova, Komiteti i CEDAW- pa paragjykime ndaj statusit final të Kosovës - kërkon nga UNMIK-u që në bashkëpunim me Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ), të përpilojë një raport për shkallën e implementimit të Konventës në Kosovë që nga viti 1999. Raporti do të duhej të dorëzohej para 1 qershorit 2008.
- Agjensioni është duke punuar për raportim zyrtar dhe ka angazhuar ekspert kryesisht të legjislationit.
- Niveli i vetëdijesimit të shoqërisë kosovare për të drejtat ligjore, në përgjithësi mbetet i ulët. Në këtë kontekst, për shkak të dominimit të rrethanave të pavolitshme shoqërore problem i veçantë mbetet vetëdijesimi i grave për të drejtat e tyre të garantuara me ligj.

- Shumica e raporteve mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, e veçanërisht të atyre të ashtuquajtura grupe të "cenueshme" të njerëzve siç janë komunitetet pakicë, personat me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët, etj. flasin për marginalizimin e këtyre kategorive të njerëzve, duke konfirmuar me këtë praninë e praktikave diskriminuese në të gjitha sferat e jetës publike.
- Ekzistojnë pengesa të konsiderueshme për implementimin e plotë të CEDAW në Kosovë. Rrjedhimisht, nevojitet një përqendrim në gjetjen e kanaleve më të përshtatshme për përhapjen e informacioneve relevante lidhur me të. Fushatat mediale dhe fushatat në terren të aktivisteve për të drejtat e grave do ta ndihmonin procesin e rritjes së vetëdijesimit të grave kosovare për Konventën dhe dokumentet tjera të rëndësishme që përqendrohen në të drejtat e grave.
- Në Kosovë janë edhe një varg mekanizmash institucionalë dhe të tjerë për arritjen e barazisë gjinore si: Plani Kombëtar i Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore, Agjensioni për Barazi Gjinore, Zyra për Qeverisje të Mirë, Këshilli Ndërmintor për Barazi Gjinore, Zyrtaret/ët për Barazi Gjinore në Ministri dhe në Komuna, Njësia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Ombudspersonit, Njësitë për të drejtat e Njeriut në të gjitha ministrinë.
- Ndonëse në Kosovë janë hartuar një sërë ligjesh dhe strategjish për mbrojtjen e lirive njerëzore të grave dhe vajzave, problemi më i madh qëndron në implementimin dhe respektimin e tyre.
- Legjislati mbi çështjet e barazisë gjinore duhet t'i adaptohet edhe më tej situatës ekzistuese në Kosovë.
- Agjencia për Barazi Gjinore ka nevojë për kapacitete, legjitimitet dhe status më të qartë. Këto probleme institucionale kanë ndikim të kundërt në gjendjen e gruas në Kosovë, e cila është e karakterizuar me dhunë familjare dhe diskriminim ekonomik.
- Numri i rasteve nga viti në vit nuk ka ndonjë dallim drastik, mirëpo në rast se krahasohet numri i rasteve të dhunës në familje të vitit 2002 (1.273) me atë të vitit 2006 (1.371), vërehet se dhuna në familje në këtë vit (2006) është rritur për 98 raste.
- Bazuar në të dhënat e marra nga SHPK-ja, kjo dukuri më shumë prekë gratë sesa burrat. Prej 1.370 rasteve në vitin 2005, 1.107 ose 81 përqind janë gra dhe vetëm 19 përqind janë burra. Ndërkaq, për vitin 2006 numri i viktimave është 77 përqind gra dhe 23 përqind burra. Po ashtu janë regjistruar 78 raste të dhunës në familje në të cilat viktima kanë qenë fëmijët.
- Sipas Raportit të Progresit (2007), Kosova është ende destinacion dhe



## FAQE 9

transit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

- Analfabetizmi ndër gratë dhe vajzat shqiptare në Kosovë kap shifrën 9 përqind dhe është tri herë më i lartë sesa tek burrat dhe djemtë shqiptarë. Sipas "Raportit të Zhvillimit Njerëzor të Kosovës", përqindja e analfabetizmit ndër të rriturit në përgjithësi është më e ulët tek burrat, krahasuar me përqindjen e grave kosovare
- Mundësitë e punësimit për gratë janë më të vogla. Sipas të dhënave nga Banka Botërore, mundësia për punësim tek gratë kapë shifrën 8.4 përqind, kurse për meshkuj 35.1 përqind. Këtë e determinojnë në masë të madhe disa nga faktorët, siç janë: qasja jo e barabartë në shkollim, braktisja e shkollimit, martesat e hershme etj.
- Analfabetizmi ndër gratë dhe vajzat shqiptare në Kosovë kap shifrën 9 përqind dhe është tri herë më i lartë sesa tek burrat dhe djemtë shqiptarë. Sipas "Raportit të Zhvillimit Njerëzor të Kosovës", përqindja e analfabetizmit ndër të rriturit në përgjithësi është më e ulët tek burrat, krahasuar me përqindjen e grave kosovare.
- Sipas raportit "Gjendja Perinatale në Kosovë për 2000 - 2006", në vitin 2000 janë raportuar 9 vdekje maternale në 38.907 lindje me fëmijë të gjallë (23.1/100000), përderisa në vitin 2006 janë raportuar 2 vdekje maternale në 28.450 lindje me fëmijë të gjallë (7.0/100000). Këto shifra janë të përafërta me vendet e zhvilluara. Megjithatë, nuk duhet harruar faktin se "vdekjet maternale janë të raportuara vetëm nga institucionet shëndetësore".
- Gratë e komunitetit RAE, ballafaqohen me vështirësi më të theksuar në qasje në shërbime shëndetësore, si pasojë e kushteve socio-ekonomike, diskriminimit etnik, mungesës së informacionit, infrastrukturës shëndetësore, si dhe mungesës së politikave shtetërore ndaj këtij komunitetit në përgjithësi.

## HYRJE

Gjatë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, në nivelin ndërkombëtar janë ndërmarrë iniciativa të rëndësishme në përpilimin e deklaratave dhe konventave, të cilat në mënyrë specifike kanë të bëjnë me aspektin gjinor.

Nga viti 1952 deri në vitin 1962, Komisioni për Statusin e Grave<sup>2</sup> ka hartuar disa konventa të rëndësishme si “Konventën mbi të drejtat politike të gruas” (1952), “Konventën mbi ruajtjen e përkatësisë kombëtare të gruas së martuar” (1957), dhe “Konventën ndërkombëtare mbi dhënien e pëlqimit për martesë, minimumin e moshës për të lidhur martesë dhe regjistrimin e martesës” (1962).

Pas aprovimit të këtyre tri konventave të cilat kanë adresuar vetëm probleme të veçanta në aspektin e barazisë gjinore, ka filluar puna për hartimin e një konvente e cila në mënyrë të përgjithshme do të merrej me çështjet të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në eliminimin e pabarazisë gjinore. Kësisoj, Deklarata për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Gruas, e cila është aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme në vitin 1967, i ka paraprirë Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW<sup>3</sup>), me qëllim të dhënies së karakterit obligativ për të mbrojtur të drejtat civile, politike, sociale dhe kulturore.

Në Konferencën Botërore të Grave, të mbajtur në Mexico City në vitin 1972, është kërkuar që çështjet gjinore të rregullohen përmes konventave të cilat, për shtetet që do t'i ratifikonin, do ta kishin forcën e ligjit.

Një dokument i fillë me fuqi ligjore - Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW) - është aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme në vitin 1979 dhe ka hyrë në fuqi më 1981.

Në aspektin ndërkombëtar, CEDAW krijon të drejta dhe obligime për shtetet të cilat e kanë ratifikuar atë. Për nga numri i shteteve që e kanë ratifikuar këtë konventë<sup>4</sup>, ajo është radhitur me Kartën Ndërkombëtare të të Drejtave (e cila përfshin Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Paktin Ndërkombëtar Civil dhe Politik si dhe Paktin Ndërkombëtar Social, Ekonomik dhe Kulturor).

Zbatimi i Konventës mbikëqyret nga një trup monitorues, i cili quhet Komiteti i

2 “Komisioni për Statusin e Grave” është komision funksional i Këshillit për Ekonomi dhe Shoqëri në Kombet e Bashkuara <http://www.un.org/womenwatch/daw/csw/>

3 Në anglisht: “Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination Against Women – CEDAW”. Akronimi në anglisht konsiderohet shkurtësë ndërkombëtare e Konventës, por ai gjithashtu është bërë pjesë përbërëse e terminologjisë së studimeve gjinore në Kosovë, prandaj në këtë publikim në vend të emërimit të plotë (“Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave”) do të përdoren “CEDAW” dhe “Konventa”.

4 Deri më tash, CEDAW është aprovuar nga 185 shtete, respektivisht, nga më shumë se 90 për qind e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara.

## FAQE 11

CEDAW. Në bazë të Artikullit 18 të Konventës, Komitetet e CEDAW nga shtetet që e kanë aprovuar atë duhet t'ia paraqesin Sekretarit Gjeneral një raport mbi legjislacionin, gjyqësorin, administrativin apo masat të tjera përkatëse të cilat janë ndërmarrë në mënyrë që të implementohen suksesshëm provizionet e Konventës.

Ky Komitet<sup>5</sup> po ashtu u mundëson specialistëve nga agjencionet e specializuara dhe entitetet tjera të Kombeve të Bashkuara që në takimet plenare të prezantojnë informata të cilat kanë të bëjnë me artikujt specifikë të Konventës, ose me çështjet që konsiderohen për rekomandime dhe sugjerime në përgjithësi.

Sipas Artikullit 22 të Konventës, agjencive të specializuara u jepet mundësia që të jenë prezente gjatë shqyrtimit të zbatimit të masave ligjore të Konventës të cilat janë pjesë përbërëse të aktiviteteve të saj. Komiteti mund t'i ftojë agjencitë e specializuara që t'ia paraqesin raportet e tyre lidhur me shkallën e zbatimit të Konventës në fushat përkatëse.

Aprovimi i dy instrumenteve të rëndësishme (Platforma për Veprim e Pekingut dhe CEDAW) nga një numër i madh i shteteve, është dëshmi për ekzistimin e vetëdijes globale dhe vullnetit universal politik për institucionalizmin e parimeve anti-diskriminuese ndaj grave si dhe të atyre për barazinë gjinore. Këto dy aspekte kanë ndikim në zhvillimin e ligjeve, standardeve dhe politikave për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të gruas.<sup>6</sup>

Qëllimi i CEDAW është eliminimi i të gjitha qëndrimeve, praktikave, dallimeve, përjashtimeve apo preferencave në baza gjinore. Konventa përbëhet prej dy pjesëve kryesore: pjesa hyrëse përfshin përshkrimin e strukturës, arsyeve themelore dhe theksimit të përkushtimit që shtetet duhet respektuar pas nënshkrimit/ratifikimit të kësaj Konvente, ndërsa pjesa e dytë i detajizon të drejtat e grave dhe mbrojtjen e tyre. Me ratifikimin e Konventës, shtetet përveç që pranojnë ta zbatojnë Konventën në tërë territorin e tyre, ato po ashtu pranojnë që të realizojnë/paraqesin raporte mbi masat që janë ndërmarrë për arritjen e objektivave të Konventës, posaçërisht në mënjanimin e pengesave dhe restriksioneve.

Çfarëdoj dallimi, përjashtimi apo preference në baza gjinore, ka ndikim të madh negativ në zhvillimin e shoqërisë. Për këtë arsye, zbatimi i efektshëm i kësaj Konvente mund t'ia eliminojë dallimet, përjashtimet dhe preferencat në baza gjinore të cilat krijojnë pabarazi në mes të burrave dhe grave.

Konventa është traktati i vetëm i të drejtave të njeriut që konfirmon të drejtën riprodutive të gruas dhe e merr parasysh rolin e kulturave dhe traditave si forcë e cila ndikon në formimin e roleve gjinore dhe raporteve familjare. Ajo e pohon të drejtën e gruas që ta mësojë/sigurojë, ndryshojë ose ta ruajë

5 <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/index.html>

6 [http://www.un.org/womenwatch/daw/Review/documents/panel-1/Simonovic\\_formatted.pdf](http://www.un.org/womenwatch/daw/Review/documents/panel-1/Simonovic_formatted.pdf) (14 shtator 2007).

nacionalitetin e saj dhe të fëmijëve të vetë. Shtetet që e aprovojnë CEDAW po ashtu pajtohen t'i ndërmarrin masat e duhura kundër të gjitha formave të trafikimit dhe eksploatimit të gruas.

Të gjitha shtetet të cilat e miratojnë Konventën janë të obliguara të ndërmarrin masa ligjore dhe t'i zbatojnë në praktikë. Ato janë po ashtu të detyruara t'i paraqesin raportet për shtetet e tyre, të paktën çdo katër vjet, së bashku me masat të cilat duhet t'i ndërmarrin në pajtim me obligimet e traktatit.<sup>7</sup>

## Rëndësia e Organizatave Joqeveritare gjatë procesit të raportimit për CEDAW

Pasi që përforcimi i mekanizmave të Konventës bazohet në sistemin e raportimit, është e domosdoshme që OJQ-të ta shfrytëzojnë këtë mekanizëm për ta evidentuar shkallën e përgjegjësive së strukturave qeveritare. Organizatat Joqeveritare kanë një rol të rëndësishëm, që përmes avokimit dhe monitorimit të implementimit të traktatit nga ana e qeverive të tyre përkatëse, ta shndërrojnë Konventën në një instrument për fuqizimin e grave në shoqëri.

Raportimi i përfaqësuesve qeveritarë dhe vlerësimet e arritjeve të qeverive përkatëse nga ana e tyre shpesh është i mangët dhe ka tendencë që t'i minimizojë problemet dhe t'i zmadhojë arritjet. Për këtë arsye, Komiteti i CEDAW kërkon nga qeveritë që t'i marrin parasysh edhe qëndrimet e OJQ-ve gjatë përgatitjes së raportit qeveritar.

Komiteti u bën thirrje të drejtpërdrejtë OJQ-ve që të përfshihen në këtë proces dhe t'i japin inputet e tyre në mënyrë të pavarur me anë të "raportit në hije" ("shadow report") dhe me një prezantim joformal në sesionet e CEDAW, në mënyrë që ta prezantojnë perspektivën e tyre sa i përket nivelit të respektimit të Konventës.<sup>8</sup>

"Raportimi në hije" i OJQ-ve në sesionet e CEDAW, siguron depërtim të rëndësishëm në gjendjen dhe shkallën e përpjekjeve të qeverisë që t'i promovojë dhe mbrojtë të drejtat e grave.

## Raportimi i Kosovës për CEDAW

Shtatë vjet pas përfundimit të luftës, Kosova<sup>9</sup> ende nuk ka status final politik.

7 <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>

8 [http://iwwraw.igc.org/shadow/CEDAWNGOguide\\_June2003.doc](http://iwwraw.igc.org/shadow/CEDAWNGOguide_June2003.doc)

9 Kosova gjendet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik (Evropës Juglindore).

Kufizohet me Serbinë në veri dhe lindje, Malin e Zi në veriperëndim, Shqipërinë në jugperëndim dhe Maqedoninë (IRJM) në jug. Sipërfaqja e Kosovës është 10.877 kilometra katrorë.

Regjistrimi i fundit i plotë i popullatës është bërë më 1981, dhe sipas tij, Kosova në atë kohë kishte 1.584.440 banorë. Në vitin 1991 është bërë një regjistrim tjetër i popullsisë, mirëpo ai është i pavlefshëm, pasi që u bojkotua kolektivisht nga shqiptarët. Popullsia e përgjithshme e Kosovës vlerësohet të jetë 1.900.000 banorë (sipas Entit Statistikor të Kosovës, 88 për qind janë shqiptarë, 7 për qind janë serbë dhe 5 për qind janë "të tjerë"). Rreth 40 për qind e popullsisë kosovare jeton në hapësirat

Kjo gjendje ka lënë pasoja në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe veçanërisht ka ndikuar në ngadalësimin e proceseve të demokratizimit dhe të fuqizimit institucional. Fakti se Kosova nuk është shtet i pranuar ndërkombëtarisht nënkupton se ajo ende nuk mund të bëhet palë nënshkruese e rezolutave dhe konventave ndërkombëtare. Mirëpo, prania e Kombeve të Bashkuara në Kosovë<sup>10</sup> dhe puna e aktivisteve vendore për të drejtat e grave, megjithatë, kanë krijuar parakushte për aprovimin e këtyre konventave dhe rezolutave, menjëherë pas vendosjes së statusit përfundimtar të Kosovës. Sistemi i ri ligjor i Kosovës<sup>11</sup>, i miratuar nga Kuvendi dhe i dekretuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, i merr parasysh konventat dhe rezolutat ndërkombëtare siç është edhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, e cila është e përfshirë në Kornizën Kushtetuese të Kosovës.

Korniza ligjore e Kosovës, veçanërisht Plani Kombëtar për Arritjen e Barazisë Gjinore, konsiderohet si një nga kornizat më të përparuara dhe më gjithëpërfshirëse në rajon. Megjithatë, ka pasur shumë pak përpjekje për të monitoruar nivelin e zbatimit të ligjeve të miratuara dhe të mekanizmave të vendosur. Kjo mbetet një gjë e domosdoshme, jo vetëm sa i përket përcjelljes së procesit të përpilimit dhe zbatimit të ligjeve në Kosovë, por edhe për monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare siç është CEDAW. Një analizë e hollësishme për shkallën e zbatimit të CEDAW në Kosovë do të shërbente si informacion themelor për rekomandimet lidhur me hapat e ardhshëm në këtë aspekt dhe do të mund të shfrytëzohej si bazë mbi të cilën do të ndërtoheshin përpjekjet e ardhshme monitoruese, pas vendosjes së statusit politik të Kosovës.

Duke pasur parasysh rrethanat në të cilat aktualisht gjendet Kosova, Komiteti i CEDAW- pa paragjykime ndaj statusit final të Kosovës - kërkon nga UNMIK-u që në bashkëpunim me Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ), të përpilojë një raport për shkallën e implementimit të Konventës në Kosovë që

---

urbane, kurse rreth 60 për qind në hapësirat rurale.

10 Kosova është një entitet nën administratën e përkohshme ndërkombëtare, që, me popullin e vet, katribute unike historike, juridike, kulturore dhe gjuhësore. Duke marrë parasysh që Kosova është një entitet nën administratën e përkohshme ndërkombëtare, në këtë drejtim ka shumë specifika që e dallojnë nga vendet e pavarura e këtu edhe janë veçoritë e saj se Ligji në fuqi në Kosovë përfshin: Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe legjislacionin që ka qenë në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. Në rast konfliktesh, do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to. Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar me lart, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj. Shih Neni 1, Rregullore e UNMIK-ut Nr.1999/24 për Ligjin në fuqi në Kosovë.

11 Sistemi ligjor në Kosovë rregullohet përmes një përzjerje ligjesh të aprovuara nga IPVQ-të, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative të UNMIK-ut, dhe ligjeve jugosllave të miratuara para 22 marsit të vitit 1989.

nga viti 1999. Raporti do të duhej të dorëzohej para 1 qershorit 2008.<sup>12</sup>

Akterët e intervistuar, të cilët në mënyrë direkte apo indirekte do të jenë të involvuar në raportimin e Kosovës për CEDAW, kanë qëndrime të ndryshme lidhur me raportimin.

Visare Gashi - Goranit, shefe e Agjencionit për Barazi Gjinore, tregon se Agjensioni është duke u përgatitur për të raportuar në Komitetin e CEDAW. "Pjesa me e madhe e raportit inicial për implementimin e Konventës CEDAW është përfunduar. Shtetet e reja anëtare të Kombeve të Bashkuara fillimisht e paraqesin raportin inicial. Ka raste kur paraqitet analiza e gjendjes së burrave dhe grave në vend, por gjithashtu ka raste kur paraqitet raporti inicial dhe raportet tjera. Faktikisht, analizën e situatës ne e kemi të përfunduar, kuptohet, gjithmonë duke iu referuar vitit 2006. Konturat janë aty - kurdo që të ftohemi për të raportuar, jemi në gjendje që ta paraqesim raportin inicial. Këtë raport e pasurojmë tërë kohën duke mbledhur shënime dhe duke i evidentuar trendet në fushat specifike të interesit në zbatimin e CEDAW. Sidomos në aspektin e legjisllacionit jemi mjaft të gatshëm të raportojmë, pasi Kosova e ka një legjisllacion të mirë, duke e krahasuar me vendet tjera në rajon".<sup>13</sup>

Në anën tjetër, Flora Macula, drejtoreshë e Zyrës së UNIFEM-it në Kosovë, thotë se deri më tani janë bërë shumë iniciativa dhe përpjekje, sidomos nga ana e shoqërisë civile, që të prezantohet një pasqyrë e saktë dhe e plotë lidhur me pozitën e gruas dhe të drejtave të saj në Kosovë. "Këto iniciativa janë ndërmarrë nga agjensione të ndryshme, ndërsa informacionet janë shpërndarë nëpër rrjete të ndryshme ndërkombëtare të organizatave. Mirëpo, nga ana e Qeverisë ende nuk ka raporte zyrtare sa i përket këtyre çështjeve. Duhet të theksohet se këtë vit, në Komitetin e CEDAW është raportuar për herë të parë për Kosovën, por nga ana e përfaqësuesve të Serbisë. Ai raport ka qenë i pasaktë dhe ka paraqitur një imazh të deformuar sa i përket pozitës së gruas në Kosovë".<sup>14</sup>

Claire Hutchenson, zyrtare për çështje gjinore në UNMIK, flet për gatishmërinë e administratës ndërkombëtare në Kosovë për të ndihmuar në përpilimin e raportit, por gjithashtu edhe për paqartësitë lidhur me agjencionin kosovar që duhet të raportoje në Komitetin e CEDAW. "Jemi duke e finalizuar një 'Memorandum të Mirëkuptimit' me UNIFEM-in, i cili do të na mundësojë që ta japim kontributin tonë në përgatitjen e raportit për CEDAW, qoftë me trajnime apo me përkrahje teknike. Po ashtu, do të inkurajojmë Qeverinë që të fillojë të marrë seriozisht këtë çështje, në mënyrë që raporti të përfundohej deri në muajin qershor. Për këtë arsye, 'Memorandumi i Mirëkuptimit' do t'i adresohet Kryeministrit, ashtu që ai fillimisht ta identifikojë qartë departamentin i cili do ta merr këtë përgjegjësi, sepse aktualisht ka mosmarrëveshje në mes

12 [http://www.iktk.se/publikationer/rapporter/pdf/cedaw\\_kommentarer\\_skuggrapport.pdf](http://www.iktk.se/publikationer/rapporter/pdf/cedaw_kommentarer_skuggrapport.pdf) (16 maj 2007).

13 Intervistë me Visare Gashi- Goranin, shefe e Agjencionit për Barazi Gjinore.

14 Intervistë me Flora Maculën, drejtoreshë e Zyrës së UNIFEM-it në Kosovë.

## FAQE 15

të agjensioneve brenda Zyrës së Kryeministrit rreth asaj se kush duhet të raportojë. Raportimin duhet ta bëjë Agjensioni për Barazi Gjinore, por tani për tani duket se atë do ta bëjë OGA", shprehet Hutchenson.<sup>15</sup>

Ariana Qosja, Këshilltare Ligjore Nacionale për Gratë dhe Fëmijët dhe pjesë e Njësitit kundër Trafikimit në OSBE sqaron çështjen e kërkesës zyrtare për raportim nga ana e Komitetit të CEDAW. "Këtë kërkesë ata e kanë proceduar në OSBE, sepse ky institucion ka qenë i përfshirë në koordinimin e të dhënave për raportin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike si dhe të Drejtat Ekonomike dhe Sociale".<sup>16</sup>

Ndërsa Frode Muring, përfaqësues i Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, thekson rolin që duhet të ketë OKB-ja në përgatitjen e raportimit, por gjithashtu shpreh rezervat e tij në këtë aspekt: "Kombet e Bashkuara kanë obligim ndaj Kosovës që të jenë aktive në këtë aspekt dhe të bëjnë të mundur ndërmarrjen e hapave të rëndësishëm në çështjen e raportimit. Mirëpo, fatkeqësisht jo të gjithë e kanë kuptuar këtë çështje".<sup>17</sup>

---

15 Intervistë me Claire Hutchenson, zyrtare për çështje gjinore në UNMIK

16 Intervistë me Ariana Qosjen, Këshilltare Ligjore Nacionale për Gratë dhe Fëmijët dhe pjesë e Njësitit kundër Trafikimit në OSBE

17 Intervistë me Frode Muring, përfaqësues i Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## ANALIZA E GJENDJES SË GRAVE NË KOSOVË NGA PERSPEKTIVA E CEDAW

### I. NENI 1

#### Neni 1.

Për qëllimet e kësaj Konvente shprehja “diskriminimi ndaj grave” nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit, e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.

#### 1.1 Përputhja e nenit 1 me ligje

Korniza Kushtetuese siguron që “Të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.”<sup>18</sup>

Edhe pse Korniza Kushtetuese nuk qartëson përkufizimin që ndalon diskriminimin e grave, Neni 3.2 përcakton se: “Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranura në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”. Neni 3, po ashtu përfshin instrumentet ndërkombëtare, në këtë drejtim edhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas-CEDAW, të cilat duhet t’iu referohen dhe respektojnë Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe përfundon duke cekur: “Dispozitat për të drejtat dhe liritë e parashtruara në këto instrumente (përfshirë këtu edhe CEDAW) aplikohen në Kosovë drejtpërsëdrejti si pjesë e Kornizës Kushtetuese.”<sup>19</sup>

Korniza Kushtetuese nuk përmban asnjë dispozitë me të cilën përcaktohet diskriminimi qoftë i drejtpërdrejtë apo i tërthortë. Por, kjo është përfshirë në Ligjin për Barazi Gjinore (LBGJ) dhe Ligjin Kundër Diskriminimit (LKD).

<sup>18</sup> Të gjitha rregulloret dhe urdhëresat administrative të UNMIK-ut, duke përfshirë edhe ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallura nga PSSP-ja, janë të vendosur në: <http://www.unmikonline.org/regulations/index.htm>.

Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës janë të vendosura në: <http://www.kuvendikosoves.org/> dhe <http://www.ks-gov.net/GazetaZyrtare/>

Disa nga udhëzimet administrative të nxjerra nga Qeveria e Kosovës, duke përfshirë edhe ministritë, janë të vendosura në: <http://www.ks-gov.net/>

<sup>19</sup> Neni 3.2, Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, 15 maj 2001. (Korniza Kushtetuese).



## FAQE 17

Më 7 qershor 2004, është shpallur Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë (LBGJ), me të cilin mbrohet, trajtohet dhe vendoset, barazia ndërmjet gjinive, si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore.<sup>20</sup>

Ligji për Barazi Gjinore përcakton që trajtim i barabartë gjinor “do të thotë mënjanim i formave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit gjinor.”

Neni 2 (pika 3 dhe 4) i Ligjit për barazi gjinore në Kosovë (LBGJ) përcakton që diskriminim i drejtpërdrejtë gjinor do të thotë “trajtim i pabarabartë i ndonjë individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme.”<sup>21</sup> Në anën tjetër, “Diskriminim i tërthortë gjinor do të thotë vënia e individit të njëres gjini në pozitë jo të barabartë me dispozitat asnjane, standardet apo trajtim të pabarabartë në rrethana të njëjta ose të ngjashme, përveç rasteve kur këto dispozita, standarde apo ky trajtim është i domosdoshëm dhe nëse mund të justifikohet me fakte objektive, që nuk bazohen pasqerisht në ndonjërin gjini.”<sup>22</sup>

Po ashtu, në kuptim të LBGJ-së (Neni 2.5), nxitja e individit tjetër në diskriminim gjinor konsiderohet diskriminim gjinor. Neni 2.6 përcakton që ngacmimi dhe ngacmimi seksual paraqesin diskriminim gjinor.<sup>23</sup>

Ligji Kundër Diskriminimit (Neni 3) ofron definicion të ngjashëm të diskriminimit direkt dhe indirekt.<sup>24</sup> Sipas LKD-së: Diskriminimi i drejtpërdrejtë nënkuptohet kur një person trajtohet, është trajtuar, ose do të trajtohet në mënyrë të pabarabartë në krahasim me tjetrin, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat e përshkruara nën 2 a<sup>25</sup>. Ndërsa, diskriminimi i tërthortë nënkuptohet kur nga bazat e përshkruara nën 2 a, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në shikim të parë e ven personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerë, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat që e ndalojnë diskriminim,

---

20 Neni 1.1- Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/18 (7 qershor 2004) mbi shpalljen e Ligjit për barazi gjinore në Kosovë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/2 për barazi gjinore. (LBGJ)

21 Neni 2.3, LBGJ.

22 Neni 2.4, LBGJ.

23 Neni 2.5, LBGJ.

24 Neni 3, Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/32 (20 gusht 2004) mbi shpalljen e Ligjit kundër diskriminimit, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/3 kundër diskriminimit. (LKD)

Neni 3, LKD. Ligji kundër diskriminimit definon edhe forma të tjera të diskriminimit: Ngacmimi, viktimizimi segregacioni dhe të udhëzuarit për të diskriminuar personat e tjerë.

25 Neni 2 (a) LKD-Parimi i trajtimit të barabartë-nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paafësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera).

përveç në rastet kur dispozita e tillë, praktika apo kriteri mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim dhe me mjete legjitime, të domosdoshme për arritjen e qëllimit.<sup>26</sup>

## 1.2 Përputhja e nenit 1 me fakte

Niveli i vetëdijesimit të shoqërisë kosovare për të drejtat ligjore, në përgjithësi mbetet i ulët. Në këtë kontekst, për shkak të dominimit të rrethanave të pavolitshme shoqërore problem i veçantë mbetet vetëdijesimi i grave për të drejtat e tyre të garantuara me ligj.

Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë<sup>27</sup> thekson se vetëdijesimi në kuadër të shoqërisë së Kosovës për parimin e diskriminimit dhe luftës kundër tij ende është i dobët. “Të gjitha raportet mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, e veçanërisht të atyre të ashtuquajtura grupe të ‘cenueshme’ të njerëzve siç janë komunitetet pakicë, personat me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët, etj. flasin për marginalizimin e këtyre kategorive të njerëzve, duke konfirmuar me këtë pranimë e praktikave diskriminuese në të gjitha sferat e jetës publike. Koncepti universal i të drejtave të njeriut shpesh nuk përfshinë të drejtat e grupeve të caktuara. Prandaj, kjo e ka krijuar nevojën për një përkushtim më të madh drejt promovimit dhe zbatimit praktik, me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në bazë të ligjit dhe standardeve ndërkombëtare”.<sup>28</sup>

Për këto arsye, ekzistojnë pengesa të konsiderueshme për implementimin e plotë të CEDAW në Kosovë. Rrjedhimisht, nevojitet një përqendrim në gjetjen e kanaleve më të përshtatshme për përhapjen e informacioneve relevante lidhur me të. Fushatat mediale dhe fushatat në terren të aktivisteve për të drejtat e grave do ta ndihmonin procesin e rritjes së vetëdijesimit të grave kosovare për Konventën dhe dokumentet tjera të rëndësishme që përqendrohen në të drejtat e grave.

Sipas Claire Hutchinson, zyrtare për çështje gjinore në UNMIK, “ka shumë njerëz që as nuk janë të vetëdijshëm për ekzistimin e Ligjit për Barazi Gjinore. Por, kjo gjë ndodhë edhe me ligje tjera. Në njëërën anë konsiderohen si shembuj të mrekullueshëm të progresivitetit dhe lidhjeve të forta me legjislacionin ndërkombëtar, por në anën tjetër kemi dështim në implementimin e tyre”.

Hutchinson konsideron se është problematike paqartësia në ndarjen e punës në mes të dy agjensioneve të ndryshme që punojnë në çështje gjinore përbrenda Zyrës së Kryeministrit. “Mendoj se çështjet e anti-diskriminimit janë më shume

26 Neni 3(a dhe b) LKD.

27 ZBATIMI I LIGJIT KUNDËR DISKRIMINIMIT Sfidë për Kosovën Qershor, 2007

28 ZBATIMI I LIGJIT KUNDËR DISKRIMINIMIT Sfidë për Kosovën Qershor, 2007

përgjegjësi e Zyrës për Qeverisje të Mirë, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore sesa e Agjencionit për Barazi Gjinore. Për këtë arsye, implementimi i Konventës CEDAW duhet të jetë përgjegjësi e ZQM-së”, shprehet ajo.

## II. NENI 2

Neni 2 Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë, një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave dhe për këtë arsye zotohen:

- (a) Të përfshijnë në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme, parimin e barazisë së burrit dhe të gruas, po qe se ende nuk është bërë, dhe të sigurojnë nëpërmjet legjislacionit dhe masave të tjera të përshtatshme zbatimin praktik të këtij parimi;
- (b) Të miratojnë masa ligjore dhe masa të tjera të përshtatshme duke përfshirë edhe sanksione, po qe se është e nevojshme, duke ndaluar çdo formë të diskriminimit ndaj grave;
- (c) Të vendosin një mbrojtje gjyqësore të të drejtave të grave, mbi bazën e barabartë me burrat, dhe të sigurojnë, nëpërmjet gjykatave kombëtare kompetente dhe institucioneve të tjera publike, mbrojtjen efektive të grave kundër çdo veprimi diskriminues;
- (ç) Të mos ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë detyrim;
- (d) Të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave që ushtron ndonjë person, organizatë ose çfarëdo ndërmarrje;
- (dh) Të marrin të gjitha masat e përshtatshme, duke përfshirë legjislacionin, për të ndryshuar ose shfuqizuar ligjet ekzistuese, rregulloret, zakonet apo praktikatat të cilat përbëjnë diskriminimin ndaj gruas;
- (e) Të shfuqizojnë të gjitha dispozitat e brendshme penale të cilat përbëjnë diskriminimin ndaj gruas.

### 2.1 Përputhja e nenit 2 me ligje

Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë mbron, trajton dhe vendos barazinë gjinore si vlerë themelore<sup>29</sup>. Ligji për Barazi Gjinore përcakton që barazi gjinore do të thotë: “pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi.”<sup>30</sup>

29 Neni 1.1, LBGJ.

30 Neni 2.1- LBGJ.

Neni 1.2 i LBGJ-së përcakton kushte dhe mundësi për barazi gjinore përmes politikave që mbështesin zhvillimin e gjithanshëm dhe përmirësimin, sidomos të pozitës së femrave, në mënyrë që ato të jenë të vlerësuara dhe të gëzojnë autoritet në familje dhe shoqëri.

Garantimi i të drejtave të barabarta është detyrë e tërë shoqërisë dhe nënkupton mënjanimin e pengesave në realizimin e barazisë gjinore, dhe kjo është përcaktuar në Nenin 1.3 të LBGJ-së. Neni 1.4 i LBGJ-së përcakton se barazia gjinore bazohet në parimin e sjelljes së njëjtë dhe në parimin e mundësive të barabarta, ndërsa jetësohet me masat pozitive dhe me politikë të vetëdijësuar për barazi gjinore.

Ndalohet diskriminimi gjinor me ligj në të gjitha fushat e jetës shoqërore në Kosovë, është përcaktuar në LBGJ.<sup>31</sup>

Në ushtrimin e funksioneve të tyre, të gjithë personat që marrin përsipër detyra publike ose punojnë në zyra publike në Kosovë duhet t'i respektojnë standardet e pranuar ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe nuk duhet të diskriminojnë asnjë person mbi kurrfarë baze gjinore, racore, të ngjyrës, gjuhës, religjionit, bindjes politike a qëndrimeve, mbi bazën e origjinës kombëtare, etnike apo sociale në lidhje me shoqërinë, pronën, lindjen apo të ndonjë statusi tjetër.<sup>32</sup>

Neni 3.1 i LBGJ-së përcakton: Me zbatimin e masave ligjore dhe afirmative vendoset pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në organet e të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të arrijë nivelin e pjesëmarrjes së tyre te popullata e përgjithshme e Kosovës.

“Kuvendi i Kosovës respekton parimet e përfaqësimit të barabartë gjinor gjatë themelimit të organeve punuese dhe të delegacioneve në pajtim me rregulloren e tij të punës.”<sup>33</sup>

Në fushën e barazisë gjinore është detyrë edhe e degës së ekzekutivit që të promovojë dhe garantojë të drejta të barabarta gjinore.<sup>34</sup>

Po ashtu, edhe “organet e qeverisjes lokale, në pajtim me kompetencat e tyre, promovojnë dhe krijojnë mundësi të barabarta, hartojnë politikat e tyre duke u bazuar në barazinë gjinore dhe miratojnë masa dhe ndërmarrin aktivitete të nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe meshkuj.”<sup>35</sup>

31 Neni 18.2. LBGJ

32 Neni 2 (Respektimi i standardeve të pranuar ndërkombëtare) Rregullore e UNMIK-ut nr.2000/54 (27 shtator 2000) ndryshim i Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/1,të ndryshuar mbi autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë.

33 Neni 4.1-LBGJ.

34 Neni 4.7-LBGJ

35 Neni 4.14-LBGJ.

## FAQE 21

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, në Nenin 2.3 përcakton se « Të gjitha organet dhe instancat e komunës kujdesen që banorët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendim tjetër, pa dallim prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta të barabarta dhe të drejta për punësim në shërbimet komunale të gjitha niveleve.»<sup>36</sup>

Institucioni i Avokatit të Popullit siguron mekanizma të cilëve njerëzit mund t'i uqasen në kohën e duhur për shqyrtimin e veprimeve që përbëjnë keqpërdorim të pushtetit nga institucionet e Kosovës dhe ofron rekomandime për korrigjimin e tyre. Nëse nga keqpërdorimi i pushtetit pason dëm i rëndë i vazhdueshëm, Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsheptuar i rishqyrton veprimet që përbëjnë keqpërdorimin e pushtetit dhe ofron rekomandime për korrigjimin e tyre.<sup>37</sup>

Institucioni i Avokatit të Popullit ka kompetenca për të pranuar dhe hetuar ankesat nga çdo banor i përhershëm i Kosovës apo nga personi fizik a juridik në territorin e Kosovës lidhur me shkeljen e standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të përfshira në ligjin dhe aktet në fuqi, duke përfshirë edhe mosndërmarrjen e veprimeve, që përbëjnë keqpërdorim të pushtetit nga institucionet e Kosovës.<sup>38</sup>

Ligji Kundër Diskriminimit (LKD) zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizikë dhe juridikë, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat cenojnë të drejtat e personit/ve fizik dhe juridik, në fushat si vijon : a). kushteve për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimin dhe kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale dhe avancimet b). qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimit, përfshirë edhe përvojën e punës praktike c). kushtet e punësimin dhe kushtet e punës, përfshirë shkarkimin nga puna dhe pagesën d). anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve ose të punëdhënësve ose të çdo organizate tjetër, anëtarët e së cilës ushtrojnë profesione të caktuar, përfshirë edhe fitimet që mundësohen nga organizatat e tilla e). mbrojtja sociale, përfshirë skemën e ndihmës sociale, sigurimin social dhe mbrojtjen shëndetësore f). lehtësitë sociale, përfshirë, ndër të tjera, edhe ndihmën humanitare g) arsimin h). qasje në vendbanim dhe format e tjera të pronës (të luajtshme dhe të papalujtshme) i). qasje në furnizimin e të mirave materiale dhe shërbimeve të cilat janë në dispozicion të opinionit publik j). trajtimi i drejtë

36 Neni 2.3. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/45 (11 gusht 2000) mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës.

37 Neni 1.2 Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6 (16 shkurt 2006) mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë.

38 Neni 3.1 Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6 (16 shkurt 2006) mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë.

para gjykatave dhe të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë k). sigurinë personale l). Pjesëmarrjen në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të zgjedhur dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur m). qasja në vendet publike dhe n). çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.<sup>39</sup>

Sektori publik, privat si dhe institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive në sektorin e punës dhe të punësimit, sigurojnë të drejta dhe mundësi të barabarta për femra dhe meshkuj.<sup>40</sup>

Institucioni i Avokatit të Popullit mbikëqyr, avancojnë dhe mbron të drejtat dhe liritë e banorëve të përhershëm të Kosovës dhe të personave fizikë e juridikë në territorin e Kosovës, për të siguruar që të gjithë personat e tillë të kenë mundësi të ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale, të mbrojtura me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të përfshira në ligjin në fuqi në pajtim me nenin 1.3 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 mbi Ligjin në fuqi në Kosovë dhe paragrafin 3.3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/9 e datës 15 maj 2001), veçanërisht Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Protokollin e saj, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.<sup>41</sup>

Ligji për Barazi Gjinore në Kosovë parasheh edhe dispozitat ndëshkuese për shkeljet e tij.

Në këtë drejtim Neni 16.1. i LBGJ-së përcakton: Punëdhënësi/Punëdhënësja në rast të shkeljes së paragrafit 12.5 të këtij Ligji, dënohet me gjobë prej 1,000 deri në 5,000 Euro. Derisa LBGJ përcakton që: Punëdhënësi/Punëdhënësja, është i/e detyruar të paguajë pagë të njëjtë për femra dhe meshkuj, për punën e njëjtë dhe për punën me vlerë të njëjtë, si dhe siguron kushtet e barabarta të punësimit dhe të punës dhe të gjitha të drejtat e barabarta të punës, Punëdhënësi/Punëdhënësja, i cili nuk zbaton këtë dënohet me gjobë prej 1,000 deri në 5,000 Euro. Ndërsa, Personi përgjegjës, dënohet me gjobë prej 500 deri në 1.500 Euro.<sup>42</sup>

Në rast të përjashtimit nga puna të një të punësuarit/punësuarë në rastin kur ai/ajo kërkon zbatimin LBGJ-së apo përjashtimi nga puna, pushimi i përkohshëm nga puna, padrejtësia lidhur me sigurinë në punë, kushtet e punës ose vlerësimin e punës së tij/saj si pasojë e ankesës së tij/saj për ngacmim seksual ose diskriminim në bazë të gjinisë, Punëdhënësi/Punëdhënësja, dënohet me gjobë prej 5,000 deri në 10,000 Euro ndërsa Personi përgjegjës, dënohet me gjobë prej 1.000 deri 3.000 euro në rast të shkeljes së paragrafit 14.2. të

39 Neni 4, LKD.

40 Neni 12.1-LBGJ

41 Neni 1.1 Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/6 (16 shkurt 2006) mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë.

42 Neni 16 (paragrafi 1 dhe 2) (Dispozitat Ndëshkuese) LBGJ.

## FAQE 23

LBGJ-së i cili përcakton: Ndalohej emetimi i programeve, botimi dhe publikimi i materialeve dhe informatave si dhe shpërndarja e informatave në formën elektronike mbi baza të diskriminimit gjinor. Personat juridik, dënohen me gjobë prej 5,000 deri në 10,000 Euro, ndërsa Personi përgjegjës, dënohet me gjobë prej 1.000 deri 3.000 Euro.<sup>43</sup>

LBGJ (paragrafi 15.7) përcakton që: Pasuria e krijuar gjatë jetës në martesë regjistrohet në regjistrat publik, si pronë e përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve dhe Institucioni që bën regjistrimin e pasurisë në regjistrat publik është i detyruar të veprojë në pajtim me këtë. Institucioni i autorizuar dhe personi përgjegjës për regjistrimin e pasurisë në regjistrat publik, në rast të shkeljes së këtij paragrafi dënohet me gjobë prej 10,000 deri në 20,000 Euro.<sup>44</sup>

Po ashtu edhe Neni 9 i LKD-së parasheh sanksionet për shkeljet e tij. Gjykata kompetente ose organi administrativ që ka konstatuar se është bërë shkelje e LKD-së mund të shqiptojë sanksione varësisht nga natyra dhe lloji i shkeljes si dhe ndikimi i saj në viktimën apo viktimat. Sipas LKD-së (Neni 9.3), gjykata mund të shqiptojë edhe urdhëresa të tjera sipas vlerësimit të saj.<sup>45</sup>

Shqiptimi i cilit do sanksion që parashihet me LKD nuk përjashton shqiptimin e ndonjë ligji tjetër që është në fuqi në Kosovë.<sup>46</sup>

Edhe pse ligji u jep të drejtën femrave për pronë, qiradhënie dhe trashëgiminë e pronës, ligji zakonor nuk e bën këtë. Kjo rezulton në shumë raste me heqjen dorë të femrave nga prona e tyre dhe kështu e vështirësojnë perspektivën e tyre ekonomike.<sup>47</sup>

Ndikimi i së drejtës zakonore akoma në disa raste është i pranishëm.

Ndalohej diskriminimi gjinor me ligj në të gjitha fushat e jetës shoqërore në

---

43 Neni 16 (paragrafi 3) (Dispozitat Ndëshkuese). LBGJ.

44 Neni 16 (paragrafi 3) (Dispozitat Ndëshkuese). LBGJ.

45 Neni 9-LKD. Sanksionet e parapara me vendimin e organit kompetent ndaj personit fizik dhe juridik të cilët cenojnë dispozitat e LKD-së përfshijnë:

a). Kompezimin për dëmin material dhe moral i shkaktuar nga cenimi i dispozitave të këtij ligji, përfshinë kthimin e të drejtave dhe masat e tjera të parapara me legjislacionin në fuqi, e të cilat organi kompetent i vlerëson si të përshtatshme

b). Çdo personi fizik dhe juridik ose kombinim i tyre, i cili ka cenuar dispozitat e këtij ligji, i shqiptohet dënimi me gjobë në bazë të natyrës dhe shkallës së shkeljes, si në vijim:

(i) personi fizik, prej 500 deri 1.000 euro;

(ii) kontraktuesi i pavarur, prej 1.000 deri 5.000 euro;

(iii) personat juridik prej 1.000 deri 10.000 euro;

(iv) personi fizik brenda personit juridik i cili është përgjegjës për shkelje prej 500 deri 2.000 euro;

(v) personi i cili ushtron funksion publik i cili është përgjegjës për shkelje prej 500 deri 2.000 euro;

46 Neni 9.6-LKD.

47 Raporti i Progresit të Kosovës (nën RKSKB-së 1244) për vitin 2005 Komisioni Evropian-Bruksel, 9 nëntor 2005, SEC (2005) 1423, fq..21 ).

Kosovë, është përcaktuar në Nenin 18.2. të LBGJ-së. Po ashtu me këtë Ligj nuk ndalohet zbatimi i ligjeve të tjera në fuqi me të cilat ndëshkohet shkelja e barazisë gjinore.<sup>48</sup>

Mbrojtja gjyqësore e barazisë gjinore është e garantuar. Kjo është përcaktuar në Nenin 18.1 të LBGJ-së.

Por, LBGJ nuk shfuqizon dispozitat ligjore te brendshme që diskriminojnë gratë.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/12 mbrojtja kundër dhunës në familje (Neni 1.2) përcakton: "Dhunë në familje" do të thotë një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në një lidhje familjare.<sup>49</sup>

Në Kosovë, dhuna në familje nuk përbën vepër të veçantë penale. Megjithatë, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/12 Mbrojtja kundër dhunës në familje, në Nenin 1.6 kërkon që disa vepra penale të ndiqen automatikisht në ato kryhen në kontekst të marrëdhënies familjare: Shkelja e urdhrat për mbrojtje, e urdhrat për mbrojtje emergjente ose urdhrat për mbrojtje të përkohshme emergjente do të ndiqet automatikisht. Po ashtu, "nëse është kryer vepra me lëndim të lehtë trupor në kontekstin e dhunës familjare" dhe "nëse është kryer vepra me dëmtim të pasurisë së tjetrit në kontekstin e dhunës familjare", ato ndiqen automatikisht.<sup>50</sup>

Veç kësaj, në pajtim me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës disa vepra penale mund të ndëshkohen me dënime më të larta nëse janë kryer kundër personit me të cilin kryesi i veprës ka marrëdhënie familjare.<sup>51</sup>

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003) Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës në Neni 193 përmban një listë gjithëpërfshirëse të veprave apo shkeljeve të cilat mund të bien në kategorinë e dhunës në familje, nëse kryhen kundër një personi me të cilin kryerësi është apo ka qenë në marrëdhënie familjare.<sup>52</sup>

48 Neni 18.3.-LBGJ.

49 Neni 1.2, Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2003/12 mbrojtja kundër dhunës në familje. Këto janë rastet që konsiderohen si dhunë në familje: (a) Shkaktimi i lëndimit trupor; (b) Marrëdhënia seksuale ose keqtrajtimi seksual pa pëlqim; (c) Qitja e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen e tij apo të saj fizike, emocionale dhe ekonomike; (d) Rrëmbimi; (e) Shkaktimi i dëmeve pasurore; (f) Kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër; (g) Hyrja me dhunë në pronë dhe personit tjetër; (h) Largimi me dhunë i personit tjetër nga banesa e përbashkët; (i) Ndalimi i personit tjetër për të hyrë ose për të dalë nga banesa e përbashkët ose (j) Përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përlules së personit tjetër.

50 Neni 16, Neni 1.2, Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2003/12 mbrojtja kundër dhunës në familje.

51 Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003), Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës. Shih veprat penale në vijim: lëndimet e lehta trupore (Neni 153(4), lëndimet e rënda trupore (Neni 154(3), kërcënimi (neni 161(3)), heqja e paligjshme e lirisë (Neni 162(4), dhunimi (Neni 193(3) 8), sulmi seksual (Neni 195(3) 8), dhe veprat kundër integritetit seksual Neni 196(3) 7). Për definicionin e marrëdhënies familjare në KPPK, shih Nenin 107 (2)(24), KPPK.

52 Neni 193-Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003), Mbi Kodin e Përkohshëm



Po ashtu edhe në kuptim të Nenit 195 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, disa vepra penale mund të ndëshkohen me dënime më të larta nëse janë kryer kundër personit me të cilin kryesi i veprës ka marrëdhënie familjare.<sup>53</sup>

## 2.2 Përputhja e nenit 2 me fakte

Parimi i barazisë mes burrit dhe gruas ekziston në legjislacionin kosovar. Në Kosovë janë edhe një varg mekanizmash institucionale dhe të tjerë për arritjen e barazisë gjinore si: Plani Kombëtar i Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore, Agjensioni për Barazi Gjinore, Zyra për Qeverisje të Mirë,

Penal të Kosovës përmban këtë listë gjithëpërfshirëse të veprave apo shkeljeve të cilat mund të bien në kategorinë e dhunës në familje:(1) Kushdo që e detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë dënohet me burgim prej dy vite deri në dhjetë vjet.

(2) Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual: i) Me forcë; ii) Me kërcënim të rrezikimit të atqashtëm të jetës ose trupit të personit të tillë a të personit tjetër ose iii) Duke shfrytëzuar një situatë në të cilën personi është i pambrojtur dhe siguria e tij është në rrezik; dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni kryhet në një ose me më shumë rrethana të mëposhtme, kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet kur:

Veprës i ka paraprirë, ajo është shoqëruar ose përcjellur nga tortura apo trajtimi çnjerëzor;

Kryerësi shkakton lëndime të rënda trupore ose çrregullim të rëndë për shëndetin fizik a mendor të personit;

Kryerësi përdor armë ose mjet tjetër të rrezikshëm;

Kryerësi me dashje e ka shkakuar dehjen e personit me anë të alkoolit, drogës apo substancave të tjera;

Vepra është kryer bashkërisht nga më shumë se një person;

Kryerësi e di që personi është posaçërisht i ndjeshëm për arsye të moshës së vjetër, çrregullimit fizik a mendor, paaftësisë a shtatzënisë;

Kryerës është prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku, gjyshi ose gjyshja, daja, tezja, vëllai ose motra më e vjetër e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetëvjeçare;

Kryerësi është në marrëdhënie familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetëvjeçare.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në njëzet vjet.

(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e viktimës, kryerësi dënohet me së paku 10 vjet burgim apo me burgim afatgjatë.

53 Neni 195-Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003), Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës. përcakton:

(1) Kushdo që e prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër të prekë kryerësin ose personin e tretë me qëllim seksual pa pëlqimin e personit tjetër të tillë dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

8) Kryerësi është në marrëdhënie të përbashkët familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në dhjetë vjet.

(5) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e viktimës, kryerësi dënohet me burgim së paku dhjetë vjet apo me burgim afatgjatë

Këshilli Ndërmintor për Barazi Gjinore, Zyrtaret/ët për Barazi Gjinore në Ministri dhe në Komuna, Njësia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Ombudspersonit, Njësitë për të drejtat e Njeriut në të gjitha ministrinë.

Teksti i CEDAW nuk është përkthyer në gjuhët zyrtare të Kosovës megjithatë, një variant jo zyrtar është botuar në Gazetën Zyrtare të UNMIK-tu<sup>54</sup>

Institucioni i Avokatit të Popullit është i autorizuar që të pranojë dhe hetojë ankesat që kanë të bëjnë me rastet e diskriminimit. Veç kësaj, qeveria është përgjegjëse që të udhëheq fushatat për ngritjen e vetëdijes kundër diskriminimit. Së fundi janë duke u organizuar edhe trajnime specifike për gjyqtarë dhe prokurorë mbi përdorimin praktik dhe të vazhdueshëm të ligjit kundër diskriminimit.

Që nga viti 2006 kur Institucioni i Avokatit të Popullit është transferuar në kompetenca vendore, UNMIK-u nuk ka më mandat që të hetojë rastet e diskriminimit që përfshijnë agjenci apo individë ndërkombëtarë. Në raportin e këtij Institucioni është konkluduar se kishte patur shkelje të të drejtës së aplikanteve për qasje në gjykatë, ashtu siç garantohej me nenin 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Gratë që kishin punuar për Hekurudhat e UNMIK-ut dhe të cilat u ankuan se ishin përjashtuar nga puna në mënyrë diskriminuuese, nuk mund ta dërgonin lëndën e tyre në gjykatë për shkak se Hekurudhat e UNMIK-ut, pjesërisht menaxhoheshin nga personeli i UNMIK-ut, të cilët sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47, gëzojnë imunitet kundrejt procedurave civile dhe penale.<sup>55</sup>

Edhe pse ligji u jep të drejtën grave për pronë, qiradhënie dhe trashëgiminë e pronës, e drejta zakonor nuk e bën këtë. Ndikimi i së drejtës zakonore akoma në disa raste është i pranishëm në Kosovë.<sup>56</sup>

54 [http://www.unmikonline.org/albanian/regulations/index\\_alb.htm](http://www.unmikonline.org/albanian/regulations/index_alb.htm)

55 Zbatimi i ligj kundër diskriminimit, Sfidë për Kosovën, Qershor 2007

56 Normat sociale të bazuara në traditë dhe në kode jozyrtare, siç është për shembull "Kanuni i

Lekë Dukagjinit" shpeshherë ndërhyjnë në zbatimin e vendimeve të gjykatës lidhur me dhunën me ndarjen e pronës. Vendimi për të filluar procedurë të ndjekjes në interes publik është një faktor vështirësues sepse ngatërrohet me vlerat tradicionale të kodeve jozyrtare. Kodi i Lekë Dukagjinit, ose thjeshtë "Kanuni" (ose "Canon" në gjuhën angleze), është një tërësi ligjesh të hartuara nga Lekë Dukagjini dhe të përdorura kryesisht në Shqipërinë e veriut nga shekulli i 15-të deri në shekullin e 20-të dhe i ringjallur së voni pas rënies së regjimit komunist në fillim të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar. Kjo ishte një tërësi e ligjeve zakonore, e bartur brez pas brezi dhe e pakodifikuar dhe e pashkruar deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Për herë të parë këtë kod e kompiloni Atë Shtjefën Gjeçovi. Megjithatë Kanuni i atribuohet princit shqiptar Lekë Dukagjinit, rregullat e tij kanë evoluuar me kalimin e kohës me qëllim që të vendoset rendi në këto troje. Kanuni ishte i ndarë në disa pjesë: Kisha, Familja, Martesa, Shtëpia, Kafshët dhe Prona, Puna, Bartja e Pronës, Fjala e Dhënë, Nderi, Dëmshtëpërlimi, Ligji lidhur me krimet, E drejta juridike, dhe Lëshimet e Përgjashtimet.

Kjo rezulton në shumë raste me heqjen dorë të grave nga prona e tyre dhe kështu e vështirësojnë perspektivën e tyre ekonomike.

Gjithashtu, çështja e pagave të barabarta, nënkupton edhe një vlerësim apo stimulim të njëjtë të gjinive. Për të arritur këto rezultate, në Kosovë nevojitet shumë punë për tu bërë. Aktualisht, burrat në Kosovë fitojnë rreth katër herë më shumë se gratë (134 Euro me 42 Euro në muaj) dhe gratë në përgjithësi kanë pozita të cilat paguhen më pak. Dallimi bëhet në bazë të mundësive për punësim si dhe shkollimit paraprak. Përderisa 75 % të burrat marrin pjesë në fuqinë punëtore, te gratë kjo pjesëmarrje është 31 %. Burrat kanë në përgjithësi dy vjet më shumë shkollim së gratë, edhe regjistrimi në shkollë fillore dhe të mesme është më i lartë të burrat se sa te gratë, përderisa analfabetizmi është më i theksuar të gratë se të burrat<sup>57</sup>.

Ligji nuk e specifikon lejimin e mbajtjes së mbulesës së kokës nga gratë në institucionet publike. Kjo ka shkaktuar shpesh dilema dhe ka nxitë debate lidhur me atë se a duhet lejuar mbajtja e mbulesës së kokës në institucionet publike dhe veçanërisht në shkolla dhe universitet. Në mediat kosovare kohëve të fundit ka pasur një debat lidhur me mbajtjen apo jo të mbulesës së grave në institucionet publike. Për këtë çështje gjatë një debatit televiziv<sup>58</sup> është diskutuar lidhur me pengesat dhe sfidat me të cilat ballafaqohet një grua e mbuluar. E pyetur nëse mbajtja e mbulesës është një hendikep gjatë përditshmërisë së saj, studentja e psikologjisë e cila bartë mbulesë, shpjegoi se “mbulesa e tërheqë më shumë vëmendjen e njerëzve por se kjo nuk e ndalon atë që të jetojë një jetë normale.

Gjatë këtij debati Visare Gorani-Gashi, Shefe e Agjencionit për Barazi Gjinore, mendon se gratë që punojnë në institucione duhet të veshin rroba zyrtare. Ajo shpreh bindjen se “Një grua e mbuluar e cila punon në institucione do të tërheqë më shumë vëmendje të padëshirueshme se sa gratë e veshura në mënyrë të zakonshme. Vetëm një përqindje e vogël e grave në Kosovë janë të mbuluara” thekson Gashi.

Për shkak të mungesës së gjykatës së familjes dhe gjykatës për të miturit, njohuritë mbi të drejtat për këto dy kategori mund të jenë të kufizuara. Për dhunën në Familje janë mbajtur disa trajnime mbi barazinë gjinore. Me anë të trajnimeve gjykatësit/et, dhe juristët/et, kanë marrë informacion të detajuar mbi përmbajtjen e Ligjit për Barazi Gjinore dhe rëndësinë e tij në lidhje me legjislacionin.

Sipas Kryetarit të Gjykatës së Gjilanit ka raste ku është aplikuar edhe konventa për të drejtat e njeriut dhe ka pasur raste kur jam thirrur në konventa ndërkombëtare. p.sh unë personalisht e kam pasur një palë. “Ku çiftet bashkëshortor kanë dashur të bëjnë shkurorëzimin. Avokati që çiftet e ka përzgjedhur ka qenë për gruan dhe burrin dhe kërkesa ime ka qenë që të merret edhe një avokat tjetër dhe që të dyve të ju mbrohen interesat e tyre. Për

57 Indeksimi i UNDP

58 RTK Emisioni Jeta në Kosovë

këtë rast unë jam thirr në konventën për të drejtat e njeriut”

Numri i rasteve nga viti në vit nuk ka ndonjë dallim drastik, mirëpo në rast se krahasohet numri i rasteve të dhunës në familje të vitit 2002 (1.273) me atë të vitit 2006 (1.371), vërehet se dhuna në familje në këtë vit (2006) është rritur për 98 raste.

Bazuar në të dhënat e marra nga SHPK-ja, kjo dukuri më shumë prekë gratë sesa burrat. Prej 1.370 rasteve në vitin 2005, 1.107 ose 81 përqind janë gra dhe vetëm 19 përqind janë burra. Ndërkaq, për vitin 2006 numri i viktimave është 77 përqind gra dhe 23 përqind burra. Po ashtu janë regjistruar 78 raste të dhunës në familje në të cilat viktimat kanë qenë fëmijët.

Sipas Tahire Haxhollit, zyrtare për dhunë në familje në SHPK<sup>59</sup>, në të shumtën e rasteve, gratë janë viktimat të dhunës në familje si rezultat i mosbarazisë ndërmjet burrit dhe graas.

Të dhënat e vitit 2006 tregojnë që burrat janë të “përfaqësuar” në ushtrimin e dhunës në 92 përqind të rasteve, përderisa gratë ushtrijn dhunë në masën 8 përqind të rasteve.

Dhuna në familje më së shpeshti është e shprehur ndër çiftet bashkëshortore. Megjithatë, rastet e dhunës në familje natyrisht nuk kufizohen vetëm në relacionet bashkëshortore. Prandaj, dhuna në familje ka një shtrirje më të gjerë dhe marrëdhënia familjare në mes të viktimës dhe të kryesit prekë edhe relacione të tjera brenda familjes së gjerë.

Flora Macula nga UNIFEM-i, thotë se dhuna në familje nuk është trajtuar nga qeveria, por nga shoqëria civile. Sipas saj, kjo ka krijuar mundësinë në rritjen e vetëdijes të gratë, për të raportuar dhunën në institucionet relevante dhe për ta zhvendosur këtë çështje nga sfera e mbyllur private në atë publike.

Tahire Haxholli, zyrtare në sektorin e dhunës në familje në SHPK, tregon se ka trende të rritjes së raportimit të dhunës në familje, por jo të dhunës.

Adile Basha, udhëheqëse e sektorit për mbrojtjen e familjes në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mendon se dhuna në familje është një problem social që ekziston ndër shekuj dhe Kosova nuk është vendi i parë në botë që po përballet me këtë dukuri<sup>60</sup>

Edhe Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv në KMDLNJ, gjenezën e dhunës në familje e nxjerr të hershme në shoqërinë kosovare. “Shumica e shqiptarëve, gran dhe fëmijët i kemi konsideruar si pronë private. Meqë kemi pas një trajtim të tillë, atëherë i kemi dhënë të drejtë vetes që sipas vlerësimeve tona të marrim

59 Intervistë me Tahire Haxholli, Zyrtare për Dhunë në Familje në Shërbimin Policor të Kosovës. 06.07.2007

60 Intervistë me Adile Bashën, udhëheqëse e Sektorit për Mbrojtjen e Familjes, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. 11.07.2007. Prishtinë,

## FAQE 29

edhe masa ndëshkuese ndaj tyre. Pra, në qoftë se ne e kemi rrah gruan, kemi konsideruar se meqë jemi burra na takon edhe nga natyra, edhe nga Kanuni, edhe nga Zoti"<sup>61</sup>, shprehet Shala.

Raporti i OSBE-së "Raport mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë"<sup>62</sup> tregon që problemi kryesor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje është vonesa e paligjshme në marrjen e vendimit mbi kërkesat për urdhër dhe mbrojtje apo caktim të seancave gjyqësore, ngaqë sipas Rregullores, kërkesa për mbrojtje duhet të vendoset brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e marrjes së kërkesës nga gjykata<sup>63</sup>

Sipas Behar Selimit "Për luftimin e dhunës në familje nuk mund të mbështetemi vetëm në polici. Policia arrin ta largojë viktimën nga vendi ku shkaktohet dhuna, por nuk ka infrastrukturë në Kosovë për t'u kujdesur për sigurinë e tyre"<sup>64</sup>

### III. NENI 3

---

#### Neni 3.

Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke përfshirë edhe legjislacionin, për të siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave me qëllim që t'u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut mbi bazën e barazisë me burrat.

---

#### 3.1 Përputhja e nenit 3 me ligje

---

Qeveria e Kosovës, më 11 tetor 2005, ka miratuar Planin e veprimit për zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit (Vendimi nr. 4/170) i cili "përcakton parametrat e aktiviteteve të kufizuara në kohë, përgjegjësitë e vepruesve/institucioneve të angazhuara si dhe propozimet për hartimin e një përkrahimi të detajizuar të nevojave të financimit për zbatimin e Planit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe nga donatorët."<sup>65</sup>

#### 3.2 Përputhja e nenit 3 me fakte

---

Qeveria e Kosovës, në vitin 2004 ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit

---

61 Intervistë me Behxhet Shalën,

62 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misionë në Kosovë (OSBE) "Raport mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë", korrik 2007

63 Neni 7 (1) rregullores

64 "Siguria e Kujt", dokumentarë. Intervista e dhënë nga Behar Selimi.

65 Shih Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 4/170, 11 tetor 2005, me të cilin miratohet Plani i Veprimit Gjithëpërfshirës për Zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit.

për Arritjen e Barazisë Gjinore. Ky plan paraqet rekomandimet për adresimin e problemeve dhe të çështjeve specifike të kontrasteve gjinore në Kosovë. Si një mekanizëm për barazi gjinore, Plani Kombëtar i Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore është hartuar në pajtim me nevojat e grave të Kosovës dhe është disenuar në atë mënyrë që të mund të pasqyrojë përpjekjet vendore në lidhje me kontekstin e lëvizjeve ndërkombëtare për avancimin e statusit të grave, si dhe me qëllim të propozimit të hapave konkretë për rrugën që duhet të marrë Kosova drejt barazisë dhe zhvillimit.<sup>66</sup>

#### IV. NENI 4

##### Neni 4.

1. Miratimi i masave të përkohshme të veçanta nga shtetet palë që synojnë përshejtimin de facto të barazisë midis burrit dhe gruas, nuk konsiderohet diskriminim, siç është përkufizuar në këtë Konventë, por në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë për pasojë ruajtjen e normave të pabarabarta apo të veçanta. Këto masa duhet të ndërprehen kur të jenë arritur objektivat e barazisë së mundësive dhe të trajtimit.
2. Miratimi i masave të veçanta nga shtetet palë, duke përfshirë ato masa të cilat i përmban kjo Konventë, që kanë për qëllim mbrojtjen e maternitetit nuk konsiderohet akt diskriminues

##### 4.1 Përputhja e nenit 4 me ligje

Siç është përcaktuar në LBGJ, “masat ligjore janë masa të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së plotë të femrave dhe meshkujve në shoqëri, të cilat japin përparësi specifike në mënyrë që pjesëtarëve të gjinisë së caktuar t’u mundësohet qasje e barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, të mënjanohet pabarazia gjinore ekzistuese, ose t’u sigurohen të drejta të cilat më herët nuk iu kanë takuar”.<sup>67</sup>

Masat e përgjithshme janë masa të natyrës normative, përmes të cilave diskriminimi gjinor parandalohet me anë të ligjeve të cilat i rregullojnë fushat e veçanta, sjelljet në rrethana të caktuara apo qasjen e duhur për garantimin e trajtimit të barabartë gjinor, siç janë ndëshkimet që duhet ndërmarrë ndaj individëve në rast të shkeljes së këtyre kufizimeve ose kërkesave.<sup>68</sup>

Masat e veçanta janë masa të përkohshme të cilat kanë për qëllim garantimin e të drejtave të barabarta gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në

<sup>66</sup> Shih, Planin kombëtar të veprimit për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, Qeveria e Kosovës, Prishtinë, 2004.

<sup>67</sup> Neni 2.9-LBGJ.

<sup>68</sup> Neni 2.10-LBGJ.

## FAQE 31

fushat specifike të jetës shoqërore, në të cilat është identifikuar përfaqësimi i pabarabartë gjinor apo pozita e pabarabartë e personave që i përkasin njëres gjini.<sup>69</sup>

Në Kosovë janë shumë të pakta masat e përkohshme me anë të legjislacionit për përafrimin e barazisë ndërmjet burrave dhe grave.

Me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së barabartë të femrave dhe të meshkujve ashtu siç është përcaktuar në nenin 3 (3.1 dhe 3.2) të Ligjit për Barazinë Gjinore në Kosovë, Ministria e Shërbimeve Publike të Kosovës ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 2007/03-MSHP masat për arritjen e barazisë gjinore në institucionet e administratës publike gjatë vitit 2007. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet në të gjitha institucionet e administratës publike. Në kuptim të Nenit 3, të këtij udhëzimi administrativ: Të gjitha institucionet e administratës publike janë të obliguara që të marrin masa të përkohshme (të veçanta) gjatë vitit 2007, që synojnë përshtetimin e vendosjes së barazisë gjinore, duke mos u kufizuar vetëm në këto masa të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.<sup>70</sup>

### 4.2 Përputhja e nenit 4 me fakte

---

Ndonëse në Kosovë janë hartuar një sërë ligjesh dhe strategjish për mbrojtjen e lirive njerëzore të grave dhe vajzave, problemi më i madh qëndron në implementimin dhe respektimin e tyre

Legjislacioni mbi çështjet e barazisë gjinore duhet t'i adaptohet edhe më tej situatës ekzistuese në Kosovë. Agjencia për Barazi Gjinore ka nevojë për kapacitete, legjitimitet dhe status më të qartë. Këto probleme institucionale kanë ndikim të kundërt në gjendjen e gruas në Kosovë, e cila është e karakterizuar me dhunë familjare dhe diskriminim ekonomik.

## V. NENI 5

---

### Neni 5

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme:

(a) Për të ndryshuar karakteristikat dhe modelet sociale e kulturore të sjelljes së burrit dhe të gruas, në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paragjykimet dhe praktikat zakonore, dhe të gjitha praktikat e tjera që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njërit apo të tjetrit seks, ose në rolet stereotipe të burrit dhe të gruas;

---

<sup>69</sup> Neni 2.11-LBGJ.

<sup>70</sup> Neni 3 Udhëzim Administrativ nr. 2007/03-MSHP masat për arritjen e barazisë gjinore në institucionet e administratës publike gjatë vitit 2007.

(b) Për të siguruar që edukimi i familjes të përfshijë të kuptuarit e duhur të maternitetit si një funksion social dhe të njohjes së përgjegjësisë së përbashkët të burrit dhe të gruas në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre duke bërë të qartë se interesi i fëmijëve është kusht kryesor në të gjitha rastet.

---

## 5. Përputhja e nenit 5 me fakte

---

Mekanizmat e Qeverisë së Kosovës nuk kanë organizuar ndonjë fushatë mbarëkombëtare për të adresuar eliminimin e diskriminimit ndaj gruas. Pjesa më e madhe e fushatave dhe trajnimeve janë ndërmarrë nga OJQ-të e grave në Kosovë, të cilat kanë pasur synim zbutjen e stereotipeve dhe paragjyqimeve në baza gjinore.

Gratë kanë më shumë fuqi vendimmarrëse rreth fëmijëve dhe edukimit të tyre, blerjes së gjërave për familje dhe rreth menaxhimit të punëve të përditshme shtëpiake. Në anën tjetër, burrat marrin vendime që janë drejtpërdrejt të lidhura me buxhetin familjar, martesë e fëmijëve, leja për punë dhe ndikimi në zgjedhjen e punës për gruan, shitblerja e patundshmërive, shitblerja e pajisjeve dhe mjeteve shtëpiake, etj.<sup>71</sup>

Nëse këto marrëdhënie familjare ngrihen në rrafshin e përgjithshëm shoqëror, mund të thuhet se ato reflektohen edhe në ekonominë e tregut të punës. Gratë nuk e shohin veten në proceset makroekonomike, udhëheqje të biznesit ose në pozitë vendimmarrëse, por në profesione të tjera, të cilat reflektojnë rolin e tyre në familje dhe më pak në profesionet të cilat shoqëria i identifikon si të "burrave".

Në Kosovë nuk është bërë shumë për ndarjen e barabartë të përgjegjësisë mes prindërve për kujdesin ndaj fëmijëve. Gratë mbajnë ende peshën kryesore, pavarësisht nga fakti që ato mund të jenë të punësuar edhe jashtë shtëpisë. Për shembull, me ligjin e punës, në fuqi, parashihet që "nëpunësit civil meshkuj kanë të drejtë në dy ditë pushim atësie, për lindjen e çdo fëmije". Pushimi prindëror edhe për burrat me rastin e lindjes së fëmijut do të ndikonte pozitivisht në përkrahjen e burrave për të marrë më shumë përgjegjësi në kujdesin ndaj fëmijëve si dhe përmirësimin e pozitës së grave në tregun e punës.

Duke pasur parasysh rolin dhe ndikimin që kanë mediat në krijimin e opinionit publik, grupi i ekspertëve<sup>72</sup> për çështje gjinore dhe legjisacioni konsideron se "Mediat në Kosovë, në një masë të madhe i forcojnë stereotipet gjinore, duke paraqitur gratë në mënyrë diskriminuese. Në mediat elektronike dhe

---

71 Justina Shiroka-Pula, PJESËMARRJA E GRAVE NË TREGUN E PUNËS NË KOSOVË (Analizë krahasuese dhe hulumtim empirik)

72 Qendra Kosovare për Studime Gjinore, ka organizuar një diskutim në grup me ekspertë të të drejtave të njeriut, çështjeve gjinore dhe legjisacionit, përfaqësues të instancioneve qeveritare dhe shoqërisë civile.



## FAQE 33

të shkruara, gruaja kryesisht paraqitet si objekt erotik ose paraqitet në rolet e saj tradicionale, si nënë, amvise, bashkëshorte, ose në profesione të cilat tradicionalisht konsiderohen të grave.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka hartuar një Plan Strategjik të Veprimit, në vitin 2004 - 2005 "Përfshirja e perspektivës gjinore në arsim", dhe Objektiv 2 i këtij Plani parasheh përfshirjen e perspektivës gjinore në planprograme dhe në tekste shkollore. Përkundër këtij fakti, paragjykimet dhe stereotipet gjinore vazhdojnë të jenë prezentë në shumë tekste shkollore.

Grupi i ekspertëve që morën pjesë në diskutim u pajtuan se për luftimin e këtyre stereotipeve dhe paragjykimeve në mediat kosovare duhet të ekzistojë një mekanizëm apo grup i aktivisteve që do të reagonin dhe të padisnin mediat me qëllim që këto çështje të lokalizohet dhe të luftohen.

## VI. NENI 6

### Neni 6

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme, duke përfshirë legjislacionin, për luftimin e të gjitha formave të trafikut të grave dhe të shfrytëzimit të prostitucionit të grave

### 6.1 Përputhja e nenit 6 me ligje

Më kuptim të Nenit 192 (7) të rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003), Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, shprehja "prostitucion" do të thotë ofrimi ose dhënia e shërbimeve seksuale në këmbim me të holla, me mallra ose me shërbime.<sup>73</sup>

Mundësimi i prostitucionit, është vepër penale i cili është përcaktuar ne Nenin 201 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës:

(1) Kushdo që me dije rekruton, organizon ose ndihmon një person tjetër apo ia lëshon lokalet një personi tjetër për qëllime të prostitucionit dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 kryhet brenda një rrethi prej 350 metrash nga shkolla ose mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

<sup>73</sup> Neni 140 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës Shprehja "shfrytëzim" ashtu siç është përdorur në pikën 1 të këtij paragrafi, përfshin ndër të tjera shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve.

(3) Kushdo që me dhunë, me kërcënim se do ta përdorë dhunën ose duke mbajtur personin tjetër në situatë të varësisë personale a ekonomike e detyron personin tjetër të merret me prostitucion dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.

(4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet kundër personit të moshës mes gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 kryhet kundër personit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet.

(5) Afati i parashkrimit të ndjekjes së veprës penale nga paragrafi 4 fillon të rrjedhë ditën kur viktimja i mbush tetëmbëdhjetë vjet.<sup>74</sup>

Në kuptim të Kodit të përkohshëm penal, shprehja “trafikim me njerëzit” do të thotë rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.<sup>75</sup>

Me qëllim të krijimit të një legjislacioni të veçantë për ndjekjen dhe ndëshkimin e kryerësve të krimeve të trafikimit të njerëzve dhe veprat e tjera penale të lidhura me të si dhe ndihma dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit si dhe veprat penale të lidhura me të është shpall Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/4 (12 janar 2001) mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë.

Në kuptim të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë: “trafikimi me njerëz” do të thotë rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi, ose pranimi i personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose me anë të formave të tjera të shtrengimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthitjes, keqpërdorimit të autorizimit ose të pozitës së dobësisë, ose me anë të dhënies ose të pranimit të pagesave ose të beneficioneve për të arritur pëlqimin e ndonjë personi që ka kontroll mbi një person tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.

Po ashtu me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë (Neni 2.1-2.5) janë paraparë edhe dënimet në rastet e trafikimit me njerëz.<sup>76</sup>

74 Neni 201 (Mundësimi i prostitucionit) Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës

75 Neni 139 dhe neni 140 (8) Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës.

76 Neni 2, Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë.

Neni 2.1-2.5 parashih dënimet në rastet e trafikimit me njerëz si në vijim:

2.1 Çdo person që merret ose tenton të merret me trafikim me njerëz kryen veprë penale dhe pas shpalljes fajtor i nënshtrohet dënimit prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet burg. 2.2 Në rast se viktimja e trafikimit është nën moshën 18 vjeçare, dënimi maksimal për personin që merret me trafikim

## FAQE 35

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron një Koordinator për Ndhimë Viktimave i cili është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Rregullores mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë. Koordinatori për Ndhimë Viktimave ndërlidhet me autoritetet përkatëse e zbatimit të ligjit, me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare ose me organizata të tjera si dhe me departamente administrative sipas nevojës. Shpenzimet që dalin nga zbatimi i kësaj rregulloreje financohet, varësisht nga mjetet në dispozicion, nga kontributet e donatorëve që jepen posaçërisht për këtë qëllim dhe të shënuara si grante të shënuara të donatorëve në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Koordinatori për Ndhimë Viktimave mund të kërkojë edhe para të tjera për këto qëllime në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.<sup>77</sup>

Me qëllim të qartësimit të përgjegjësive të koordinatorit të ndihmës së viktimit, të themelimit të fondeve për dhënien e ndihmës financiare dhe kompensimit për viktimat e trafikimit, krijimit të një komisioni për rishikim për hulumtimin e vendimeve të koordinatorit për ndihmë viktimave dhe dhënies së ndihmës shtesë për viktimat e trafikimit dhe dëshmitarëve jashtë Kosovës, PSSP-ja ka shpall Urdhëresën administrative Nr. 2005/3 (11 shkurt 2005) për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë.

Neni 1 i Urdhëresës administrative Nr. 2005/3 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë, përshkruan fushëveprimin e Koordinatorit për ndihmë të viktimave si në vijim: Koordinatori për ndihmë viktimave ("Koordinatori"), të cilin e emëron Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në pajtim me nenin 9.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 do të caktohet për Departamentin e Drejtësisë.<sup>78</sup>

---

është deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet burg. 2.3 Çdo person që organizon ndonjë grup të personave me qëllim të kryerjes së veprave të përmendura në paragrafët 2.1 dhe 2.2 pas shpalljes fajtor i nënshtrohet dënimit prej pesë (5) deri në njëzet (20) vjet burg. 2.4 Çdo person i cili pakujdesia kryen ndihmon kryerjen e trafikimit me njerëz kryen veprë penale pas shpalljes fajtor i nënshtrohet dënimit prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet burg

<sup>77</sup> Shih Neni 9 dhe 10 Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë.

<sup>78</sup> Neni 1, Urdhëresa administrative Nr. 2005/3 (11 shkurt 2005) për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë, në mes tjerash parasheh edhe përgjegjësitë e Koordinatorit për Ndhimë Viktimave.: (a) në koordinim me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa zhvillon një strategji për marrjen e fondeve, mes tjerash, nga gjobat e gjykatave, nga prona e konfiskuar (në pajtim me nenin 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4), nga kontributet individuale apo të dhuruara, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe nga burime të tjera; (b) Krijon mekanizma për dhënien e ndihmës financiare dhe kompensimit për viktimat e trafikimit në formë të fondeve; (c) Vendos kriteret dhe procedurat për vlerësimin e kërkesave të dorëzuara nga viktimat e trafikimit për ndihmë dhe kompensim, për marrjen e vendimeve rreth kërkesave të tilla dhe për lehtësimin e dhënies së ndihmës ë tillë; (d) Ofron ndihmë për viktimat e trafikimit që marrin pjesë në seanca gjyqësore në pajtim me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4; (e) Koordinon me autoritetet e UNMIK-ut dhe palët tjera relevante politikat dhe veprimet që ndërlidhen me trafikimin e

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, në Nenin 139, përcakton si vepër të veçantë penale trafikimin me njerëz:

(1) Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18- vjeçare, kryerësi dënohet me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.

(3) Kushdo që organizon një grup personash për të kryer vepër nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

(4) Kushdo që nga pakujdesia lehtëson kryerjen e trafikimit me njerëz dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

(5) Kushdo që përdor ose siguron shërbime seksuale të një personi për të cilin e dinë se personi i tillë është viktimë e trafikimit, dënohet me burgim prej tre muaj deri në pesë vjet.

(6) Nëse vepra penale nga paragrafi 5 i këtij neni kryhet kundër personit nën moshën 18- vjeçare, kryerësi dënohet me burgim prej dy deri në dhjetë vjet.

(7) Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës së tij kryerësi dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafët 1 ose 2, me burgim prej së paku dhjetë vjetësh për veprën penale nga paragrafi 3, me burgim prej dy deri në shtatë vjet për veprën penale nga paragrafët 4 ose 5 ose me burgim prej pesë vjetësh deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale nga paragrafi 6.<sup>79</sup>

## 6.2 Përputhja e nenit 6 me fakte

Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem kompleks i cili ngërthen në vete shumë aspekte të rëndësishme të mënyrës së funksionimit të shoqërisë. Nëse trafikimi analizohet në kontekstin e një vendi me probleme të shumta

njerëz; (f) Nxjerr raport gjysmëvjetor mbi trafikimin me njerëz në Kosovë, duke përfshirë të dhëna rreth madhësisë së problemit dhe numrit, statusit dhe gjendjes së lëndëve që janë ndjekur penalisht sipas Ligjit penal në fuqi; (g) Ngrit vetëdijen rreth çështjes së trafikimit me njerëz në Kosovë dhe të drejtave të viktimave të trafikimit; (h) Kërkon këshilla rreth lëndëve dhe çështjeve që ndërliiden me trafikimin e njerëzve që janë të mitur, të sëmurë mentalisht apo të paaftë në ndonjë mënyrë tjetër dhe (i) Nën mbikëqyrjen dhe, varësisht nga leja e ZPSSP-së për Polici dhe Drejtësi, bashkëpunon në suaza të përpjekjeve rajonale dhe ndërkombëtare për luftimin e trafikimit dhe për dhënien e ndihmës viktimave të trafikimit. Në ushtrimin e përgjegjësisë së tij, koordinatori punon ngushtë me autoritetet e UNMIK-ut, autoritetet për zbatimin e ligjit, Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare dhe palët tjera relevante, sipas nevojës.

<sup>79</sup> Neni 140-Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003), Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës

dhe të vazhdueshme, siç është Kosova, atëherë kjo çështje bëhet edhe më e ndërlikuar. Sidoqoftë, një qasje e përshtatshme për ta krijuar një ide fillestare rreth gjendjes së trafikimit në Kosovë duket të jetë përzgjedhja dhe përqendrimi në disa elemente të rëndësishme siç janë: arsyet e rritjes së shkallës së trafikimit, niveli i efektivitetit të instancave përgjegjëse për luftimin e tij dhe mendimet e kompetenteve për fushatat e vetëdijesimit dhe mundësitë e rehabilitimit të viktimave.

Sipas Raportit të Progresit (2007)<sup>80</sup>, Kosova është ende destinacion dhe transit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Në këtë raport theksohet se në praktikë ka vetëm bashkëpunim të kufizuar në mes sektorit kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe njërive rajonale. Shumica prej këtyre të fundit kanë numër të vogël të stafit të gjinisë femërore dhe ato nuk janë të përgatitura mirë për detyrat e tyre. Për më tepër, stafi i njërive rajonale shpesh angazhohet për punë tjera që nuk kanë të bëjnë me luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Për më tepër, efikasiteti në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dallon shumë nga një rajon në tjetri.

Sipas definicionit zyrtar, "Njësi Antitrafikim është njësit brenda Shërbimit Policor të Kosovës, misioni i të cilit është luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore në tri drejtime: parandalim të krimit dhe veprave të tilla, ndjekje të kryesve dhe prezantimi i fakteve në gjykatë dhe mbrojtje dhe asistencë të viktimave të trafikimit"<sup>81</sup>

Në raportin e punës së këtij Njësi për periudhën janar - qershor 2007<sup>82</sup>, thuhet se në disa rajone ka mungesë të personelit, si dhe në përgjithësi struktura e organizimit të këtij njësi është e paqartë.

Sa i përket lokaleve të dyshuara për zhvillim ilegal të prostitucionit, janë kontrolluar 591 të tilla dhe 10 të tjera janë mbyllur. Sipas këtij raporti janë intervistuar 46 persona për dyshim të trafikimit me njerëz, 15 për kundërvajtje "emigrim" dhe 83 dëshmitarë.

Në kuadër të operacioneve të këtij Njësi, në tërë Kosovën janë bërë 91 vëzhgime, 37 operacione të fshehta, 56 operacione të përbashkëta me njësi të tjera dhe 15 operacione me komuna.

Pjesëtarët e Njësitit në periudhën janar - qershor 2007, kanë arrestuar gjithsej 26 persona, prej tyre 18 burra dhe 8 gra. Sa u përket rasteve, në këtë periudhë kohore ka pasur 29 raste të reja, 13 raste të dorëzuara në gjykatë, 10 raste të mbyllura dhe 17 raste nën hetime.

Në vitin 2007 është e dukshme rritja e shifrave të grave dhe vajzave vendore në trafikim të brendshëm dhe në atë jashtë Kosovës.

---

80 Raportit të Progresit (2007)

81 Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), Web-faqja zyrtare: <http://www.kosovopolice.com/>

82

Vetëm në periudhën janar - qershor 2007 janë identifikuar 19 viktime të trafikimit<sup>83</sup>. Prej tyre 9 janë kosovare, 6 janë shtetase të Shqipërisë, 2 janë nga Moldavia, 1 është shqiptare nga Maqedonia dhe 1 është shqiptare nga Serbia. Prej 19 viktimeve, 13 prej tyre u është ofruar ndihma e institucioneve, ndërsa 6 të tjera janë riatdhesuar.<sup>84</sup>

Mendim për rritjen e numrit të viktimeve vendore të trafikimit kanë edhe dy zyrtare që merren me këtë çështje.

Sipas Violeta Krasniqit, zyrtare për barazi gjinore në kuadër të zyrës së Ombudspersonit, pas luftës në Kosovë është rritur numri i viktimeve të trafikimit. “Në vitet e para të pasluftës, viktimat e trafikimit kanë qenë kryesisht ndërkombëtare por, fat të keq kohëve të fundit kemi informata që viktime e trafikimit janë edhe gratë dhe vajzat tona”, ka deklaruar Krasniqi.<sup>85</sup>

Një gjë të tillë e pohon edhe Virgjina Dumnica, nga zyra e UNDP-së në Kosovë: “Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, në Kosovë ka pasur shumë gra të trafikuar nga shtetet tjera, si nga Moldavia, mirëpo tani kjo gjendje ka ndryshuar, pasi aktualisht kemi rritje të numrit të kosovareve të cilat po trafikohen. Urgjentisht duhet që të problematizohet çështja e trafikimit të brendshëm dhe të shqyrtohen mënyrat se si mund t’ju ndihmohet vajzave të cilat po trafikohen brenda Kosovës. Kjo veçanërisht po ndodhë në rajonin e Ferizajt dhe në një pjesë të Prizrenit, që ka numrin më të madh të rasteve”.<sup>86</sup>

Qëndrimin më të ashpër në identifikimin e shkaqeve të rritjes së shkallës së trafikimit të brendshëm e ka Behxhet Shala, drejtor i KMLDNJ-së. Sipas tij, “shkalla e trafikimit është ngritur kryesisht pas luftës, me ardhjen e ndërkombëtarëve, ngase zakonisht ku ka forca të mëdha policore dhe ushtarake të huaja dhe administratë ndërkombëtare ndihet edhe nevoja për trafikim”. Ai shton se ndërkombëtarët e kanë fajin për trafikim, sepse në vend që të krijojnë mekanizma për parandalimin e trafikimit, ata merren me pasojat, duke i ekstraduar, apo duke i strehuar përkohësisht femrat të cilat kanë qenë viktime të trafikimit. “Ndërkombëtarët janë ata të cilët kanë ndihmuar në lulëzimin e trafikimit. Ata e kanë udhëhequr trafikimin dhe nuk kanë ndërmarrë masa për parandalimin e tij”, shprehet Shala.

Edhe Ariana Qosja - Mustafa, nga OSBE, e përmend militarizimin e madh të Kosovës si një ndër shkaqet e rritjes së shkallës së trafikimit. Sipas saj, “në fillim kryesisht ndërkombëtarët kanë qenë përdoruesit e shërbimeve të tilla, por tani shfrytëzuesit kryesorë të të trafikuarave janë vendorët, gjë që është vërtetuar

83 Për krahasim, sipas statistikave të IOM-it për periudhën 2001 - 2006 janë identifikuar 91 viktime të trafikimit, 85 prej tyre janë shfrytëzuar për qëllime seksuale, 4 për punë të detyrueshme, ndërsa 2 prej tyre janë shfrytëzuar për kërkim lëmoshe apo vjedhje.

84 Statistikat e siguruara nga SHPK-ja.

85 Intervista me Violeta Krasniqi, Zyra për barazi gjinore në kuadër të Ombudspersonit, 26/06/07.

86 Intervistë me Virgjina Dumnica, UNDP, 22/06/07

## FAQE 39

edhe me të dhëna statistikore. Fillimisht femrat kanë ardhur nga vendet e Evropës Juglindore, si Moldavia, Rusia, në disa raste nga Bullgaria si dhe në raste të rralla nga Shqipëria dhe Rumania”, potencon Qosja<sup>87</sup>.

Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), ka konstatuar se 60 për qind e viktimave vendore të trafikimit janë persona nën moshën 18 vjeçare dhe shumica prej tyre vijnë nga vendet rurale të Kosovës.<sup>88</sup>

Iniciativat për rritjen e vetëdijesimit mbi rrezikun e trafikimit në Kosovë ndërmerren nga Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës, Agjensioni për Barazi Gjinore dhe nga disa organizata ndërkombëtare (OSBE, UNDP, IOM, OGA).

Është evidente se ekziston një dallim në mes të zonave urbane dhe atyre rurale sa i përket fushatave kundër trafikimit, pasi në pjesët rurale bëhet dukshëm më pak për të ngritur vetëdijesimin për këtë rrezik.

Violeta Krasniqi thotë se kur është fjala te informacionet për parandalimin e trafikimit, zyra e Ombudspersonit mundohet që të ofrojë informacione të bollshme për mënyrën se si një qytetar mund të informojë me kohë për ndonjë rasti të tillë në mënyrë që parandalimi të jetë i efektshëm. “Ne kemi takime informimi edhe me nxënësit e shkollave fillore dhe atyre të mesme të cilëve u flasim për mënyrat e ndryshme të lajmërimit përmes postës elektronike dhe numrave të telefonit, ose edhe përmes vizitimit të stacioneve të policisë ku një viktimë apo një qytetar mund të informojë”.<sup>89</sup>

Përveç fushatave të informimit dhe një element i rëndësishëm në këtë kontekst është edhe çështja e rehabilitimit të viktimave. Sipas Violeta Krasniqit, “është punuar shumë me agjenci të ndryshme për krijimin e strategjisë kundër trafikimit. Mirëpo, një mangësi është se nuk ekziston një strategji më afatgjate për rehabilitimin e viktimave - si për viktimat e trafikimit, ashtu edhe për ato të dhunës në familje”.<sup>90</sup>

Për shkak të mentalitetit dominues në Kosovë, viktimat e trafikimit pos mungesës së përkrahjes së duhur institucionale, shpesh edhe stigmatizohen. Kjo në një masë të madhe reflektohet edhe në vështirësitë e mëdha në procesin e risocializimit të tyre. Sipas Ariana Qosja - Mustafa, këto viktimat janë shumë të reja dhe një fatkeqësi tjetër është se për shkak të mentalitetit tradicional ato konsiderohen nga shoqëria si prostituta: “Mund ta përmendi një rast në Komunën e Pejës, ku një familje është inçoruar komplet nga fshati, për shkak se

---

87 Intervistë me Ariana Qosja Mustafa – Këshilltare Ligjore Nacionale për Gratë dhe Fëmijët dhe Pjesë e Njësitit kundër Trafikimit në OSBE. Intervistuar nga Lynne Alice. 26.06.2007. Prishtinë

88 Gazeta Express, e martë, 9 janar 2007, faqe 12. Autore: Besiana Xharra

89 Intervista me Violeta Krasniqin, Zyra për barazi gjinore në kuadër të Ombudspersonit, 26/06/07.

90 Intervista me Violeta Krasniqin, Zyra për barazi gjinore në kuadër të Ombudspersonit, 26/06/07.

prindërit kanë pranuar që vajza e tyre - e cila ka qenë viktimë e trafikimit - të kthehet në shtëpi".<sup>91</sup>

Igballe Rogova, drejtoreshë ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës thekson se vështirësitë e luftimit të dukurisë së trafikimit lidhen me problemet e pranishme në sistemin gjyqësor si dhe me mungesën e vullnetit politik të UNMIK-ut dhe KFOR-it për ta parandaluar këtë dukuri. "Mekanizmat ekzistojnë, mirëpo duhet të funksionojë sistemi gjyqësor që të mund të dënohen trafikantët", thotë Rogova.<sup>92</sup>

Sipas Ariana Qosja - Mustafa, ekziston një thënie në botën e trafikantëve: "Trafikantët janë gjithnjë një hap përpara", sepse trendi dhe metodat e tyre ndryshojnë me kohën. Prandaj edhe reagimet institucionale duhet që të jenë dinamike, të fuqishme dhe shumëdimensionale.

## VII. NENI 7

Neni 7 Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe në mënyrë të veçantë u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën:

- (a) Për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike si dhe për të qenë të zgjedhshme në të gjitha organet e zgjedhura publikisht;
- (b) Për të marrë pjesë në përpunimin e politikës së shtetit dhe në zbatimin e saj; për të mbajtur poste publike dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes;
- (c) Për të marrë pjesë në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën publike dhe politike të vendit.

### 7.1 Përputhja e nenit 7 me ligje

Ligji kundër Diskriminimit zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat cenojnë të drejtat e personit/ve fizik dhe juridik, edhe në fushën e pjesëmarrjes në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të zgjedhë dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur.<sup>93</sup>

LBGJ Në nenin 3.1. përcakton që: Me zbatimin e masave ligjore dhe afirmative

91 Intervistë me Ariana Qosja Mustafa – Këshilltare Ligjore Nacionale për Gratë dhe Fëmijët dhe pjesë e Njësitit kundër Trafikimit në OSBE. Intervistuar nga Lynne Alice, 26.06.2007, Prishtinë.

92 Intervistë me Igballe Rogovën

93 Neni 4 (l) LKD-



## FAQE 41

vendoset pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në organet e të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të arrijë nivelin e pjesëmarrjes së tyre të popullata e përgjithshme e Kosovës. Ndërsa në nenin 3.2. Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve sipas nenit 3 pika 3.1 arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40 %.

Shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, është vepër e veçantë e përcaktuar në Nenin 158 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës: (1) Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme i mohon ose i kufizon liritë a të drejtat e banorit të Kosovës të parapara në Kornizën Kushtetuese dhe në ligjin në fuqi mbi bazën e dallimit në racë, në ngjyrë, në gjini, në gjuhë, në besimin fetar ose në ateizëm, në mendimin politik ose në mendimin tjetër, në prejardhje sociale ose kombëtare, në pronë, në lindje, në arsim, në statusit shoqëror ose sipas karakteristikave të tjera personale, të lidhjes me bashkësinë etnike ose gjuhësore në Kosovë ose kushdo që në mënyrë të kundërligjshme i jep qytetarit të Kosovës çfarëdo privilegji ose përparësi mbi bazën e një dallimi ose përkatësie të tillë dënohet me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet.<sup>94</sup>

E drejta për të votuar në zgjedhje në Kosovë është paraparë në nenin 9.1.3 (c) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme: Çdo person që ka mbushur moshën 18-vjeçare në ditën e zgjedhjeve dhe që i plotëson kriteret e tjera për të drejtën e votimit, ka të drejtën e votës, ashtu siç është vepruar në zgjedhjet komunale të mbajtura në Kosovë më 28 tetor të vitit 2000.<sup>95</sup>

Me qëllim të krijimit të dispozitave themelore për drejtimin e zgjedhjeve komunale në Kosovë në vitin 2002, PSSP-ja ka shpallë Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/11 mbi zgjedhjet komunale në Kosovë. Neni 8, (8.1) i kësaj rregulloreje përcakton: Të gjithë personat me të drejtë vote në Kosovë duhet t'i kenë 18 apo më tepër vjet në ditën e votimit.

Ndërsa Neni 5.5 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/11 mbi zgjedhjet komunale në Kosovë përcakton: Në të gjitha listat e kandidatëve të subjekteve të certifikuar politike, nga numri i përgjithshëm i 67 % -shit të parë, së paku 33

<sup>94</sup> Neni 158-Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003), Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.

<sup>95</sup> Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/39, 8 korrik 2000, mbi zgjedhjet komunale në Kosovë. Neni 4 i kësaj rregulloreje përcakton: 4.1 Zgjedhjet për kuvendet komunale do të zhvillohen sipas sistemit të përfaqësimit proporcional të bazuar në listat e kandidatëve të partive politike, iniciativave qytetare dhe koalicioneve dhe kandidatëve të pavarur të emëruar në fletëvotim sipas rregullave të zgjedhjeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4.2 Çdo listë e kandidatëve duhet të përfshijë së paku tridhjetë për qind kandidatë femra në kuadër të pesëmbëdhjetë kandidatëve të parë. Në kuadër të pesëmbëdhjetë kandidatëve të parë në çdo listë të kandidatëve, në mesin e tre kandidatëve të parë duhet të figurojë së paku një femër dhe pas kësaj duhet të figurojë së paku një femër në çdo grup të plotë prej tre kandidatësh. Kjo rregull nuk do të vlejë për ato lista që përbëhen nga më pak se tre kandidatë.

% duhet të jenë kandidatet femra, me së paku një kandidat femër të përfshirë në çdo grup prej tre kandidatëve, duke numëruar nga kandidati i parë në listë. Nëse lista e kandidatëve të subjekteve të certifikuar politike përmban dy apo më pak kandidatë, kushtet për plotësimin e kriterëve gjinore të përcaktuara në këtë nen nuk janë të obligueshme. SHIH RREGULLORET E REJA 2007

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është një organ i përhershëm dhe i pavarur në kuptim të kreut 11 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe kryen funksionet e tij në mënyrë të pavarur nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, ka autorizimet, detyrimet dhe përbërjen e përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/21 (18 prill 2000) për themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/9 mbi komisionin qendror të zgjedhjeve, dhe ka për qëllim prezantimit të dispozitave për udhëheqjen e aktiviteteve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe të udhëheqjes së zgjedhjeve në Kosovë.

Parandalimi i ushtrimit të së drejtës së votimit dhe cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve janë dy vepra penale të përcaktuara në nenin 176 dhe 177 të kodit të përkohshëm penal të Kosovës: Kushdo që gjatë ushtrimit të detyrave që i besohen atij lidhur me votimet në Kosovë dhe me qëllim të pengimit të ushtrimit të së drejtës së votimit të personit tjetër në mënyrë të paligjshme nuk e regjistron personin e tillë në listën e regjistrimit të votuesve ose në ndonjë mënyrë tjetër e pengon personin tjetër nga ushtrimi i të drejtës së votës dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.<sup>96</sup> Kushdo që me përdorimin e dhunës, kanosjes serioze, rryshfetit ose duke keqpërdorur varësinë ekonomike apo profesionale të votuesit ndikon në votuesit në Kosovë që të votojnë në mënyrë të caktuar ose të mos votojnë në zgjedhje dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në tre vjet.<sup>97</sup>

Ligji kundër Diskriminimit zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat cenojnë të drejtat e personit/ve fizik dhe juridik, edhe në fushën e pjesëmarrjes në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të zgjedhë dhe të drejtën për të qenë i zgjedhur.<sup>98</sup>

Cenimi i të drejtave të punëtorëve në pjesëmarrjen në qeverisje, është veprë penale e përcaktuar në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës: Kushdo që, duke e cenuar ligjin, pengon apo i pamundëson punëtorit realizimin e të drejtës në pjesëmarrje në qeverisje apo ato të drejta i keqpërdor dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit.<sup>99</sup>

96 Neni 176 (Parandalimi i ushtrimit të së drejtës së votimit) Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003), Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.

97 Neni 177 (Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve) Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003), Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.

98 Neni 4 (I) LKD-

99 Neni 184, Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003), Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/22 (15 nëntor 1999) për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare ne Kosovë rregullon themelimin, regjistrimin, veprimtarinë dhe shpërndarjen e personave juridikë të organizuar si organizata joqeveritare (OJQ) në Kosovë. Në kuptim të kësaj rregulloreje një OJQ vendase është një Shoqatë ose Fondacion i krijuar në Kosovë për të përmbushur qëllime të ligjshme, si për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë.

Shoqata është një organizatë anëtare që përbëhet nga anëtarët e saj. Një shoqatë mund të krijohet nga të paktën tre persona juridikë ose fizikë ("Persona"), vendës ose të huaj, kur të paktën njëri prej tyre ka një rezidencë ose zyrë në Kosovë. Ndërsa, Fondacioni është organizatë pa anëtarë, i krijuar për të administruar prona dhe pasuri. Një fondacion mund të krijohet nga një ose më shumë persona kur të paktën njëri prej tyre ka vendbanim ose zyrë në Kosovë.

Në këtë drejtim, legjislacioni kosovar, për të gjithë personat pa bërë dallimin femra apo meshkuj, siguron të drejta të barabarta për gratë për të themeluar dhe marrë pjesë në organizata joqeveritare dhe shoqata që kanë të bëjnë me jetën publike dhe politike në Kosovë.

Një OJQ e regjistruar që ka ndër të tjera si aktivitete të saj kryesore nxitjen e barazisë gjinore apo nxitje të parimeve demokratike dhe të shoqërisë civile, mund të kërkojë statusin për përfitime publike dhe gëzojnë të drejtën e lehtësive tatimore dhe fiskale, duke përfshirë përjashtimet nga detyrimet doganore, tatimi mbi shitjen dhe tatime të tjera me përjashtim të pagesave që para se gjithash janë pagesa për shërbime komunale.<sup>100</sup>

Subjektet e shoqërisë civile kontribuojnë në zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore. Organizatat jo-qeveritare, shoqatat dhe fondacionet bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën e tyre në fushën e barazisë gjinore me institucionet qeveritare si dhe me institucione të tjera të përcaktuara me LBGJ.<sup>101</sup>

Paragrafi 3.2. i LBGJ-së përcakton: Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve sipas nenit 3 pika 3.1 arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40 %.

Gjatë emërimit në organet qendrore dhe në organet e qeverisjes lokale, si dhe te personat e tjerë juridik me pushtet publik, duhet të respektohet pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në përputhje me paragrafin 3.2 të LBGJ-së.<sup>102</sup>

Organet kompetente gjatë emërimit të anëtarëve të këshillave, komisioneve

---

100 Shin Neni 10 Rregullorja e UNMIK-ut NR. 1999/22 (15 nëntor 1999) për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare ne Kosovë.

101 Neni 10 – LBGJ.

102 Neni 3.3.-LBGJ.

dhe organeve përfaqësuese brenda dhe jashtë Kosovës duhet të përfillin përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve në këta këshilla, komisione dhe organe përfaqësuese.<sup>103</sup>

Kuvendi i Kosovës respekton parimet e përfaqësimit të barabartë gjinor gjatë themelimit të organeve punuese dhe të delegacioneve në pajtim me rregulloren e tij të punës.<sup>104</sup>

Detyrë dhe përgjegjësi e qeverisë dhe ministrive në fushën e barazisë gjinore është edhe promovimi dhe garantimi i të drejtave të barabarta gjinore.<sup>105</sup>

Organet e qeverisjes lokale, në pajtim me kompetencat e tyre, promovojnë dhe krijojnë mundësi të barabarta, hartojnë politikat e tyre duke u bazuar në barazinë gjinore dhe miratojnë masa dhe ndërmarrin aktivitete të nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe meshkuj.<sup>106</sup>

Organet përgjegjëse dhe personat juridik me autorizime publike si dhe institucionet financiare në kushte të barabarta u sigurojnë femrave dhe meshkujve qasje në mjete dhe shpërndarje të mjeteve të ndara për nxitjen e krijimit të biznesit dhe vetëpunësimit.<sup>107</sup>

## 7.2 Përputhja e nenit 7 me fakte

Me qëllim të fuqizimit të pozitës së gruas dhe rritjes së numrit të grave në pozitë vendimmarrëse, në zgjedhjet e para demokratike, pas luftës në Kosovë, për nivelin komunal (në vitin 2000) u aplikua parimi sipas të cilit gratë ishin të përfaqësuara në 30 për qind të numrit të përgjithshëm të kandidatëve në listat për këshilltarë komunal. Por e tëra që ishte arritur në këto zgjedhje, kur flitet për pjesëmarrjen e grave në asamblatë komunale, në 30 komuna të Kosovës, ishte vetëm 8.6 për qind. Ndërkaq pas zgjedhjeve të dyta komunale, me aplikimin e kuotës për përfaqësim të gruas edhe në asamblatë komunale, gratë mbajnë 28 për qind të të gjitha ulëseve të Kuvendeve Komunale, në 30 Komuna të Kosovës. Ndërkaq, vetëm dy nga krye shefet ekzekutive në komuna janë emëruar gra.

Në zgjedhjet e përgjithshme (2001), në bazë të kuotës, me vendim të Komisionit Qendror Zgjedhor, partitë politike në Kosovë ishin të obliguara që çdo e treta kandidatë në listat e tyre për deputet të jetë grua. Ky vendim vliente edhe për përfaqësimin e grave, prej 30 për qind në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, gjatë këtij mandati nga 120 ulëse sa ka gjithsej, gratë kanë zënë 35 vende në Kuvendin e Kosovës ose 28.3 për qind të përbërjes së përgjithshme. Ndërkaq, në zgjedhjet e dyta të përgjithshme, (2004), Kuvendi i Kosovës

103 Neni 3.4.-L.BGJ.

104 Neni 4.1.-L.BGJ.

105 Neni 4.1. .-L.BGJ.

106 Neni 4.14.-L.BGJ.

107 Neni 11.2. -L.BGJ.

## FAQE 45

vazhdoi të ketë 120 ulëse, ndërsa nga to të ndaj për gratë 33 ose 27.5 për qind nga numri i përgjithshëm.

Përkundër asaj që konsiderohet se është arritur një përqindje relativisht e lartë e përfaqësimit të grave në Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendet Komunale, në krahasim me vendet tjera të rajonit, nuk mund të thuhet se pjesëmarrja e gruas në jetën politike dhe publike ka arritur nivel të kënaqshëm.

Numri i grave në poste udhëheqëse edhe më tej është disproporcional. Nga 893 poste udhëheqëse, në nivel lokal, vetëm 90 poste mbulohen nga gratë.

Në Kuvendin e Kosovës janë të përfaqësuar 14 parti politike, të grupuara në pesë grupe parlamentare. Përderisa asnjëra nga partitë politike parlamentare nuk udhëhiqet nga gratë, dy nga pesë grupet parlamentare udhëhiqen nga gratë (Gjynaze Sylja - Shefe e grupit parlamentar të AAK-së dhe Teuta Sahatçiu - Shefe e grupit parlamentar të ORA-s). Kuvendi i Kosovës ka 18 Komisione Parlamentare, prej të cilave 7 drejtohen nga gratë.

Në kuadër të ekzekutivit në Kosovë funksionojnë pesëmbëdhjetë ministri. Vetëm një nga to udhëhiqet nga një grua.

Nga numri i përgjithshëm i partive politike (35), vetëm dy parti udhëhiqen nga gratë. Këto janë Partia Social-Demokrate e Kosovës - Kaqusha Jashari dhe Alternativa e Re e Kosovës - Edita Tahiri, të cilat në zgjedhjet e përgjithshme të 2004 mbetën jashtë kuvendit.

Partitë politike, të cilat në zgjedhjet e 2004 morën përqindjen më të madhe në Kuvendin e Kosovës, në kryesitë e tyre gratë janë të përfaqësuar, me 20 për qind në LDK, 10 për qind në PDK dhe 20 për qind në AAK.

Struktura gjinore në postet udhëheqëse në komuna<sup>108</sup> sipas të dhënave MSHP/DASHC<sup>109</sup>

- Kryeshefe ekzekutive prej 28 të punësuarve 1 është grua
- Drejtore Drejtorie prej 280 të punësuarve 28 janë gra
- Zv/Drejtores drejtorie prej 24 të punësuarve 3 gra janë gra
- Shefe sektori prej 346 të punësuarve 40 janë gra
- Shefe shërbimi prej 80 të punësuarve 10 janë gra
- Shefe zyre prej 27 të punësuarve 3 janë gra
- Menaxhere personeli prej 18 të punësuarve 5 janë gra

Gratë janë të nën përfaqësuar në pozitat e larta në kuadër të gjyqësorit. Janë vetëm tri gjyqtare të gjinisë femërore në mesin e 14 gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës. Nga 46 gjyqtarë të gjykatave të qarkut, 10 janë gra.

---

108 Vërejtje: Komunitet e Zubin Potokut dhe Zveçan nuk është në këto shënime

109 MSHP/DASHC

Përderisa në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje përfaqësimi gjinor është pak a shumë i balancuar (tre burra, dy gra). Kurse në Odën e Avokatëve gratë përfaqësohen me 6.7 për qind.

Në Shërbimin Policor të Kosovës gratë marrin pjesë me 14 për qind në të gjitha strukturat. Derisa në Trupat Mbrojtëse të Kosovës gruaja është prezente me vetëm 2 për qind në të gjitha strukturat.

Vlerësohet se tash për tash në Kosovë funksionojnë mbi 2000 Organizata Joqeveritare. Nga ky numër i përgjithshëm 10 për qind adresojnë probleme specifike për gratë.

Edhe pse në Kosovë që nga viti 1981 nuk është bërë regjistrimi i popullsisë, konsiderohet se gratë në Kosovë përbëjnë rreth 50 për qind të popullatës. Në Kosovë, ka pak raporte dhe të dhëna statistikore për numrin dhe shkaqet e sakta të nivelit të analfabetizmit tek gratë dhe vajzat. Përqindja e analfabetizmit që paraqitet në raportet e ndryshme që trajtojnë këtë problematikë, shpeshherë nuk është konsistente, kryesisht për shkak të mungesës së regjistrimit civil në Kosovë. Sidoqoftë, analfabetizmi duket se ka përmasa shqetësuese për shoqërinë kosovare. "Përqindja e analfabetizmit midis të rriturve është 5.8 për qind. Përqindja është më e lartë te gratë (12.5 për qind), sesa tek burrat (3.4 për qind). Kjo përqindje dallon midis grave të kombësive të ndryshme. Gratë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian udhëheqin listën me 26 për qind, gratë shqiptare përbëjnë deri 8 për qind, gratë serbe 4 për qind dhe të tjerat 11 për qind".<sup>110</sup>

Bazuar në të dhënat e Entit Statistikor të Kosovës të vitit 2002 dhe Planit të Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore të vitit 2003, vetëm rreth 6.5 për qind e bizneseve kosovare janë në pronësi të grave. Përderisa në bazë të hulumtimit të kryer nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në vitin 2004, me 500 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, 98 për qind e pronarëve të bizneseve janë burra, përderisa vetëm 2 për qind janë gra. Njëra ndër arsyt kryesore për këtë përqindje shumë të ulët të pronësisë së bizneseve nga gratë kosovare është mungesa e qasjes së drejtpërdrejtë të përkrahjes financiare dhe e shfrytëzimit të huave bankare, për shkak se pasuria e tyre familjare kryesisht është e regjistruar në emër të burrave të familjes. Trashëgimia familjare në shoqërinë kosovare rregullohet në bazë të marrëveshjeve të brendshme përbrenda familjes dhe bazohet në normat tradicionale. Bazuar në zakonet vendore, prona ndahet midis burrave të familjes (vetëm në raste të rralla gratë marrin ndonjë pjesë të saj), gjë që ua pamundëson grave që të fillojnë biznese të vogla dhe të zhvillojnë iniciativa individuale.<sup>111</sup>

110 Raporti i Zhvillimit Njerëzor (Human Development Report) për Kosovë, 2004, f. 36.

111 Justina Shiroka-Pula PJESEMARRJA E GRAVE NË TREGUN E PUNËS NË KOSOVË (Analizë krahasuese dhe hulumtim empirik)

## VIII. NENI 8

### Neni 8

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për t'u siguruar grave mundësinë, në të njëjtat kushte me burrat, dhe pa asnjë diskriminim, që t'i përfaqësojnë qeveritë e tyre në arenën ndërkombëtare dhe të marrin pjesë në punimet e organizatave ndërkombëtare.

### 8.1 Përputhja e nenit 8 me ligje

LBGJ përcakton: Organet kompetente gjatë emërimit të anëtarëve të këshillave, komisioneve dhe organeve përfaqësuese brenda dhe jashtë Kosovës duhet të përfillin përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve në këta këshilla, komisione dhe organe përfaqësuese.<sup>112</sup>

## IX. NENI 9

### Neni 9

1. Shtetet palë i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit në fushën e marrjes, ndërrimit dhe mbajtjes së shtetësisë. Ato veçanërisht garantojnë që as martesa me një të huaj, e as ndërrimi i shtetësisë së burrit gjatë martesës nuk e ndërrojnë automatikisht shtetësinë e gruas, po ashtu nuk e bën atë pa shtetësi dhe nuk e detyron të marrë shtetësinë e burrit.
2. Shtetet palë i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit për sa i përket shtetësisë së fëmijëve të tyre.

### 9.1 Përputhja e nenit 9 me ligje

Korniza Kushtetuese nuk përmban asnjë dispozitë me të cilën i akordohet gruas e drejta e barabartë me atë të burrit në fushën e marrjes, ndërrimit dhe mbajtjes së shtetësisë, apo garantimi që martesa me një të huaj dhe ndërrimi i shtetësisë së burrit gjatë martesës nuk e ndërrojnë automatikisht shtetësinë e gruas, po ashtu nuk e bën atë apatride (pa shtetësi) dhe nuk e detyron të marrë shtetësinë e burrit.

Regullorja e UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil, përcakton që Zyra Qendrore e Regjistrimit Civil do të ketë një regjistër të banorëve të zakonshëm të Kosovës, dhe në Nenin 3 përcakton: Ofiqari do t'i regjistrojë si banorë të përhershëm personat e poshtëshënuar:

- a. Personat e lindur në Kosovë ose ata të cilët e kanë një prind të lindur në Kosovë;
- b. Personat të cilët mund të dëshmojnë se kanë banuar në Kosovë për një kohë të pandërprerë prej së paku pesë vitesh;
- c. Personat tjerë të cilët, sipas mendimit të ofiqarit, kanë qenë të detyruar të largohen nga Kosova dhe për këtë arsye nuk kanë qenë në gjendje ta plotësojnë kushtin e kohëzgjatjes së banimit në paragrafin (b) të këtij neni dhe
- d. Fëmijët e tjerë vartës të personave që nuk e fitojnë të drejtën e regjistrimit sipas nënparagrafëve (a), (b) dhe (c) të këtij neni, fëmijët e tillë që janë në moshën 18-vjeçare ose nën moshën 23-vjeçare, por për të cilët dëshmohet se janë vijues të rregullt të një institucioni të pranuar arsimor.<sup>113</sup>

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/18 (29 mars 2000) Për Dokumentet e Udhëtimit, në Nenin 1 përcakton: Personat e regjistruar në Zyrën Qendrore të Gjendjes Civile dhe që kanë statusin e banorëve të zakonshëm mund të kërkojnë nga Zyra Qendrore e Gjendjes Civile lëshuarjen e dokumentit të udhëtimit. Dokumenti i udhëtimit nuk e tregon shtetësinë e bartësit të dokumentit dhe as që ndikon në shtetësinë e tij.<sup>114</sup>

Projektligji për Shtetësinë e Kosovës (qershor 2007) në Nenin 3 (Shtetësia e shumëfishte) parasheh: Shtetasi i Kosovës mund të jetë edhe shtetas i një ose më shumë shteteve të tjera. Fitimi dhe mbajtja e shtetësie tjetër nuk rezultojnë në humbjen e shtetësisë së Kosovës.

Mënyrat e fitimit të shtetësisë, janë përcaktuar në Nenin 5 të Projektligjit për Shtetësinë e Kosovës, i cili parasheh që shtetësia e Kosovës fitohet me: lindje; adoptim; natyralizim; në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare si dhe në bazë të neneve 28 dhe 29 të këtij ligji.<sup>115</sup>

Në bazë të legjislacionit në fuqi të gjithë qytetarët e Kosovës kanë statusin e banorit të Kosovës dhe Neni 3, i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil, përcakton rastet kur Ofiqari mund t'i regjistrojë si banorë të përhershëm personat.

Projektligji për Shtetësinë e Kosovës në Nenin 11, parasheh:

1. Personi i huaj i cili është bashkëshort i shtetasit të Kosovës e fiton shtetësinë e Kosovës në bazë të kërkesës, nëse në ditën e paraqitjes së kërkesës plotëson kushtet vijuese:

113 Neni 3, Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil.

114 Neni 1, Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/18 (29 mars 2000) Për Dokumentet e Udhëtimit

115 Projektligji për Shtetësinë e Kosovës (qershor 2007)



#### FAQE 49

- a. të paktën tre (3) vite ka lidhje të vlefshme martesore me shtetasin e Kosovës dhe
  - b. është duke jetuar rregullisht në Kosovë për të paktën një (1) vit dhe posedon leje të vlefshme qëndrimi.
2. Dispozitat e nenit 10, paragrafi 1, pikat a), c), d) dhe e) vlejnë po ashtu edhe për natyralizimin e bashkëshortit.

Projektligjit për Shtetësinë e Kosovës në Nenin 16 parasheh Mënyrat e humbjes së shtetësisë:

Shtetësia e Kosovës humbet:

- a. me lirim nga shtetësia,
- b. me privim të shtetësisë,
- c. në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Korniza Kushtetuese nuk përmban asnjë dispozitë me të cilën i akordohen gruas të drejta të barabarta me ato të burrit për sa i përket shtetësisë së fëmijëve të tyre.

Neni 3, i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil, përcakton: Ofiqari do t'i regjistrojë si banorë të përhershëm personat e poshtëshënuar:

- a. Personat e lindur në Kosovë ose ata të cilët e kanë një prind të lindur në Kosovë;
- b. Personat të cilët mund të dëshmojnë se kanë banuar në Kosovë për një kohë të pandërprerë prej së paku pesë vitesh;
- c. Personat tjerë të cilët, sipas mendimit të ofiqarit, kanë qenë të detyruar të largohen nga Kosova dhe për këtë arsye nuk kanë qenë në gjendje ta plotësojnë kushtin e kohëzgjatjes së banimit në paragrafin (b) të këtij neni dhe
- d. Fëmijët e tjerë vartës të personave që nuk e fitojnë të drejtën e regjistrimit sipas nënparagrafëve (a), (b) dhe (c) të këtij neni, fëmijët e tillë që janë në moshën 18-vjeçare ose nën moshën 23-vjeçare, por për të cilët dëshmohet se janë vijues të rregullt të një institucioni të pranuar arsimor.<sup>116</sup>

Projektligjit për Shtetësinë e Kosovës në Nenin 12 parasheh:

1. Fëmija i mitur i personit i cili ka paraqitur kërkesën për natyralizim e fiton shtetësinë e Kosovës kur prindi i tij e fiton shtetësinë e Kosovës edhe nëse fëmija nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1. Kërkesa për natyralizimin e fëmijës së mitur i bashkëngjitet kërkesës për

---

116 Neni 3, Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil.

natyralizim të parashtruar nga prindi.

2. Paragrafi 1 vlen edhe për personat e mitur të adoptuar.

Po ashtu Neni 18, i Projektligjit për Shtetësinë e Kosovës parasheh Lirimin nga shtetësia i personave te mitur në këto raste:

1. Personi i mitur e humb shtetësinë e Kosovës me lirim nëse kjo kërkohet nga dy prindërit të cilët e kanë humbur shtetësinë e Kosovës me lirim, ose nëse kjo kërkohet nga prindi i cili e ka humbur shtetësinë e Kosovës me lirim dhe prindi tjetër nuk është shtetas i Kosovës.

## 9.2 Përputhja e nenit 9 me fakte

Duke marrë parasysh statusin e Kosovës, si një entitet nën administratën e përkohshme ndërkombëtare çështja e martesës me një të huaj, apo çështja lidhur me ndryshimin e shtetësisë nga bashkëshorti gjatë martesës nuk e ndryshon automatikisht shtetësinë e bashkëshortes, e le atë pa shtetësi ose e detyron atë të marrë shtetësinë e bashkëshortit, nuk është rregulluar me asnjë akt ligjor në Kosovë.

## X. NENI 10

### Neni 10

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas, me qëllim që t'i sigurohen asaj të drejta të barabarta me burrin në fushën e arsimit, në mënyrë të veçantë, për të siguruar mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas:

(a) Kushte të njëjta të bërjes së karrierës dhe të kualifikimit profesional, të frekuentimit të shkollave dhe të marrjes së diplomave në institucionet arsimore të të gjitha kategorive si në fshat ashtu edhe në qytet; kjo barazi sigurohet në arsimin parashkollor, të përgjithshëm, teknik profesional dhe në arsimin teknik të lartë, si dhe në çdo institucion tjetër të kualifikimit profesional;

- a. Të drejtën për të frekuentuar programe të njëjta mësimore, për t'u nënshtruar provimeve të njëjta, për të pasur kuadër mësimor me kualifikim të standardit të njëjtë dhe lokale e pajisje shkollore të një cilësie të njëjtë;
- b. Eliminimin e çdo koncepti stereotip për rolin e burrit dhe të gruas në të gjitha nivelet dhe në të gjitha format e arsimit, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe tipe të tjera të arsimit që ndihmojnë realizimin e këtij objekti, e sidomos duke rishikuar tekstet dhe programet mësimore dhe duke përshtatur metodat e mësimdhënies;
- c. Mundësi të njëjta për shfrytëzimin e bursave dhe subvencioneve të tjera për studime;

- d. Mundësi të njëjta për të frekuentuar programet e arsimit të pandërprerë, duke përfshirë programet e aftësimit për shkrim e lexim për të rritur dhe të alfabetizimit funksional duke pasur sidomos për qëllim ato programe qëllimi i të cilave është që brenda një kohe sa më të shkurtër të zvogëlohet dallimi në nivelin ekzistues të arsimit midis burrit dhe gruas;
- e. Uljen e përqindjes së braktisjes së shkollave nga gratë dhe organizimin e programeve për të reja dhe për ato gra që janë larguar nga shkolla para kohe;
- f. Mundësi të njëjta për të marrë pjesë në sporte dhe në edukimin fizik;
- g. Të drejtën për të marrë informacione specifike nga fusha e arsimit për të ndihmuar sigurimin e shëndetit dhe mirëqenien e familjeve, duke përfshirë informacionin dhe konsultimet lidhur me planifikimin e familjes.

### **10.1 Përputhja e nenit 10 me ligje**

---

LBGJ përcakton: Në shkolla dhe institucione të tjera arsimore dhe pedagogjike ndalohet çdo lloj diskriminimi gjinor.<sup>117</sup>

Në të gjitha nivelet e arsimit dhe edukimit duhet të mundësohet arsimimi dhe edukimi i barabartë i femrave dhe meshkujve për pjesëmarrje e tyre aktive në shoqëri, në jetën familjare dhe në tregun e punës.<sup>118</sup>

Organi përgjegjës për arsim dhe institucionet në fushën e arsimit dhe të edukimit në të gjitha nivelet krijojnë, zbatojnë dhe mbikëqyrin politikat e veprimit për sigurimin e barazisë gjinore me qëllim të trajtimit të njëjtë të femrave dhe meshkujve, veçanërisht sa i përket:

- a. qasjes në arsim dhe edukim;
- b. arsimit dhe edukimit lidhur me çështjet e barazisë gjinore;
- c. përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të programit arsimor-edukativ;
- d. hartimit të materialeve dhe teksteve shkollore dhe rishikimit të materialeve dhe teksteve shkollore ekzistuese;
- e. hulumtimit të statusit të gjinive në shoqërinë kosovare, si një ndër mënyrë specifike në fushën e arsimit;
- f. përfshirjes së femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimimit profesional dhe të këshillimit për ato profesione të cilat deri tani janë konsideruar tradicionalisht si profesione vetëm për meshkuj ose vetëm për femra;
- g. përfshirjes së barabartë të femrave dhe meshkujve në lëmenjtë e sportit dhe aktiviteteve të lira, gjatë orarit arsimor.<sup>119</sup>

Ligji kundër Diskriminimit zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat cenojnë të drejtat e personit/ve fizik dhe juridik, edhe në fushën e arsimit.<sup>120</sup>

117 Neni 13.3. (Arsimi dhe Edukimi) LBGJ.

118 Neni 13.1. (Arsimi dhe Edukimi) LBGJ.

119 13.2.(Arsimi dhe Edukimi) LBGJ.

120 Neni 4 (g) LKD.

Rregullorja nr. 2005/15, e datës 16 mars 2005, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, në nenin 1.7 përcakton: “Gjatë kryerjes së përgjegjësisve dhe funksioneve të tyre, ministrat kujdesen që ministrinë e tyre përkatëse: Të sigurojnë shërbime të besueshme, transparente dhe të përgjegjshme pa diskriminim mbi baza etnike apo të prejadhjes sociale, gjinore, paafësisë fizike, religjionit, mendimit politik a ndonjë mendimi tjetër”.<sup>121</sup>

Në këtë drejtim ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT-i), duhet të kujdeset që në fushëveprimin e MASHT-it, i cili është përcaktuar në Shtojcën IV të e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2005/15), d.m.th në sferën e arsimit, të sigurojnë shërbime të besueshme, transparente dhe të përgjegjshme pa diskriminim mbi baza etnike apo të prejadhjes sociale, gjinore, paafësisë fizike, religjionit, mendimit politik a ndonjë mendimi tjetër.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT):

- (i) Krijon politikën e veprimit dhe zbaton legjisllacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë arsimin e lartë dhe shkencën në Kosovë.
- (ii) Përkrah një sistem arsimor jodiskriminues, ku respektohet e drejta e çdo personi për shkollim dhe ku mundësitë për mësim cilësor janë në dispozicion të të gjithëve;
- (iii) Ofron arsim joformal dhe arsim për të rriturit në të gjitha nivelet, duke përfshirë rajonet e largëta dhe përkrah mundësitë e shkollimit të përjetshëm për të gjithë;
- (iv) Përpilon, zbaton dhe mbikëqyr format e drejta dhe efektive të administratës arsimore dhe të menaxhimit të shkollave;
- (v) Përmirëson cilësinë, lidhjen dhe efikasitetin e arsimit në të gjitha nivelet;
- (vi) Ndihmon zhvillimin dhe përmirësimin cilësor të sistemit arsimor dhe shpërndarjen e shërbimeve arsimore;
- (vii) Përkrahë hulumtimin lidhur me zhvillimin social, ekonomik, shkencor, teknologjik dhe kulturor të Kosovës.
- (viii) Ndërton një sistem gjithëpërfshirës bibliotekar, i cili do të përfshijë bibliotekat e posaçme dhe ato shkollore;
- (ix) Përkrah një politikë gjithëpërfshirëse për integrimin e personave të paafë dhe të hendikepuar;
- (x) Përkrahë pjesëmarrjen e prindërve dhe të komunave në aktivitetet arsimore dhe në format përkatëse të bashkëpjesëmarrjes shkollë - komunitet në nivelin lokal.<sup>122</sup>

Në pajtim me LBGJ-në, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është

121 Rregullorja e UNMIK –ut nr. 2005/15 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1.7 (c).

122 Shtojca IV e Rregullores së UNMIK-ut- Nr. 2005/15, 16 mars 2005, Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë.

organi përgjegjës për arsim dhe institucionet në fushën e arsimit dhe të edukimit në të gjitha nivelet, i cili duhet të krijojë, zbatojë dhe mbikëqyrë politikat e veprimit për sigurimin e barazisë gjinore me qëllim të trajtimit të njëjtë të femrave dhe meshkujve, veçanërisht sa i përket:

- a. qasjes në arsim dhe edukim;
- b. arsimit dhe edukimit lidhur me çështjet e barazisë gjinore;
- c. përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të programit arsimor-edukativ;
- d. hartimit të materialeve dhe teksteve shkollore dhe rishikimit të materialeve dhe teksteve shkollore ekzistuese;
- e. hulumtimit të statusit të gjinive në shoqërinë kosovare, si një ndër mënyrë specifike në fushën e arsimit;
- f. përfshirjes së femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimit profesional dhe të këshillimit për ato profesione të cilat deri tani janë konsideruar tradicionalisht si profesione vetëm për meshkuj ose vetëm për femra;
- g. përfshirjes së barabartë të femrave dhe meshkujve në lëmenjtë e sportit dhe aktiviteteve të lira, gjatë orarit arsimor.<sup>123</sup>

Sipas legjisllacionit në fuqi në Kosovë "Ngacmimi dhe ngacmimi seksual paraqesin diskriminim gjinor."<sup>124</sup> Ngacmimi përfshinë çdo formë të sjelljes që ka për qëllim ose që paraqet cenim të dinjitetit personal.<sup>125</sup> Ndërsa, Ngacmimi seksual përfshinë çdo formë të sjelljes së padëshiruar seksuale verbale dhe joverbale, fizike ose simbolike, që në të njëjtën kohë ka për qëllim ose paraqet cenim të dinjitetit personal.<sup>126</sup> Ngacmimi dhe ngacmimi seksual në vendin e punës është i ndaluar, sipas LBGJ-së,<sup>127</sup> i cili po ashtu përcakton: Ndalohet përjashtimi nga puna, pushimi i përkohshëm nga puna, padrejtësia lidhur me sigurinë në punë, kushtet e punës ose vlerësimin e punës së tij/saj si pasojë e ankesës së tij/saj për ngacmim seksual ose diskriminim në bazë të gjinisë.<sup>128</sup> Ngacmimi seksual i ndonjë nëpunësi tjetër civil i përkufizuar si sjellje fizike apo verbale e natyrës seksuale, e cila shkel dinjitetin e femrës ose të mashkullit në punë e që është e padëshirueshme ose fyese për personin mbi të cilin bëhet, apo që bëhet si kushtëzim për punësim që krijon një ambient armiqësor, kërcënues ose rrezikues për atë person.<sup>129</sup>

Organet e administratës publike nuk bëjnë dallimet lidhur me personat fizikë dhe juridikë si: gjini, racë, ngjyrë, gjuhë, opinion politik ose opinion tjetër, origjinë kombëtare ose sociale, pasuri, lindje ose ndonjë status tjetër, gjatë veprimtarisë administrative.<sup>130</sup>

123 13.2.(Arsimi dhe Edukimi) LBGJ.

124 Neni 2.6-LBGJ.

125 Neni 2.7 –LBGJ.

126 Neni 2.8-LBGJ.

127 Neni 12.11-LBGJ.

128 Neni 12.13-LBGJ.

129 Urdhëresa Administrative Nr. 2003/2 Zbatim i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, neni 30.1 (g).

130 Neni 5.2. Rregullore nr. 2006/33 për shpalljen e Ligjit mbi Procedurën Administrative të

## 10.2 Përputhja e nenit 10 me fakte

Në Kosovë, ka pak raporte dhe të dhëna statistikore për numrin dhe shkaqet e sakta të nivelit të analfabetizmit tek gratë dhe vajzat. Përqindja e analfabetizmit që paraqitet në raportet e ndryshme që trajtojnë këtë problematikë, shpeshherë nuk është konsistente, kryesisht për shkak të mungesës së regjistrimit civil në Kosovë. Sidoqoftë, analfabetizmi duket se ka përmasa shqetësuese për shoqërinë kosovare. Luljeta Vuniqi, drejtoreshë ekzekutive në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, ka bindjen se për ta ulur shkallën e analfabetizmit, duhet bërë më shumë në shkollimin e grave dhe vajzave. "Edhe pse janë bërë përpjekje të konsiderueshme nga ana e organizatave joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare për ta ulur nivelin e analfabetizmit në Kosovë, arsimimi i grave dhe vajzave mbetet çështje së cilës duhet kushtuar vëmendje të posaçme."<sup>131</sup>

Një raport i UNICEF-it, i cili citon një studim të kryer nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe Qendra për Arsim e Kosovës, nxjerrë në pah se në zonat rurale shkalla e analfabetizmit ndër gra dhe vajza është 40 përqind, prej të cilave 14.8 përqind janë krejtësisht analfabete (që nuk dinë shkrim-lexim), ndërkaq 12.5 përqind me aftësi të pjesshme në shkrim-lexim. Megjithatë, më shqetësues është fakti se shkalla e analfabetizmit për vajzat e moshave 16-19 vjeçare është më e lartë sesa për të gjitha grupmoshat tjera. Kjo ka ardhur si pasojë e mosvijimit të shkollimit paralel gjatë viteve të 90-ta<sup>132</sup>.

Analfabetizmi ndër gratë dhe vajzat shqiptare në Kosovë kap shifrën 9 përqind dhe është tri herë më e lartë sesa tek burrat dhe djemtë shqiptarë<sup>133</sup>. Sipas "Raportit të Zhvillimit Njerëzor të Kosovës", për qindja e analfabetizmit ndër të rriturit në përgjithësi është më e ulët tek burrat, krahasuar me për qindjen e grave kosovare. Të njëjtit gjë e argumenton edhe raporti "Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme në Kosovë". Sipas raportit të zyrës për çështje gjinore të UNMIK-ut "për qindja e grave pa asnjë formë arsimi është (6.6 për qind) - dy herë më e lartë sesa e burrave (3.1 për qind)"<sup>134</sup>.

Për qindjet e analfabetizmit te gratë në Kosovë, nga më e ulëta tek më e larta janë: për serbët 4 për qind, për shqiptarët 9 për qind, për grupet e tjera etnike 11 për qind dhe për gratë e komunitetit RAE, 25 për qind.<sup>135</sup>

Afërdita Jaha, zyrtare për edukim joformal në Zyrën Rajonale të Arsimit,

---

miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

131 QKSGJ "Auditimi i Çështjeve Gjinore në Sistemin Arsimor", faqe 4, Prishtinë, 2007

132 Analizë e gjendjes së fëmijëve dhe të grave në Kosovë. UNICEF. Shkurt 2004. faqe 49

133 Raporti i Zhvillimit Njerëzor: Ngritja e Qytetarit: Sfidat dhe Mundësitë. UNDP. Kosovë. 2004. faqe 30

134 Raport: "Rishikimi i sektorit për siguri të brendshme në Kosovë", UNDP, Kosovë 2006, faqe 81

135 Zëri i Grave, raport nga (KWN, KWI, UNICEF, UNIFEM, UNDP, UNFPA, WHO, UNHCR), Prishtinë (2004) faqe 18

## FAQE 55

thekson se projektet e edukimit joformal kanë për qëllim zbutjen e shkallës së analfabetizmit tek gratë dhe burrat. Projekti shkrim-lexim bazik për gratë dhe vajzat zbatohet prej viti 2001.<sup>136</sup>

Braktisja e shkollimit është po ashtu një dukuri tjetër shqetësuese, e cila kërcënon sigurinë e individëve.

Një numër i konsiderueshëm i nxënësve të komunës së Skenderajt, për shkak të kushteve të rënda ekonomike po detyrohen të ndërpresin shkollimin. Numri i saktë i këtyre nxënësve nuk dihet, mirëpo, sipas drejtuesve të arsimit komunal, ai po rritet në vazhdimësi<sup>137</sup>

Për të njëjtën çështje, raporti i Entit të Statistikës së Kosovës, "Gratë dhe burrat në Kosovë", vë në pah se djemtë kanë gjasa më të mëdha se vajzat për të ndjekur shkollimin themelor ose atë universitar. "Diferenca në mes të gjinive rritet krahas nivelit të shkollimit. Në grup moshat 5-14 vjeç, djemtë gëzojnë përparësi ndaj vajzave, por diferencat nuk janë të mëdha. Në grupmoshën 15-19 vjeç, djemtë kanë avantazh prej 17 përqind krahasuar me vajzat. Ndërsa, në grup moshën 25-29 vjeç përparësia e burrave krahasuar me gratë është shumë më e madhe".<sup>138</sup>

Sipas raportit "Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë", vlerësohet se prej atyre që regjistrohen në klasën e parë, deri në klasën e tetë, shkollën e braktisin afër 20 përqind të nxënësve. Prej tyre, shifrat e vijueshmërisë janë më të ulëta tek vajzat, tek fëmijët e zonave rurale dhe tek pjesëtarët e minoritetit RAE

## XI. NENI 11



### Neni 11

1. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në fushën e zënies punë, për të siguruar, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas, të drejtat e njëjta, e sidomos:
  - a. Të drejtën për punë si një e drejtë e pamohueshme e të gjithë njerëzve;
  - b. Të drejtën për mundësi të njëjta punësimiti, duke përfshirë zbatimin e kriterëve të njëjta të përzgjedhjes lidhur me zënieën punë
  - c. Të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës, të drejtën për ngritjen e postit të punës, për punë të qëndrueshme, për të gjitha

136 Intervistë me Afërdita Jahën, zyrtare për Arsimit Joformal në Zyren Rajonale të Arsimit, Prishtinë, 06.06.2007

137 Express, 16 janar 2007. Jeton Rushiti, faqe 9

138 Enti i Statistikës së Kosovës, raport, "Gratë dhe burrat në Kosovë", Prishtinë, shkurt 2007, faqe.28

- përfitimet dhe kushtet e punës, të drejtën për përgatitje profesionale dhe rikualifikim, duke përfshirë mësimin e personave në ekonomi, ngritjen profesionale dhe kualifikimin e herëpashershëm;
- d. Të drejtën për shpërblim të barabartë, duke përfshirë shpërblimet ndihmë dhe për trajtim të barabartë për punën me vlerë të barabartë, si dhe për barazinë e trajtimit në vlerësimin e cilësisë së punës;
  - e. Të drejtën për sigurime sociale, sidomos në rastet e pensionimit, të papunësisë, të sëmundjes, të invaliditetit dhe të pleqërisë ose të çdo humbje tjetër të aftësisë për punë, si dhe të drejtën për pushime të paguara;
  - f. (dh) Të drejtën për mbrojtjen e shëndetit dhe për sigurimin në punë, duke përfshirë ruajtjen e funksionit biologjik dhe riprodhues të gruas.
2. Për të parandaluar diskriminimin ndaj gruas për shkaqe martesore ose maternitetit, dhe për të siguruar të drejtën e saj efektive për punë, shtetet palë marrin masa të përshtatshme:
    - a. Për të ndaluar pushimin nga puna për shkaqe shtatzanie apo të lejes së barrës, si dhe diskriminimin në raste të pushimit nga puna të bazuar në gjendjen martesore, nën kërcënimin e marrjes së sanksioneve;
    - b. Për të aplikuar leje të barrës me pagesë ose për të përfituar ndihma sociale të krahasueshme, pa e humbur vendin e mëparshëm të punës, të të drejtave të vjetërsisë dhe të avantazheve sociale;
    - c. Për të inkurajuar sistemin e shërbimeve sociale mbështetëse të nevojshme që t'i mundësojnë prindërit të gërshetojnë detyrimet familjare me përgjegjësitë në vendin e punës, dhe të marrin pjesë në jetën publike, sidomos duke nxitur themelimin dhe zhvillimin e një rrjeti çerdhesh e kopshtesh;
    - d. Për të siguruar një mbrojtje të veçantë për gratë shtatzëna në ato vende të punës në të cilat provohet se puna që kryejnë është e dëmshme.
  3. Masat e mbrojtjes ligjore të grave në çështjet e përfshira në këtë nen do të rishikohen periodikisht varësisht nga njohuritë shkencore e teknike. Këto masa, sipas nevojës, do të rishikohen, shfuqizohen ose zgjerohen.

## 11. 1 Përputhja e nenit 11 me ligje

LBGJ në nenin 12.2. përcakton: Vendi i lirë i punës hapet njësoj për femra dhe meshkuj.

Shpallja ose publikimi i vendit të lirë të punës nuk mund të përmbajë fjalë apo shprehje që diskriminojnë në baza gjinore. Kjo dispozitë nuk vlen nëse qëllimi i shpalljes dhe publikimit bëhet për të balancuar strukturën gjinore brenda një sektori profesional, dhe kjo duhet të vihet në dukje në shpallje.<sup>139</sup>

Kriteret dhe kushtet për zgjedhjen e kandidatëve për vende të punës në çdo degë veprimtarie, në të gjitha shkallët profesionale, në sektorin publik dhe

<sup>139</sup> Neni 12.3. LBGJ.



## FAQE 57

privat, vendosen mbi bazat e barazisë gjinore.<sup>140</sup>

Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës "nëpunës civil" <sup>141</sup> është çdo person i punësuar i një organi të punësimit, roga e të cilit paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, përveç anëtarët e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, duke përjashtuar këtu edhe personat e emëruar dhe ata të Trupave të Mbrojtjes të Kosovës (TMK).

Një nga parimet e Shërbimit Civil të Kosovës është edhe Parimi i Jodiskriminimit, i cili përcakton se: nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik, prejardhjes kombëtare, etnike apo sociale, lidhjes me ndonjë komunitet nacional, pronës, lindjes, paaftësisë fizike, statusit familjar, shtatzënisë, orientimit seksual apo moshës.

Nëpunësit civilë duhet të veprojnë në pajtim me parimet e shërbimit civil në kontaktet e tyre me zyrtarët qeveritarë, me kolegët e tyre të Shërbimit Civil dhe me publikun. Zyrtarët qeveritarë duhet të veprojnë në pajtim me këto parime gjatë kontakteve të tyre me të gjithë nëpunësit civilë.<sup>142</sup>

Spektori publik, privat si dhe institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive në sektorin e punës dhe të punësimit, sigurojnë të drejta dhe mundësi të barabarta për femra dhe meshkuj.<sup>143</sup>

Punëdhënësi/Punëdhënësja siguron që femrat dhe meshkujt të kenë mundësi të barabarta për të vazhduar shkollimin dhe aftësimin profesional dhe të përcjellin trajnimet të cilat mbahen për të shtuar shkathhtësi të profesionale ose të përgatiten për profesione të tjera.<sup>144</sup>

Punëdhënësi/Punëdhënësja apo institucioni që bën aftësimin profesional dhe secili individ që merr pjesë në aftësimin profesional nuk u lejohet që të diskriminojnë asnjë individ në baza gjinore.<sup>145</sup>

Punëdhënësi/Punëdhënësja, duhet të sigurojë trajtim të barabartë për femra dhe meshkuj në sektorin e punës, dhe të marrë masa në mënyrë që profesionet të mos jenë të kategorizuara si punë specifike vetëm për femra ose vetëm për meshkuj.<sup>146</sup>

Rregullorja e UNMIK -ut nr. 2001/27 rregullon punësimin në Kosovë, duke përfshirë edhe marrëdhëniet e punës sipas të cilave kryhen punët ose shërbimet. Marrëdhënia e punës në kuadër të shërbimit publik, UNMIK, KFOR dhe zyrat

---

140 Neni 12.4. LBGJ.

141 Neni 1 (a) i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës

142 Po aty Neni 2.2 dhe 2.3

143 Neni 12.1. -LBGJ.

144 Neni 12.6.-LBGJ.

145 Neni 12.7. LBGJ

146 Neni 12.8. LBGJ

apo përfaqësitë e qeverive të huaja dhe të organizatave ndërkombëtare qeveritare nuk rregullohen me këtë rregullore.

Sipas Neni 2 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2001/27, të gjitha llojet e diskriminimit në punësim janë të ndaluara. Ky nen përcakton:

- 2.1 Diskriminimi në punësim dhe në profesion është i ndaluar. Fjalët punësim dhe profesion përfshijnë qasjen ndaj aftësisimit profesional, qasjen ndaj punësisimit dhe ndaj profesioneve të caktuara si dhe kushtet e punësisimit.
- 2.2 Fjala diskriminim përfshin çdo dallim, përjashtim ose dhënie të përparësisë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, moshës, gjendjes familjare, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose sociale, orientimit seksual, gjuhës ose anëtarësisë sindikale e cila ka fuqinë e anulimit ose të dëmtimit të mundësive të barabarta ose trajtimit në punësim a në profesion.
- 2.3 Çdo dallim, përjashtim ose preferencë përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune në bazë të kushteve tipike të tij nuk konsiderohet si diskriminim.
- 2.4 Diskriminimi ndaj një personi me të meta, gjasat e të cilit për sigurimin, ruajtjen ose përparimin në një punë të përshtatshme janë të zvogëluara në mënyrë të konsiderueshme si pasojë e të metave mendore a fizike të konstatuara me kohë, është i ndaluar.
- 2.5 Diskriminimi qoftë i drejtëpërdejtë ose i tërthortë ndaj ndonjë femre punonjëse si rrjedhojë e shtatzënisë ose lindjes është i ndaluar.
- 2.6 Ngacmimi seksual në vendin e punës është i ndaluar.

Ndalohet diskriminimi gjinor me ligj në të gjitha fushat e jetës shoqërore në Kosovë, është përcaktuar në LBGJ.<sup>147</sup>

Kriteret dhe kushtet për zgjedhjen e kandidatëve për vende të punës në çdo degë veprimtarie, në të gjitha shkallët profesionale, në sektorin publik dhe privat, vendosen mbi bazat e barazisë gjinore.<sup>148</sup>

Sektorin publik, privat si dhe institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive në sektorin e punës dhe të punësisimit, sigurojnë të drejta dhe mundësi të barabarta për femra dhe meshkuj.<sup>149</sup>

Neni 3.3 i Urdhërësës Administrative Nr. 2003/2, zbatim i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës parasheh: Punësimi në Shërbimin civil bëhet sipas një konkurrence të ndershme e të hapur, në bazë të meritës dhe në pajtim me parimin e përfaqësisimit të barabartë të komuniteteve në Kosovë dhe përfaqësisimit të barabartë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet në pajtim me nenin 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 dhe nenin 2.1 (g) dhe (h) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36. Kjo duhet të bëhet në pajtim me shkallët e posaçme të përfaqësisimit të komuniteteve që mund të zbatohet për pjesë të ndryshme të Shërbimit civil, që nxirren herë pas here nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

147 Neni 18.2.-LBGJ.

148 Neni 12.4. LBGJ.

149 Neni 12.1. –LBGJ.

Urdhëresa Administrative Nr. 2003/2, zbatim i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës në Nenin 10.1 Përcakton: Të gjitha organet e punësimit duhet t'i monitorojnë dhe zbatojnë procedurat me qëllim të sigurimit të përfaqësimit shumetnik dhe të balancit gjinor brenda ministrive të tyre, brenda komunës ose agjencisë ekzekutive në pajtim me nenin 3.3 dhe mund t'i shfrytëzojnë sipas nevojës, ndër të tjera edhe masat e mëposhtme të veprimit pozitiv: ...Mos t'i përjashtojnë grupet e veçanta etnike apo gjinitë nga konkurrenca e hapur dhe meritore për postet e veçanta që nuk kanë kritere legjitime etnike apo gjinore për kualifikim për atë post dhe

Neni 10.3 i Urdhëresës Administrative nr. 2003/02 përcakton obligimin e Ministrisë së Shërbimeve Publike që të: "përpilon një udhëzim administrativ i cili duhet t'i përmbajë kriteret dhe procedurat e mëtejme për zbatimin dhe monitorimin e përfaqësimit të drejtë në Shërbimin civil në të gjitha nivelet". Në këtë drejtim është nxjerrë Udhëzimi Administrativ Nr.MSHP/DASHC 2003/12, (12.09.2003) Procedurat e Mundësive të Barabarta.

Qëllimi i Procedurave të Mundësive të Barabarta, i përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr.MSHP/DASHC 2003/12, është që t'u shërbejë autoriteteve punëdhënëse me instruksion si udhëzim për t'i aftësuar ata për t'u përballur me përgjegjësitë ligjore për ndërtimin e një shërbimi civil të bazuar në Mundësi të Barabarta ku nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik, përkatësisë kombëtare, etnike apo sociale, lidhjes me ndonjë komunitet nacional, pronës, lindjes, aftësisë së kufizuar, statusit familjar, shtatzënisë, orientimit seksual apo të moshës.<sup>150</sup>

Ligji për Barazi Gjinore, në nenin 12.5 përcakton: "Punëdhënësi/Punëdhënësjë është i/e detyruar të paguajë pagë të njëjtë për femra dhe meshkuj, për punën e njëjtë dhe për punën me vlerë të njëjtë, si dhe siguron kushtet e barabarta të punësimit dhe të punës dhe të gjitha të drejtat e barabarta të punës"<sup>151</sup>. Me Rregulloren e UNMIK -ut nr. 2001/27 (8 tetor 2001) për Ligjin themelor të punës në Kosovë, rregullohet punësimi në Kosovë, duke përfshirë edhe marrëdhëniet e punës sipas të cilave kryhen punët ose shërbimet. Ndërsa, në nenin 13 përcaktohet se "punëdhënësi u paguan për të njëjtën punë një shumë të barabartë femrave dhe meshkujve, e cila përfshin pagën/rrogën bazë dhe çdo pagesë ose të ardhur tjetër, që iu paguhet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me para të gatshme ose në natyrë nga punëdhënësi. Ligji themelor i punës në Kosovë përcakton se inspektori i punës siguron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe të dispozitave të tjera përkatëse të ligjit në fuqi që kanë të bëjnë me kushtet në vendin e punës, me orarin e punës, me pagën/rrogën, me sigurinë dhe me shëndetin<sup>152</sup>.

150 Udhëzim Administrativ Nr.MSHP/DASHC 2003/12, (12.09.2003) Procedurat e Mundësive të Barabarta.

151 Neni 12.5-LBGJ

152 Neni 24.4. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27 - 8 tetor 2001 për Ligjin themelor të punës në Kosovë.

Ligji për barazi gjinore, në nenin 12.5 përcakton: “Punëdhënësi/Punëdhënësjja, është i/e detyruar të paguajë pagë të njëjtë për femra dhe meshkuj, për punën e njëjtë dhe për punën me vlerë të njëjtë, si dhe siguron kushtet e barabarta të punësimit dhe të punës dhe të gjitha të drejtat e barabarta të punës”.

Në nenin 13 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë, përcaktohet se “punëdhënësi u paguan për të njëjtën punë një shumë të barabartë femrave dhe meshkujve, e cila përfshin pagën/rrogën bazë dhe çdo pagesë ose të ardhur tjetër, që iu paguhet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me para të gatshme ose në natyrë nga punëdhënësi.”<sup>153</sup>

Neni 15.14. i LBGJ-së përcakton: Femrat dhe meshkujt kanë të drejtë për qasje të barabartë në sistemin e sigurisë dhe mirëqenies sociale gjatë tërë jetës.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale është përgjegjëse e gjithmbarshme për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë dhe siguron që të gjithë banorët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale dhe familjare pa asnjë dallim, siç është raca, përkatësia etnike, gjinia, gjuha, religjioni, mendimi politik, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose diçka tjetër.<sup>154</sup>

Ligji për shërbime sociale dhe familjare përcakton dhe rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë.<sup>155</sup>

Ligji për shërbime sociale dhe familjare në Nenin 1.2. përcakton: Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Përveç në rrethana të jashtëzakonshme të nevojës dhe të mbrojtjes, këto shërbime do t’u ofrohen personave në nevojë dhe familjeve në suaza të komunitetit e jo nëpër institucione rezidenciale.

Ligji mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor dhe mekanizmat e mbrojtjes dhe të sigurimit të këtyre të drejtave dhe përgjegjësi.<sup>156</sup>

153 Neni 13. Rregullore e UNMIK –ut nr. 2001/27 (8 tetor 2001) për Ligjin themelor të punës në Kosovë.

154 Neni 2.1. Rregullorja e UNMIK –ut nr. 2005/46 (14 tetor 2005) Për shpalljen e Ligjit mbi shërbimet sociale dhe familjare të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare.

155 Rregullorja e UNMIK –ut nr. 2005/46 (14 tetor 2005) Për shpalljen e Ligjit mbi shërbimet sociale dhe familjare të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare.

156 Rregullorja e UNMIK –ut nr.2004/47 (19 nëntor 2004) për shpalljen e Ligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të

## FAQE 61

Rregullorja e UNMIK-ut mbi Pensionet në Kosovë përcakton dhe përshkruan format e ndryshme të sigurimit pensional qeveritar dhe privat në Kosovë. Vetëm administrata e pensioneve, Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës, fondet pensionale plotësuese të punëdhënësit ose siguruesit e pensioneve të licencuar për sigurimin e pensioneve plotësuese individuale në pajtim me këtë Rregullore mund të sigurojnë pensione në Kosovë.<sup>157</sup>

Kompania që siguron anuitete<sup>158</sup> nuk mund të imponojë kushte apo shkallë të posaçme për shkaqe të shëndetit, gjinisë, racës, religjionit, kombësisë ose kritereve të tjera të ngjashme.<sup>159</sup>

Qëllimi i Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës<sup>160</sup>, është që të parandalohen lëndimet në punë, sëmundjet profesionale në vendin e punës dhe të mbrohet ambienti i punës.

Në pajtim me Nenin 2 të Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës Punëdhënësi është i obliguar të krijoj kushtet për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës për punëmarrësit e tij/saj. Punëdhënësi është i obliguar për ti mbuluar të gjitha shpenzimet për kurimin e të lënduarve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Krijimi i fondit për sigurimin shëndetësor, nga kontributet e punëdhënësve për të gjithë punëmarrësit, i liron punëdhënësit prej obligimeve për bartjen e shpenzimeve. Punëdhënësi është i obliguar të organizoi dhe të ndërmer masa të nevojshme për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, trajnimeve, organizimit përkatës dhe masave të duhura për të siguruar, mirëmbajtur makinerinë, instrumentet, pajisjet, veglat, vendin e punës, mundësit për të shkuar në vendin e punës.<sup>161</sup>

Ligji për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit të Punës u siguron një mbrojtje të veçantë të Rinjve, Grave dhe Personave me aftësi të kufizuara. Në Nenin 4 të këtij ligji është përcaktuar: Punëmarrësit deri në moshën 18 vjeçare, gratë shtatzëna, personat me aftësi të kufizuara për punë, nuk mund të sistemohen në punë veçanërisht të rënda, punë më të gjatë se orari

---

Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror.

157 Rregullore e UNMIK-ut nr. 2005/20 (29 prill 2005) për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë

158 "Anuitet" do të thotë një polisë të cilën një pjesëmarrës e ka blerë nga një kompani e sigurimit e shprehur në formë të pagesave mujore për tërë jetën e pjesëmarrësit ose të shfrytëzuesit të tij siç është paraparë në këtë Rregullore.

159 Neni 13.11 Rregullore e UNMIK-ut nr. 2005/20 (29 prill 2005) për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë.

160 Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/33 (6 nëntor 2003) Për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës lidhur me Ligjin mbi sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës.

161 Neni 2, Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/33 (6 nëntor 2003) Për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës lidhur me Ligjin mbi sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës.

i plotë i punës dhe në punë të natës.<sup>162</sup>

Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2003/2, përcakton: Çdo organ i punësimit duhet të garantojë që nëpunësitë civilë të kenë një ambient të sigurt e të shëndetshëm pune. Ankesat dhe pakënaqësitë lidhur me ambientin e punës duhet t'i drejtohen menaxherit kadrovik të organit të punësimit dhe t'i drejtohen komisionit të ankesave.<sup>163</sup>

Korniza ligjore e Kosovës përfshin të drejtat e grave që të mbajnë punën e tyre dhe të kthehen pas pushimit të lindjes. Neni 13.13 i Ligjit për barazi gjinore përcakton ndalimin e përfjashtimit nga puna, pushimi i përkohshëm nga puna, padrejtësia lidhur me sigurinë në punë, kushtet e punës ose vlerësimin e punës së tij/saj si pasojë e ankesës së tij/saj për ngacmim seksual ose diskriminim në bazë të gjinisë. Për më tepër, neni 12.8 i Ligjit për barazisë gjinore përcakton që "punëdhënësit duhet të sigurojnë trajtim të barabartë për femra dhe për meshkuj në sektorin e punës dhe të marrë masa në mënyrë që profesionet të mos jenë të kategorizuara si punë specifike vetëm për femra ose vetëm për meshkuj". Përkundër, dispozitave të përgjithshme që rregullojnë sigurinë dhe shëndetin në punë, korniza ligjore e Kosovës nuk ka rregulla të veçanta që garantojnë sigurinë e vendit të punës dhe shëndetin e grave shtatzëna dhe të atyre që ushqejnë foshnjën me gji. Në Kosovë, pushimi i lindjes për gra, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, zgjatë 12 javë. Derisa në sektorin publik paguhet 100 % nga paga e plotë në atë privat, paguhet më së paku 2/3 nga paga e plotë.

Punonjëset shtatzëna kanë të drejtë të bëjnë kontrollet e rregullta mjekësore pa humbje të pagës, nëse ato kontrolle duhen të bëhen gjatë orarit të punës.

Çdo banor i përhershëm i Kosovës ose personi i cili i plotëson kushtet për t'u regjistruar si banor i përhershëm i Kosovës ka të drejtë, për kujdes shëndetësor që është i kushtëzuar me gjendjen e tij të shëndetit. Kujdesi shëndetësor duhet të jetë adekuat, me qasje në vazhdimësi për të gjithë dhe pa diskriminim.<sup>164</sup>

Ligji mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror përcakton: Ofrimi i shërbimeve është pa asnjë diskriminim, atëherë kur gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore qytetarët nuk janë të diskriminuar në bazë të pozitës së tyre shoqërore, pikëpamjeve politike, prejardhjes, kombësisë, religjionit, gjinisë, preferencave seksuale, moshës, gjendjes martesore, paaftësisë trupore ose mendore, kualifikimit ose mbi

<sup>162</sup> Neni 4, Rregullores e UNMIK-ut nr. 2003/33 (6 nëntor 2003) Për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës lidhur me Ligjin mbi sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës.

<sup>163</sup> Neni 34, Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2003/2 (25 janar 2003) zbatim i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.

<sup>164</sup> Neni 4.1. Rregullorja e UNMIK –ut nr.2004/47 për shpalljen e ligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

## FAQE 63

çfarëdo baze tjetër, e cila nuk është e lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore.<sup>165</sup>

Legjislacioni kosovarë nuk ka norma ligjore të përcaktuara saktë me të cilat do të ndalohej prishja e kontratës së punësimit me gruan shtatzënë dhe me gruan që ka fëmijë nën moshën tre vjeçare.

Diskriminimi qoftë i drejtëpërdetjtë ose i tërthortë ndaj ndonjë femre punonjëse si rrjedhojë e shtatzënisë ose lindjes është i ndaluar, është përcaktuar në Rregulloren e UNMIK –ut nr. 2001/27 për ligjin themelor të punës në Kosovë.<sup>166</sup>

Neni 12.13. i LBGJ përcakton: Ndalohet përjashtimi nga puna, pushimi i përkohshëm nga puna, padrejtësia lidhur me sigurinë në punë, kushtet e punës ose vlerësimin e punës së tij/saj si pasojë e ankesës së tij/saj për ngacmim seksual ose diskriminim në bazë të gjinisë.

Ligji për inkurajimin dhe mbrojtjen e të ushqyerit të fëmijëve me qumësht, në Nenin 14, përcakton që: Punëdhënësi nuk mund të ndërpres marrëdhënien e punës të punësuarës që ushqen foshnjën me gji e cila gjendet në pushimin e lehonisë. Punëdhënësi nuk mund të ndërpres kontratën e punës të punësuarës që ushqen foshnjën me gji për shkak të së drejtave të saj të përcaktuara me këtë ligj. Punëdhënësi është i detyruar që në rast të ndërprerjes së kontratës të punësuarës që ushqen foshnjën me gji për arsye tjera nga paragrafi 2, të beje arsyetimin e këtij veprimi me shkrim. Në rast të shkeljeve të dispozitave ligjore nga ky nen, punëdhënësi detyrohet që të paguaj dëmshpërblimin adekuat për kompensimin material që do të kishte takuar të punësuarës që ushqen foshnjën me gji për 6 muajt e ardhshëm. Në rastet nga paragrafi 2, punësuarja që ushqen foshnjën me gji ka të drejtë për vazhdim të pagesës nga paragrafi 4 për 6 muaj tjerë nga fondet e sigurimit shëndetësore ose në mungesë të këtyre fondeve nga fondet sociale.

Ligji për Barazi Gjimore në Kosovë parasheh edhe dispozitat ndëshkuese për shkeljet e tij.

Në rast të përjashtimit nga puna të një të punësuarit/punësuarëve në rastin kur ai/ajo kërkon zbatimin LBGJ-së apo përjashtimi nga puna, pushimi i përkohshëm nga puna, padrejtësia lidhur me sigurinë në punë, kushtet e punës ose vlerësimin e punës së tij/saj si pasojë e ankesës së tij/saj për ngacmim seksual ose diskriminim në bazë të gjinisë, Punëdhënësi/Punëdhënësjja, dënohet me gjobë prej 5,000 deri në 10,000 Euro ndërsa Personi përgjegjës, dënohet me gjobë prej 1.000 deri 3.000.<sup>167</sup>

---

<sup>165</sup> Neni 4.5. Rregullorja e UNMIK –ut nr.2004/47 për shpalljen e ligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

<sup>166</sup> Neni 2.5. Rregullore e UNMIK –ut nr. 2001/27 për ligjin themelor të punës në Kosovë.

<sup>167</sup> Neni 16 (paragrafi 3) (Dispozitat Ndëshkuese) LBGJ.

Po ashtu edhe Neni 9 i LKD-së parasheh Sanksionet për shkeljet e tij. Gjykata kompetente ose organi administrativ që ka konstatuar se është bërë shkelje e LKD-së mund të shqiptojë sanksione varësisht nga natyra dhe lloji i shkeljes si dhe ndikimi i saj në viktimën apo viktimat.<sup>168</sup>

Sipas LKD-së gjykata mund të shqiptojë edhe urdhëresa të tjera sipas vlerësimit të saj. Shqiptimi i cilit do sanksion që parashihet me LKD nuk përjashton shqiptimin e ndonjë ligji tjetër që është në fuqi në Kosovë.<sup>169</sup>

Në Kosovë, pushimi i lindjes për gra, si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat, zgjat 12 javë. Gjersa në sektorin publik paguhet 100% nga paga e plotë, në atë privat paguhet më së paku dy të tretat nga paga e plotë.

Neni 23 i Urdhëresës Administrative Nr. 2003/2, zbatim i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës, përcakton: Nënpunësit civile kanë të drejtë në pushim të lindjes me pagesë prej dymbëdhjetë (12) javësh për lindjen e çdo fëmije, që paguhet në shkallën e zakonshme të rrogës, lindje e cila duhet të vërtetohet nga një mjek i pranuar. Me kërkesën e nëpunësit civil mund të jepet pushim plotësues pa pagesë për lindje në bazë të vlerësimit të lirë të organit të punësimit më së shumti deri në katërdhjetë (40) javë plotësuese. Menjëherë pas rifillimit të punës, përkatësisht pas pushimit të lindjes me ose pa pagesë, nëpunësit civile mund t'i jepen gjithsej dy (2) orë me pagesë të zbritura nga orari ditor i punës gjatë gjashtë (6) muajve të parë për dhënien gji fëmijës dhe një orë në ditë pas këtij afati, që vazhdon deri në fund të muajit të nëntë pas lindjes së fëmijës. Nënpunësit civilë meshkuj kanë të drejtë në dy (2) ditë pushim atësie për lindjen e çdo fëmije. Me kërkesën e nëpunësit civil mashkull mund t'i jepet pushim plotësues i atësisë pa pagesë sipas të drejtës së organit të punësimit më së shumti deri në pesë (5) ditë. Pushimi prindor duhet të shfrytëzohet për qëllimin që jepet dhe nuk mund të akumulohet apo të shndërrohet pjesërisht ose tërësisht në të holla të gatshme.<sup>170</sup>

Punonjëset e shërbimit civil kanë të drejtë për pushim lehonie të paguar deri në 12 javë rresht dhe kjo është për secilin fëmijë të lindur, ky pushim mund të merret pas konfirmimit të shtatzënisë nga ana e mjekut të kualifikuar. Pushimi

<sup>168</sup> Neni 9-LKD-Sanksionet e parapara me vendimin e organit kompetent ndaj personit fizik dhe juridik të cilit cenonin dispozitat e LKD-së përfshijnë: a). Kompezimin për dëmin material dhe moral i shkaktuar nga cenimi i dispozitave të këtij ligji, përfshinë kthimin e të drejtave dhe masat e tjera të parapara me legjislacionin në fuqi, e të cilat organi kompetent i vlerëson si të përshtatshme b). Çdo personi fizik dhe juridik ose kombinim i tyre, i cili ka cenuar dispozitat e këtij ligji, i shqiptohet dënimi me gjobë në bazë të natyrës dhe shkalles së shkeljes, si në vijim: (i) personi fizik, prej 500 deri 1.000 euro; (ii) kontraktuesi i pavarur, prej 1.000 deri 5.000 euro; (iii) personat juridik prej 1.000 deri 10.000 euro; (iv) personi fizik brenda personit juridik i cili është përgjegjës për shkelje prej 500 deri 2.000 euro; (v) personi i cili ushtron funksion publik i cili është përgjegjës për shkelje prej 500 deri 2.000 euro.

<sup>169</sup> Neni 9.3 dhe 9.6-LKD.

<sup>170</sup> Neni 23 Urdhëresa Administrative Nr. 2003/2, zbatim i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.



i lehonisë mund të autorizohet nga Menaxheri i Personelit. Pushimi i paguar i lehonisë mund të përdoret për qëllimin të cilin është caktuar, dhe nuk mund të grumbullohet ose zëvendësohet me të holla pjesërisht ose në tërësi. Punonjësja do të bie dakord për datën me menaxherin e saj, kur të filloj pushimi i lehonisë, por zakonisht nuk mund të jetë më shumë se 10 javë përpara se të pritet data e lehonisë. Pas përfundimit të pushimit me pagesë me kërkesën e nëpunëses si dhe me lejin e autoriteteve punëdhënëse mund t'i jepet edhe një pushim pa pagesë prej maksimum 40 javëve ose deri në fund të kontratës, cila të është periudhë më e shkurtë. Pushimi pa pagesë i lehonisë mund të shfrytëzohet vetëm për qëllimin për të cilin është caktuar, dhe nuk mund të grumbullohet ose zëvendësohet pjesërisht ose plotësisht me të holla. Në post pas kthimit prej pushimit të lehonisë Pas përfundimit të pushimit të lehonisë, me pagesë dhe atij pa pagesë, nëpunëset në shërbimin civil, kanë të drejtë që të kthehen në pozitën e tyre të punës apo në një pozitë ekuivalente brenda Ministrisë apo Komunës së njëjtë me normë të njëjtë pagese. Para se ajo të filloj pushimin e lehonisë, punonjësja, menaxheri dhe Menaxheri i Personelit do të diskutojnë dhe miratojnë për postin në të cilin punonjësja do të caktohet me rastin e kthimit prej pushimit të lehonisë. Pushimi i lehonisë, i paguar ose i papaguar, nuk dëmton epërsinë e punonjësës. Pas kthimit në punë prej pushimit me pagesë ose papagesë të lehonisë, punonjësja ka të drejtë për zvogëlimin prej dy orëve të punës me pagesë për çdo ditë për një periudhë 6 mujore pas lindjes së fëmijut; dhe 1 orë për çdo ditë deri në fund të muajit të 9të pas lindjes së fëmijut. Punonjësja do të diskutojë dhe miratojë me menaxherin e saj kohët gjatë të cilave ajo do të vijojë punën gjatë këtyre periudhave. Menaxheri drejtues do të mbaj regjistrin e orëve të punuara, dhe paraqet ato të Menaxheri i Personelit në fund të muajit të 9të pas lindjes së fëmijut për ta përfshirë në dosjen konfidenciale personale të punonjësës.<sup>171</sup>

Ligji për barazi gjinore në nenin 12.9. përcakton se, punëdhënësit marrin masa të nevojshme për t'ua mundësuar femrave dhe meshkujve që të bëjnë përshtatje të detyrimeve të tyre profesionale dhe ato familjare. Në pajtim me nevojat e tregut të punës dhe gjendjen familjare të të punësuarve, organizimi i punës dhe i orarit të punës bëhet në mënyrë që të sigurojë kthimin në vendin e njëjtë të punës edhe pas pushimit të lindjes, edhe pas pushimit prindëror, edhe pas pushimit të abortit, edhe pas pushimit mjekësor, si dhe pas kohës së kaluar jashtë vendit të punës për shkaqe urgjente familjare, apo për shkaqe të aftësimeve profesionale.

Legjislacioni kosovar nuk ka norma ligjore të përcaktuara saktë me të cilat do të ndalohej prishja e kontratës së punësimit me gruan shtatzënë dhe me gruan që ka fëmijë nën moshën trevjeçare.

Neni 23, i Kontratës së Përgjithshme Kolektive në Kosovë, rregullon Pushimin e lehonisë: Femra e punësuar gjatë kohës së shtatzënisë dhe lindjes ka të drejtë

<sup>171</sup> Udhëzimi Administrativ Nr.MSHP/DAShC 2003/10 , datë 20.05.2003 Procedura e Pushimeve.

në pushim lehonie prej gjashtë (6) muajsh pa ndërprerë.

Pushimi i lehonisë njihet si periudhë kohore pune, dhe për tre (3) muajt e parë të pushimit të lehonisë paguhet nga punëdhënësi prej jo më pak se 70 për qind nga paga e të punësuarës, kurse për tre (3) muajt e tjerë vijues pagesa bie në ngarkesë të Fondit të Qeverisë së Kosovës për mbrojtjen e maternitetit, jo më pak se 70 për qind të pagës së të punësuarës. Gjatë pushimit pa pagesë, femrës së punësuar i pushojnë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, përveç sigurimit shëndetësor. Në bazë të konstatimit të organit kompetent shëndetësor, femra e punësuar mund ta fillojë pushimin e lehonisë dyzet e pesë (45) ditë para lindjes, kurse domosdo njëzetetë (28) ditë para lindjes. I ati i fëmijës mund ta shfrytëzojë mbrojtjen, përkatësisht të drejtat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, në rast vdekjeje të nënës së fëmijës ose në qoftë se ajo braktis fëmijën, duke u bazuar në konfirmimin e organit kompetent, gjegjësisht Qendrës për Punë Sociale. Në bazë të kërkesës personale me shkrim, femra e punësuar mund ta fillojë punën para se fëmija ta mbushë moshën gjashtëmujore (6), mirëpo jo para skadimit të dyzet e pesë (45) ditëve. Fëmija, i cili domosdo ka nevojë për përkujdesje të veçantë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, përkatësisht fëmija i cili është rëndë i hendikepuar në kuptim të dispozitave për sigurimin shëndetësor, njëri prej prindërve me skadimin e pushimit të lehonisë ka të drejtë, që të punojë me gjysmën e orarit të plotë të punës derisa fëmija t'i mbushë dy (2) vjeç.<sup>172</sup>

Në Kodin Penal, parashihet përgjegjësi penale për mohimin apo kufizimin e të drejtave të grave nga lëmi i punës. Sipas nenit 182, "Kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive mbi punësimin apo pushimin e marrëdhënies së punës, për pagën apo të ardhurat e tjera, për kohëzgjatjen e orarit të punës, për pushim apo mungesë në punë, mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me paafësi apo për punën jashtë orarit ose për punën e natës dhe në këtë mënyrë punëtorit ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit".<sup>173</sup>

Ligji për Shëndetësi i Kosovës përcakton format e kujdesit shëndetësor, që sigurohen dhe zbatohen falas në institucionet publike shëndetësore, që, ndër të tjera përfshin edhe kujdesin shëndetësor riprodhues, kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonisë, si dhe metodat e planifikimit të familjes përveç ndërprerjes së dhunshme të shtatzënisë.<sup>174</sup>

Qëllimi i Ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, është parandalimi i lëndimeve në punë, i sëmundjeve

172 Neni 23, Kontrata e Përgjithshme Kolektive në Kosovë.

173 Kodi Penal, Neni 182.

174 Neni 22.2 (b) Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/31, 20 gusht 2004, Për shpalljen e Ligjit për shëndetësi në Kosovë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/4 për shëndetësi. (Ligjit për shëndetësi)

profesionale në vendin e punës dhe mbrojtja e ambientit të punës.<sup>175</sup> Ndërsa në nenin 3 janë përcaktuar të drejtat dhe përgjegjësitë e punëmarrësit. Në këtë drejtim punëmarrësi ka të drejtë dhe obligim për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe të ambientit të punës. Punëmarrësi është i obliguar t'u përmbahet masave të nevojshme për siguri në punë, mbrojtjes së shëndetit të të punësuarve dhe të ambientit të punës, të kujdeset për sigurinë dhe shëndetin e tij/saj dhe të personave të tjerë të ndikuar nga veprimet e tij/saj në punë, të shfrytëzojë në mënyrë të duhur mjetet e sigurisë dhe PPM-në (pajisjet personale mbrojtëse), t'i përdor ato me kujdes dhe t'i mbajë në gjendje funksionale. Punëmarrësit gjithashtu duhet të kenë përgjegjësi që të sigurojnë mbrojtje dhe shëndet të gjithë personave të ndikuar nga veprimet në punën e tyre. Në nenin 4 të Ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, është përcaktuar si vijon: "Punëmarrësit nën moshën 18 vjeçare, gratë shtatzëna, personat me aftësi të kufizuar për punë, nuk mund të sistemohen në punë veçanërisht të rënda, punë më të gjatë se orari i plotë i punës dhe në punë të natës."<sup>176</sup>

Në nenin 2 të Ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, janë përcaktuar obligimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësit, i cili është i obliguar të krijojë kushte për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe të ambientit të punës për punëmarrësit e tij/saj. Punëdhënësi është i obliguar t'i mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të lënduarve në punë dhe për shërimin e sëmundjeve profesionale. Krijimi i fondit për sigurimin shëndetësor nga kontributet e punëdhënësve për të gjithë punëmarrësit, i liron punëdhënësit prej obligimeve për bartjen e shpenzimeve të transportit. Punëdhënësi është i obliguar të organizojë dhe të ndërmarrë masa të nevojshme për sigurinë në punë, për mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe të ambientit të punës, përfshirë këtu edhe parandalimin e rreziqeve në punë, ofrimin e informatave, organizimin e trajnimeve, organizimet përkatëse dhe ndërmarrjen e masave të duhura për t'i siguruar dhe për t'i mirëmbajtur makinerinë, instrumentet, pajisjet, veglat, vendin e punës, mundësitë për të shkuar në vendin e punës. Punëdhënësi është përgjegjës për organizimin dhe zbatimin e masave për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe të ambientit të punës. Punëdhënësi do të kontrollojë suksesin e masave të ndërmarra dhe doemos do të ndërmarrë masat e duhura për përmirësim të mëtejshëm. Ndërmarrja me më shumë se 50 të punësuar, duhet ta caktojë një referent për siguri në punë me orar të shkurtuar të punës (agjent për siguri në punë). Ndërmarrja me më shumë se 250 të punësuar duhet ta caktojë një referent për siguri në punë me orar të plotë të punës. Punëdhënësi do të bëjë vlerësim të hollësishëm mbi rreziqet për secilin vend të punës.

Ligji për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit

175 Neni 1.Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/33 - 6 nëntor 2003 - për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës lidhur me Ligjin mbi sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës,

176 Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/33 - 6 nëntor 2003 - për shpalljen e Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës lidhur me Ligjin mbi sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës.

të punës, në nenin 2.7 përcakton se punëdhënësi duhet ta informojë punëmarrësin për rreziqet e punëve të cilat kryhen nga ai/ajo. Punëdhënësi duhet t'i informojë punëmarrësit, të cilët do t'i ekspozohen rrezikut të lartë. Për të minimizuar rrezikun, punëdhënësi, sa më parë që të jetë e mundshme, duhet t'i informojë punëmarrësit për rreziqet dhe për masat mbrojtëse që duhet ndërmarrë. Në rast rreziku të pashmangshëm, kërcënues për vetveten dhe për personat tjerë, nëse mbikëqyrësi nuk është aty, punëmarrësit i lejohet të zbatojnë kundërmasa të përshtatshme. Duke pasur parasysh trajnimin që është bërë dhe mjetet teknike në dispozicion, punëmarrësit nuk do të pësojnë dëm për akte të tilla, përveç në rastet e neglizhencës flagrante ose sabotimit të qëllimtë. Ndërsa në nenin 15 të këtij ligji, janë paraparë edhe masat ndëshkimore për punëdhënësit të cilët i cenojnë dispozitat e neneve të këtij ligji (gjobë prej 100 deri 20 000 Euro).

Ligji për inkurajimin dhe mbrojtjen e të ushqyerit të fëmijëve me qumësht jep në Aneksin I-Listën jo komplete të faktorëve, proceseve dhe e kushteve të punës. Çdo punëdhënës është i detyruar që të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë lidhur me punët të cilat i ekspozohen rrezikshmërisë së veçantë nga agjentet e Aneksit I- i cili është pjesë përbërëse e këtij ligji, dhe përfshin.<sup>177</sup>

Në Kosovë janë themeluar një numër institucionesh për mbrojtjen dhe promovimin e barazisë gjinore. Me nxjerrjen e Ligjit për Barazi Gjinore, organ kryesor është Zyra për Barazi Gjinore. Themelimi i Zyrës për Barazi Gjinore është bërë me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 5/31, të datës 01.02.2005.

<sup>177</sup> Neni 12.1. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2007/7 (31 janar 2007) Mbi shpalljen e Ligjit për inkurajimin dhe mbrojtjen e të ushqyerit të fëmijëve me qumësht gjiri të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-81 për inkurajimin dhe mbrojtjen e të ushqyerit të fëmijëve me qumësht gjiri. Aneksin I-Lista jo komplete e faktorëve, proceseve dhe e kushteve të punës, përfshin: A. Faktorët-Faktorët fizik ku trajtohen si faktorë që shkaktojnë lëndimin e fetusit dhe/apo për përçarjen e shtrati të fëmijës, dhe në veçanti që shkaktojnë: (a) shok, dridhje apo lëvizje; (b) reagimi ndaj rrezikut nga barra e detyruar, posaçërisht ata të natyrës shpinore; (c) zhurma; (d) rrezatim jonizues (\*) (e) rrezatim jo-jonizues; (f) ftohje apo nxeheje ekstreme; (g) lëvizjet dhe gjendja, udhëtimet brenda apo jashtë ndërmarrjes, lodhjes fizike apo psikike, dhe ngarkesa tjera fizike, lidhur me aktivitetet e të punësuarës që ushqen foshnjën me gji. Faktorët Biologjik-Faktorët Biologjik të grupeve në rrezik sikur: Grupet 2, 3 dhe 3 brenda kuptimit të Nenit 2 (d) numrat 2, 3 dhe 4 të Direktivës 90/679/EEC (1), deri në atë masë që të dihet se këta faktorë apo masat terapeutike të kërkuara nga këta faktorë, rrezikojnë shëndetin e grave shtatzëna dhe të fëmijës që nuk kanë lindur ende, që nuk përmenden në Shtojcën II.

Faktorët Kimik-Faktorët kimik vijues, kur dihet se rrezikojnë shëndetin e grave shtatzëna dhe fëmijës që nuk ka lindur ende, ku me sa duket nuk përmenden në Shtojcën II: (a) Substanca e etiketuar R 40, R 45, R 46, dhe R 47 nën Direktivën 67/548/EEC (?), me sa duket nuk përmendet në Shtojcën II; (b) faktorët kimik në Shtojcën I të Direktivës 90/394/EEC (?); (c) zhiva dhe derivatet nga zhiva; (d) bari antimitotik; (e) oksid karboni; (f) faktorët kimik të njohur dhe të rrezikshëm që përcjellën (thithen) përmes lëkurës.

B. Proceset-Proceset industriale të përmendur në Shtojcën I të Direktivës 90/394/EEC.

C. Kushtet e punës-Puna nëntokësore në minierë.

Rishikimi periodik i legjislacionit mbrojtës (për sa i takon Nenit 11 të CEDAW) në dritën e njohurive shkencore dhe teknologjike, është detyrë e Zyrës për Barazi Gjinore. Kjo është përcaktuar në Nenin 5.2 të LBGJ-së. Zyra për Barazi Gjinore ka këto kompetenca: a) zbaton dhe monitoron dispozitat e këtij Ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të tij; b) i propozon qeverisë dhe ministrive hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe rregulloreve, si dhe miratimin e masave të tjera;... l) propozon nisma për hulumtim dhe analiza në fushën e barazisë gjinore;...

Gjatë kryerjes së detyrave të saj lidhur me çështjet gjinore i bashkërendon aktivitetet e saj me Zyrën këshillëdhënëse për qeverisje të mirë, për të drejta të njeriut, për mundësi të barabarta dhe gjini, ndërsa për çështjet e diskriminimit që lidhen drejtpërdrejt me gjininë trajtohen nga Njësia për Barazi Gjinore në kuadër të institucionit të Ombudspersonit të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/38, e cila po ashtu ka përgjegjësi të rishikojë projektligjet, të japë komente lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe me legjislacionin ekzistues kur ka të bëjë me çështjet gjinore.<sup>178</sup>

Edhe pse Rishikimi periodik i legjislacionit mbrojtës (për sa i takon Nenit 11 të CEDAW) në dritën e njohurive shkencore dhe teknologjike, është detyrë e Zyrës për Barazi Gjinore siç është përcaktuar në Nenin 5.2 të LBGJ-së, kjo akoma nuk kryhet.

### 11.2 Përputhja e nenit 11 me fakte

Raporti i Bankës Botërore mbi Vlerësimin e Varfërisë në Kosovë konstaton se “37 përqind e popullatës klasifikohen si “të varfër”, që jetojnë me më pak se 1.42 euro në ditë, ndërsa 15 përqind llogaritet të jenë nën varfëri ekstreme, që jetojnë me më pak se 0.93 euro për ditë”<sup>179</sup>

Ky raport në mënyrë të veçantë trajton varfërinë në kuadër të ekonomive familjare të udhëhequra nga burrat, dhe të ekonomive familjare të udhëhequra nga gratë. Raporti thekson se ekonomitë familjare me kryefamiljarë të gjinisë femërore janë shumë më të varfra sesa ato me kryefamiljarë të gjinisë mashkullore. Derisa ekonomitë familjare me kryefamiljarë të gjinisë femërore llogariten të jenë vetëm 4.7 përqind të të gjitha ekonomive familjare në Kosovë, rrezikimi i tyre nga varfëria e skajshme (28.2 përqind) është shumë më e lartë sesa për ekonomitë familjare me kryefamiljarë të gjinisë mashkullore (14.6 përqind). Shfaqja më e madhe e varfërisë të kryefamiljarët gra vie kryesisht për shkak të dallimeve gjinore në burimet e të ardhurave dhe nivelin arsimor<sup>180</sup>.

Ilustrues për shkallën e lartë të varfërisë në Kosovë, janë të dhënat nga Enti Statistikor i Kosovës, sipas të cilave në vitin 2006, ishin 42.569 familje, të cilat jetonin nga ndihmat sociale. Kjo shifër sipas statistikave ka trend të rënies,

178 Shih Neni 5-LBGJ.

179 Banka Botërore, “Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë”, 16 qershor 2005, Prishtinë

180 Po aty

shkaku i kontrollit të shtuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me kriteret që duhet plotësuar familjet për të përfituar asistencë sociale.<sup>181</sup>

Njëri prej burimeve kryesore të pasigurisë ekonomike është edhe papunësia, e cila rezulton me mungesë të mundësive të barabarta në resurset elementare për jetë.

Duke iu referuar “Raportit të Progresit për Kosovë, 2007” del se në fund të vitit 2006, numri i personave të regjistruar si të pa punë është ngritur për 2.4 përqind në krahasim me vitin 2005, ndërkaq ky numër është ngritur edhe më tej në vitin 2007. Numri i grave të papuna arrinë shifrën 47 përqind. Mosekzistenca e të dhënave zyrtare mbi papunësinë e bënë të vështirë analizimin e zhvillimeve të tregut të punës. Mungesa e statistikave ekonomike dhe sociale është veçori kryesore e ekonomisë së Kosovës. Sipas vlerësimit të fuqisë punëtore, papunësia arrinë nivelin 44.9 përqind të fuqisë aktive të punës në vitin 2006. Megjithatë, një numër i madh i të papunëve të regjistruar mund të kenë qasje në ekonominë joformale. Në përgjithësi, pjesërisht për shkak të shkallës së vlerësuar të ekonomisë së hirtë, regjistrimi i të papunëve ende nuk reflekton sistematikisht dinamikën e ekonomisë<sup>182</sup>.

Mundësitë e punësimit për gratë janë më të vogla. Sipas të dhënave nga Banka Botërore, mundësia për punësim tek gratë kapë shifrën 8.4 përqind, kurse për meshkuj 35.1 përqind. Këtë e determinojnë në masë të madhe disa nga faktorët, siç janë: qasja jo e barabartë në shkollim, braktisja e shkollimit, martesat e hershme etj.

Sipas raportit të UNIFEM-it, arsye të tjera që ndikojnë në vështirësinë e punësimit të grave janë edhe mungesa e reformave strukturore, kërkesa për rikalifikim dhe ristrukturimi i vendeve të punës.

“Gratë më të vjetra se 45 vjeç, të cilat kanë punuar më herët, por që nuk punojnë për momentin, e kanë të vështirë të adaptohen me kërkesat e tregut të ri të punës, për shkak të ndryshimeve strukturore në atë treg”<sup>183</sup>

Divizioni për Aftësi Profesionale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, organizon trajnime profesionale për personat e regjistruar si të papunë në qendrat për punësim. Numri i grave që kanë marrë pjesë në trajnime është në shpërputhje me numrin e burrave. Edhe pse ka një ngritje të përqindjes së numrit të grave pjesëmarrëse në trajnime, prapë se prapë kjo çështje mbetet ende problematike, pasi që numri i grave të papuna dhe të pakualifikuara mbetet ende i lartë, përderisa pjesëmarrja e tyre në trajnime është më e ulët në krahasim me burrat. Kjo problematikë thellohet edhe më shumë veçanërisht kur

181 Enti Statistikor

182 Komisioni i Komunitetve Europiane, Raporti i Progresit 2007 për Kosovën nën RKSOKB 1244, Bruksel, 06.11.2007

183 “Pjesëmarrja e gruas në tregun e punës në Kosovë” (Analizë krahasuese dhe hulumtim empirik), autorë: Justina Shiroka- Pula. Kosovë 2006

## FAQE 71

merren parasysh vështirësitë me të cilat përballen gratë e “pakualifikuara” sa i përket riintegrimin në tregun e punës <sup>184</sup>

Raporti i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore, “Monitorimi i mundësive të barabarta për gratë dhe burrat në Kosovë” vë në spikamë se dallimi në paga ndërmjet grave dhe burrave ligjërisht nuk ekziston në Kosovë. Megjithatë, pozita e grave në tregun e punës është e pafavorshme duke pasur parasysh faktin se në Kosovë paga mesatare e grave është më e ulët se e burrave. Njëra prej shumë arsyeve të kësaj pabarazie në paga është se gratë shumë rrallë janë të punësuara në pozita udhëheqëse dhe në fushat përkatëse në kuadër të atyre pozitave.

Në bazë të kësaj del se “dallimi i madh ndërmjet të ardhurave të grave dhe atyre të burrave në Kosovë, është shkaku kryesor pse indeksi i zhvillimit gjinor në Kosovë është relativisht i ulët”<sup>185</sup>.

Dallimi ndërmjet grave dhe burrave në shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është evident edhe për arsye tjera. “Shumë gra të moshuara e braktisin punën para se të arrijnë kufirin e moshës së punës, ngaqë shumica marrin përgjegjësitë mbi familjen dhe ekonominë familjare, ndaj nuk angazhohen në aktivitetet ekonomike.”<sup>186</sup>

Pos kësaj, kriteret që përcaktohen në shumicën e konkurseve për vende të lira të punës, janë jofavorizuese për gratë e moshës së mesme.

## XII. NENI 12



---

### Neni 12

1. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në fushën e kujdesit për shëndetin për t’u siguruar, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, mundësitë për të përfituar shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit të familjes.
  2. Megjithë dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, shtetet palë u sigurojnë grave gjatë barrës, lindjes dhe pas lindjes, shërbime të përshtatshme, po qe nevojta, falas, si dhe ushqim të përshtatshëm gjatë barrës dhe mbajtjes së fëmijës në gjij.
- 

---

184 Promovimi i punësimit – Raporti i performancës 2005/2006 (Departamenti i Punës dhe Punësimit)

185 Qendra Kosovare Për Studime Gjinore “Monitorimi i Mundësive të Barabarta për Gratë dhe Burrat në Kosovë”, 2006, faqe 26

186 Gratë dhe Burrat në Kosovë, Enti Statistikor, faqe 29

## 12.1 Përputhja e nenit 12 me ligje

Barazia dhe Gjithëpërfshirja dhe jo diskriminimi janë dy nga parimet udhëheqëse që zbatohen gjatë Kujdesit shëndetësor në pajtim me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës.<sup>187</sup>

Sipas, Ligjit për Shëndetësi të Kosovës Barazia nënkupton: Trajtimi korrekt i qytetarëve bazuar në ligj dhe respektimi i plotë i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut, të përcaktuara me konventa ndërkombëtare; Sigurimi i qasjes së plotë të kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet dhe për të gjithë qytetarët, duke siguruar për personat me aftësi të kufizuara, një qasje të lehtë fizike të kujdesit shëndetësor; Shpërndarja e drejtë e burimeve të kujdesit shëndetësor duke u bazuar në gjendjen ekonomike dhe sociale të qytetarëve.<sup>188</sup>

Gjithëpërfshirja dhe jo diskriminimi, sipas, Ligjit për Shëndetësi të Kosovës (Neni 12.5.) nënkupton:: Kujdes shëndetësor i barabartë për të gjithë qytetarët duke siguruar standardet gjatë përmbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor pa diskriminim në bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike gjendjes sociale, statusit pronësor, shkallës së aftësive fizike dhe mendore, statusit familjar dhe moshës.<sup>189</sup>

Ligji për Shëndetësi i Kosovës përcakton format e kujdesit shëndetësor, që sigurohen dhe zbatohen falas në institucionet publike shëndetësore, që, ndër të tjera përfshin edhe kujdesin shëndetësor riprodhues, kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonisë, si dhe metodat e planifikimit të familjes përveç ndërprerjes së dhunshme të shtatzënisë.<sup>190</sup>

Ligji mbi Shëndetin Riprodhues përcakton (4.1): “Çdo individ, pavarësisht nga përkatësia gjinore, ideologjike, religjioze apo kulturore, i garantohet e drejta në informim dhe edukim lidhur me shëndetin seksual e riprodhues, gjatë gjithë ciklit jetësor të saj/tij.”<sup>191</sup> Neni 5 i Ligjit mbi Shëndetin Riprodhues përcakton: “Çdo individ ka të drejtë në jetë të shëndoshë seksuale dhe riprodhuese që zgjedh me

187 Neni 12, Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2007/11, 7 shkurt 2007, për shpalljen e Ligjit mbi shëndetin riprodhues të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 02/L-76 Mbi Shëndetin Riprodhues. (Ligji Mbi Shëndetin Riprodhues).

188 Neni (Neni 12.2.) Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/31, 20 gusht 2004, Për shpalljen e Ligjit për shëndetësi në Kosovë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/4 për shëndetësi. (Ligji për shëndetësi).

189 Neni (Neni 12.5.) Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/31, 20 gusht 2004, Për shpalljen e Ligjit për shëndetësi në Kosovë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/4 për shëndetësi. (Ligji për shëndetësi).

190 Neni 22.2 (b) Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/31, 20 gusht 2004, Për shpalljen e Ligjit për shëndetësi në Kosovë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/4 për shëndetësi. (Ligji për shëndetësi).

191 . Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2007/11, 7 shkurt 2007, për shpalljen e Ligjit mbi shëndetin riprodhues të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 02/L-76 Mbi Shëndetin Riprodhues. (Ligji Mbi Shëndetin Riprodhues).



## FAQE 73

vullnetin e saj/tij. Asnjë femër nuk mund të detyrohet të mbetet shtatzënë.

Sipas, Neni 8 të Ligjit mbi Shëndetin Riprodhues: "Të gjitha femrat para dhe gjatë shtatzënësisë, gjatë lindjes dhe në lehoni, përfitojnë pa bashkëpagesë në institucionet shëndetësore publike këto shërbime:

1. këshillimin prekonceptional,
2. ndjekjen periodike dhe kujdesin shëndetësor në shtatzënësi,
3. kujdesin shëndetësor gjatë lindjes,
4. ndjekjen periodike dhe kujdesin shëndetësor në lehoni,
5. kujdesin për foshnjën.

Çdo femër ka të drejtën për mbrojtje shëndetësore gjatë shtatzënësisë së saj, për asistencë gjatë lindjes dhe të përfitojë zbatimin e metodave e praktikave që minimizojnë rrezikun për shëndetin e saj ose shëndetin e fetusit, të të porsalindurit dhe të fëmijës.<sup>192</sup>

Neni 22.2. i Ligjit për Shëndetësi përcakton format e kujdesit shëndetësor që sigurohen dhe zbatohen, falas në institucionet publike shëndetësore, të cilat janë si vijon:

- a. Kujdesi shëndetësor parandalues:
  - i. zbulimi i hershëm i sëmundjeve ngjitëse dhe zbatimi i detyrueshëm i imunizimit,
  - ii. sigurimi i kushteve për grumbullimin e gjakut dhe krijimin e rezervave të gjakut,
  - iii. zbulimi i hershëm dhe trajtimi adekuat i sëmundjeve që shkaktojnë zvogëlimin e aftësive fizike dhe mendore,
  - iv. masat e tjera nga nenet 34 deri 37 të këtij Ligji;
- b. Kujdesi shëndetësor riprodhues, që përfshin kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënësisë, lindjes dhe lehonisë, si dhe metodat e planifikimit të familjes përveç ndërprerjes së dhunshme të shtatzënësisë;
- c. Kujdesi shëndetësor për pacientët të cilët lëngojnë nga sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet të cilat e rrezikojnë seriozisht ose e vështirësojnë jetën e tyre, të cilat do të rregullohen me akt të veçantë nën-ligjor;
- d. Kujdesi shëndetësor rehabilitues i integruar në tri nivelet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet dhe lëndimet e përcaktuara me akt të veçantë nën-ligjor;
- e. Kujdesi shëndetësor në kushte spitalore për qytetarin në stadin terminal duhet të ofrohet në shtëpinë e qytetarit nga ana e qendrës së mjekësisë familjare.<sup>193</sup>

Me Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor

<sup>192</sup> Neni 8. Ligji për shëndetësi.

<sup>193</sup> Neni 22.2. Ligji për shëndetësi.

përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor dhe mekanizmat e mbrojtjes dhe të sigurimit të këtyre të drejtave dhe përgjegjësiive.<sup>194</sup>

Çdo qytetar ka të drejtë, për kujdes shëndetësor që është i kushtëzuar me gjendjen e tij të shëndetit. Kujdesi shëndetësor duhet të jetë adekuat, me qasje në vazhdimësi për të gjithë dhe pa diskriminim. Ofrimi i shërbimeve është pa asnjë diskriminim, atëherë kur gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore qytetarët nuk janë të diskriminuar në bazë të pozitës së tyre shoqërore, pikëpamjeve politike, prejardhjes, kombësisë, religjionit, gjinisë, preferencave seksuale, moshës, gjendjes martesore, paaftësisë trupore ose mendore, kualifikimit ose mbi çfarëdo baze tjetër, e cila nuk është e lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore.<sup>195</sup>

Neni 9 i Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor përcakton: Qytetari ka të drejtë që të pranojë informatën e plotë, në një formular individual. Qytetari ka të drejtë, që të pranojë informata të detajizuara lidhur me:

- a. gjendjen e shëndetit të tij, përfshirë këtu edhe vlerësimin mjekësor;
- b. ekzaminimet dhe intervenimet e rekomanduara;
- c. përparesitë e mundshme dhe rreziqet e realizimit të ekzaminimeve ose të intervenimeve të rekomanduara;
- d. datat e planifikuara për realizimin e ekzaminimeve dhe të intervenimeve;
- e. të drejtën e tij, për të vendosur lidhur me ekzaminimin ose intervenimin e rekomanduar;
- f. procedurat dhe metodat e mundshme alternative;
- g. rrjedhën e ofrimit të shërbimeve si dhe rezultatet e pritura;
- h. suksesin ose dështimin eventual të çfarëdo ekzaminimi ose intervenimi të përfunduar, përfshirë edhe rezultatet që dallojnë nga ato të pritura, si dhe shkaqet për këtë;
- i. mënyrat e rekomanduara për jetë të shëndoshë dhe
- j. çdo informatë tjetër, relevante për shëndetin e qytetarit ose për trajtimin e tij.

Qytetari ka të drejtë që të disponojë me emrat, kualifikimet dhe pozicionet e personave që janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për të. Qytetari, pa aftësi veprimi ose me aftësi të zvogëluar të veprimit ka të drejtë në informata që i përgjigjen moshës dhe gjendjes së tij mendore. Qytetari ka të drejtë, që të sigurojë informatën në mënyrën, e cila është e pranueshme për të, duke pasur parasysh moshën, nivelin arsimor, nivelin

<sup>194</sup> Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/47, 19 nëntor 2004, për shpalljen e Ligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr.2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror.

<sup>195</sup> Neni 4 .1. dhe 4.5. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/47, 19 nëntor 2004, për shpalljen e Ligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

## FAQE 75

e ditorisë, gjendjen psikike dhe pritjet e tij, lidhur me çështjen konkrete. Në rast se është e mundshme, me rastin e ofrimit të informatave, duhet të sigurohet përkthyesi ose përkthyesi që shërbehet me gjuhën e shenjave. Kushtet, që janë të domosdoshme për të realizuar të drejtat e lidhura me sigurimin e informatave, duhet të sigurohen nga institucioni shëndetësor që i disponon ato. Qytetari, i cili ka aftësi të plotë veprimi, mund ta refuzojë të drejtën për të qenë i informuar, përveç në rastet kur ai duhet që, patjetër, të jetë koshient për natyrën e sëmundjes, me qëllim që të mos e rrezikojë shëndetin e të tjerëve. Në rast se intervenimi kryhet me iniciativën e qytetarit dhe jo për qëllime terapeutike, mohimi i të drejtës, për të qenë i informuar, mund të jetë i vlefshëm vetëm atëherë kur bëhet në formë të shkruar. Qytetari, me aftësi të plotë veprimi, ka të drejtë që ta përcaktojë personin, i cili do të informohet, me shkrim ose në çfarëdo mënyre tjetër të besueshme, në vend të tij. Qytetari ka të drejtë që të informohet edhe në rastet kur pëlqimi i tij, nuk është kusht për fillimin e trajtimit.<sup>196</sup>

Qytetari, ka të drejtë që të vendosë se a do t'i nënshtrohet ose jo trajtimit të caktuar. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm në mënyrën e përcaktuar me ligj. Brenda kornizës së realizimit të së drejtës të vendimit personal, qytetari është i lirë që të vendosë se a dëshiron që të shfrytëzojë shërbimet shëndetësore apo jo, si dhe me cilat intervenime të pajtohet dhe cilat intervenime t'i refuzojë, duke pasur parasysh kufizimet e përcaktuara me ligj.<sup>197</sup>

### 12.2 Përputhja e nenit 12 me fakte

Sipas raportit "Gjendja Perinatale në Kosovë për 2000 - 2006", në vitin 2000 janë raportuar 9 vdekje maternale në 38.907 lindje me fëmijë të gjallë (23.1/100000), përdërisa në vitin 2006 janë raportuar 2 vdekje maternale në 28.450 lindje me fëmijë të gjallë (7.0/100000). Këto shifra janë të përafërta me vendet e zhvilluara. Megjithatë, nuk duhet harruar faktin se "vdekjet maternale janë të raportuara vetëm nga institucionet shëndetësore"<sup>198</sup>.

"Nuk ka ndonjë sistem të besueshëm për të ditur shkaqet e vdekjeve maternale në Kosovë. Megjithatë, disa nga shkaqet e mortalitetit të lartë amnor janë kushtet e rënda ekonomike e politike, në periudhën para dhe gjatë konfliktit, si dhe zhvillimi i dobët institucional, veçanërisht kualiteti i dobët i shërbimeve të kujdesit publik në periudhën e pasluftës."<sup>199</sup> Kësisoj, Kosova prinë me vdekshmërinë perinatale të foshnjave me 23 fëmijë në 1 mijë lindje, që

196 Neni 9. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/47, 19 nëntor 2004, për shpalljen e Ligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

197 Neni 10. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/47, 19 nëntor 2004, për shpalljen e Ligjit mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

198 Gjendja Perinatale në Kosovë, për 2000-2006, prill 2007 Prishtinë, faqe 19

199 Raporti bazë i Objektivave Zhvillimore të Mileniumit për Kosovën, MDG, Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, mars 2004

vlerësohet si shkalla më e lartë në Evropë.<sup>200</sup>

Raporti "Gjendja Perinatale në Kosovë për 2000 - 2006" vë në dukje disa nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë perinatale si: anomalitë kongjenitale, infeksionet perinatale, traumat në lindje, çrregullimet e shkaktuara si pasojë e komplikimeve gjatë shtatzënisë, gjendja ekonomike dhe sociale, gjinia, statusi familjar, moshë dhe peshë e nënës, numri i madh i lindjeve si dhe cilësia e kujdesit shëndetësor.

Sipas gjinekologes, Teuta Hadri "shkaqet kryesore të vdekshmërisë së foshnjave janë ato ekonomike, sociale, si dhe mentaliteti"<sup>201</sup>. Sipas saj, mortaliteti i foshnjave është më i madh në zonat rurale sesa në ato urbane dhe vjen si rezultat i nivelit më të ulët të informimit dhe planifikimit familjar te gratë e zonave rurale.

Statistikat tregojnë se numri i vdekshmërisë së foshnjave ka ndryshuar nga viti në vit, duke pësuar rënie dhe ngritje të lehta brenda viteve. Kështu, në vitin 2002, numri i përgjithshëm i foshnjave të vdekura ishte 403, prej tyre 205 vajza dhe 198 djem. Nëse e krahasojmë me vitin 2003, ky numër është rritur në 464 gjithsej, prej tyre 265 vajza dhe 199 djem, duke shënuar kështu një rënie të lehtë të vdekshmërisë së foshnjave në vitin 2004, ku kishte gjithsej 415 vdekje, prej të cilave 233 vajza dhe 182 djem. Ndërsa, viti 2005 shënon prapë rënie të numrit të përgjithshëm të vdekjeve në gjithsej 357, prej të cilave 155 vajza dhe 202 djem.

Nga numri i përgjithshëm i vdekjeve të foshnjave, gjatë këtyre katër viteve, po të bëjmë krahasime në aspektin gjinor, vërehet se foshnjat e gjinisë femërore prijnë me numër më të lartë të vdekjeve.

Visare Mujko - Nimani, nga UNFPA, mendon se duhet t'i kushtohet përkujdesje më e madhe shëndetit amnor dhe atij të foshnjave duke pasur parasysh se shkalla e vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave në Kosovë është shumë e lartë.<sup>202</sup>

Kur flasim për resurset njerëzore, të dhënat nga raporti i lartpërmendur, tregojnë se numri i obstetërve dhe pediatërve i tejkalon kërkesat, mirëpo shpërndarja e tyre është joadekuatë, gjë që ndikon në kapacitetin dhe funksionimin e disa materniteteve si dhe në cilësinë e shërbimeve shëndetësore. P.sh. ka raste kur në disa maternitete nuk punojnë gjinekologët-obstetrit ose numri i tyre është i kufizuar.

Identifikimi i shkaqeve që shpijnë deri te ky numër i lartë i vdekshmërisë së foshnjave, shpërndarja adekuatë e kapaciteteve mjekësore, përmirësimi i kushteve të punës dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve do të luanin rol të rëndësishëm në trajtimin e kësaj problematike, si dhe në reduktimin e numrit të vdekshmërisë së foshnjave.

200 Koha Ditore, e premte 21 shtator 2007. "Kosova prin me vdekshmëri të foshnjave në Evropë". Autori: Faton Ismajli

201 Intervistë me Teuta Hadrin, gjinekologe. 04.09.2007. Prishtinë

202 Gazeta Express, e diel, 19 gusht 2007. "Shtatzënat e rrezikuara". Autori: Artan Behrami

## FAQE 77

Gjendja aktuale e vdekshmërisë së nënave dhe foshnjave, mbetet çështje mjaft shqetësuese dhe kërkon intensifikim të veprimeve institucionale, të cilat do të ndikojnë në reduktimin e nivelit të vdekshmëri së nënave dhe foshnjave

Projekti “Edukimi shëndetësor i vajzave dhe grave të komunitetit RAE”, i zbatuar nga grupi i grave RAE “Foleja”, në bashkëpunim me dy OJQ të tjera dhe Institucionet Shëndetësore, ka vënë në pah se gratë e reja të komunitetit RAE, përballen me probleme shëndetësore qysh në moshë të re dhe jetojnë me sëmundje kronike gjatë tërë jetës së tyre<sup>203</sup>. Më tej, raporti thekson se: “Kjo është pasojë e nivelit të ulët të arsimit, të pozitës së vështirë materiale, mosinformimit të duhur nga mediat e ndryshme lokale përkritazi me gjendjen e tyre aktuale.”<sup>204</sup>

Sipas UNAIDS, Kosova është rajon me nivel të ulët të epidemive, por janë të pranishme të gjithë parakushtet për një shpërndarje të shpejtë të HIV/AIDS-it. “Një rritje, madje e nivelit alarmues, mund të shfaqet për arsye të faktorëve të ndryshëm, si: numri i madh i të rinjve, shkalla e madhe e papunësisë së bashku me rritjen e konsumimit të drogës, rritja e tregut të seksit, lëvizshmëria e lartë e kosovarëve dhe e komunitetit ndërkombëtarë”<sup>205</sup>.

Në vitin 2005 kishte gjithsej 41 persona të infektuar, prej të cilëve 25 burra dhe 16 gra. “Statistikat tregojnë se gjinia mashkullore është më e prekur nga ky virus, ndërsa grupmosha më e rrezikuar është 20 - 49, më saktësisht 30 - 39”<sup>206</sup>.

## XIII. NENI 13



### Neni 13

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, për t'i siguruar, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të drejtat e njëjta, e sidomos:

- a. Të drejtën për pensione familjare;
- b. Të drejtën për hua bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kreditë financiare;
- c. Të drejtën për të marrë pjesë në aktivitetet zbavitëse, sportive dhe në të gjitha aspektet e jetës
- d. kulturore.

203 Edukimi shëndetësor i vajzave dhe grave të komunitet rom, ashkali dhe egjiptian, “Foleja”, Prizren, shkurt 2007, faqe 8

204 Po aty

205 Shqyrtimi i sektorit të Sigurisë së Brendshme të Kosovës”. Pikat e Brishta, faqe 64. Prishtinë, mars 2006

206 Intervistë me udhëheqës të OJQ-së KAPHA, .

### 13.1 Përputhja e nenit 13 me ligje

Neni 4, i Ligjit për Familjen i Kosovës përcakton: Të gjithë personat gëzojnë trajtim të barabartë të të drejtave dhe detyrimeve të parapara me këtë Ligj. Nuk do të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj asnjë personi apo personave në bazë të gjinisë, moshës, gjendje martesore, gjuhës, paaftësisë mendore apo fizike, orientimit seksual, përkatësisë apo bindjeve politike, prejardhjes etnike, kombësisë, religjionit apo besimit, racës, prejardhjes shoqërore, pasurisë, lindjes apo gjendjes tjetër.<sup>207</sup>

Duke marrë parasysh që Ligji për Familjen i Kosovës rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësim), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare, mund të themi që ligjet e Kosovës u sigurojnë grave të drejta të barabarta për të përfituar privilegjet familjare pavarësisht nga gjendja civile.

Sipas Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), për lidhjen e kontratës juridikisht të vlefshme nevojitet që kontraktuesi të ketë aftësi veprimi, e cila kërkohet për lidhjen e një kontrate të tillë (neni 56). Aftësinë kontraktuese personi e fiton me arrihtjen e moshës madhore. Se kur arrihet mosha madhore është caktuar me dispozitat e së drejtës familjare.<sup>208</sup>

Ligji Kundër Diskriminimit zbatohet ndaj të gjitha veprimeve dhe mosveprimeve të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, përfshirë këtu edhe organet publike, të cilat cenojnë të drejtat e personit/ve fizik dhe juridik, në çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi,<sup>209</sup> pra edhe në rastet e diskriminimit në lidhje me kontratat mbi baza gjinore ose gjendjet civile.

LBGJ në nenin 11 përcakton: Në legjislacionin ekonomik, financiar, të punësimit dhe mirëqenies sociale si dhe në programet makro dhe mikro - ekonomike, financiare, privatizim, përfshirë edhe të drejtën për trashëgimi dhe pronësi, kredi dhe burime natyrore duhet të mundësohet qasje e plotë dhe e barabartë për femra dhe meshkuj.<sup>210</sup> Organet përgjegjëse dhe personat juridik me autorizime publike si dhe institucionet financiare në kushte të barabarta u sigurojnë femrave dhe meshkujve qasje në mjete dhe shpërndarje të mjeteve të ndara për nxitjen e krijimit të biznesit dhe vetëpunësimit.<sup>211</sup>

207 Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: Viti I / nr. 4 / 1 shtator 2006

208 Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve "Gazeta zyrtare e RSFJ", nr. 29/78 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra g.z. nr. 39/85, 45/89, 57/89 dhe 31/93.

209 Neni 4, LKD.

210 Neni 11.1.-LBGJ.

211 Neni 11.2-LBGJ.

Ligji mbi hipotekat përcakton mjetet për krijimin e hipotekave, efektet e tyre ndërmjet palëve në një kontratë të tillë, efektet e tyre ndaj personave të tretë, dhe mjetet me anë të të cilave, hipotekat e shoqërive tregtare mund të ekzekutohen nëpërmjet procedurave jashtë-gjyqësore në rast të mospërbushjes sipas kushteve të dokumentit të hipotekës.<sup>212</sup>

Ligji i sportit rregullon organizimin, kushtet dhe mënyrat e zhvillimit të veprimtarive sportive, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e bartësve të tyre, si dhe çështjet e tjera me rëndësi për këto veprimtari veçanërisht themelimi, regjistrimi dhe menaxhimi i organizatave sportive.<sup>213</sup>

Çdo qytetar i Kosovës gëzon të drejtën e marrjes me veprimtari sportive, është përcaktuar në Ligjin e sportit.<sup>214</sup>

Në Nenin 2 të Ligjit të sportit është përcaktuar: Të gjithë personat, pa dallim moshe, gjinie, kombësie, përkatësie politike, racore, fetare, pavarësisht nga mundësitë fizike e mentale, pavarësisht nga niveli shoqëror ose ekonomik i tyre, e gëzojnë të drejtën e marrjes me veprimtari sportive.<sup>215</sup>

Ligji për institucionet e kulturës është Ligj bazik sistemor dhe i rëndësishëm së veçantë për kulturën. Me këtë Ligj rregullohen kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit të institucioneve të kulturës, karakteri, struktura organizative dhe menaxheriale e tyre, punët dhe veprimtaria, obligimet dhe përgjegjësitë, çështjet statusore, si dhe çështjet tjera për veprimtarinë dhe funksionimin e institucioneve të kulturës.<sup>216</sup>

Në nenin 2.2. të Ligjit për institucionet e kulturës është përcaktuar: Institucioni themelohet për ushtrim të veprimtarisë kulturore, shkencore dhe artistike.

Institucionin mund ta themelojë:

- a. Personi fizik;
- b. Personi juridik apo
- c. Personi fizik dhe juridik.<sup>217</sup>

---

212 Rregullore UNMIK-ut nr. 2002/2120 dhjetor 2002 për shpalljen e Ligjit mbi hipotekat të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

(Neni 3) Objekti i hipotekës mund të jetë prona e patundshme ose një e drejtë e saj me anë të së cilës pronari mund ta posedojë brenda suazave të përcaktuara me ligj.

213 Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/26 (28 korrik 2004) mbi shpalljen e Ligjit për sportin të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

214 Neni 9.1. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/26 (28 korrik 2004) mbi shpalljen e Ligjit për sportin të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

215 Neni 2.1. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/26 (28 korrik 2004) mbi shpalljen e Ligjit për sportin të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

216 Neni 2 (Qëllimi i ligjit) Rregullore e UNMIK –ut nr. 2006/44 (18 gusht 2006) Mbi shpalljen e Ligjit për institucionet e kulturës të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-57 për institucionet e kulturës.

217 Neni 2.2 Rregullore e UNMIK –ut nr. 2006/44 (18 gusht 2006) Mbi shpalljen e Ligjit për

## 13.2 Përputhja e nenit 13 me fakte

Sipas të dhënave të Entit të Statistikave të Kosovës nga viti 2002 dhe Planit veprues për barazi gjinore të vitit 2003, afro 6.5 për qind e bizneseve kosovare janë në pronësi të grave, ndërsa sipas hulumtimit me 500 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, të realizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në vitin 2004, 98 për qind e pronarëve të bizneseve janë burra, kurse vetëm 2 për qind janë gra.

Midis shkaqeve më të rëndësishme për një përqindje kaq të ulët të pronësisë së bizneseve nga gratë kosovare është mentaliteti dominues patriarkal dhe stereotipet për gratë në Kosovë, që reflektojnë në mungesë të krijimit të kushteve të përshtatshme për zhvillimin ekonomik të grave dhe pavarësimin e tyre. Një arsye tjetër me rëndësi është mungesa e mundësisë për qasje të drejtpërdrejtë në përkrahjen financiare apo shfrytëzimin e huave bankare, për shkak se pasuria familjare është kryesisht e regjistruar në emër të anëtarëve mashkullorë të familjes. Për atë arsye numri i grave të cilat kanë përdorur huat bankare është shumë simbolik. Në bazë të shënimeve të institucioneve financiare ky numër është vetëm 3 për qind.<sup>218</sup>

## XIV. NENI 14

### Neni 14

1. Shtetet palë marrin parasysh problemet e veçanta që u shtrohen grave fshatare dhe rolin e rëndësishëm që luajnë këto gra për mbijetesën ekonomike të familjeve të tyre, duke përfshirë punën e tyre në sektorët jomonetarë të ekonomisë. Ato marrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente në dobi të grave të zonave bujqësore.
2. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në zonat bujqësore me qëllim që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, pjesëmarrjen e saj në zhvillimin e fshatit dhe njëherësh në avantazhet që sjell ajo. Në mënyrë të veçantë ato i sigurojnë gruas:
  - a. Të drejtën për të marrë pjesë plotësisht në përpilimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit në të gjitha nivelet;
  - b. Të drejtën për të përfitur shërbime të përshtatshme në fushën e shëndetit, duke përfshirë informacionet, këshillat dhe shërbimet në fushën e

institucionet e kulturës të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-57 për institucionet e kulturës.

218 Raporti nga MEB Banka, 2001, 3 për qind e huamarrësve ishin gra.



- c. planifikimit të familjes;
  - c. Të drejtën për të përfituar drejtpërsëdrejti nga programet e sigurimeve sociale;
  - d. Të drejtën për të marrë të gjitha tipet e formimit dhe edukimit, formal dhe joformal, duke përfshirë atë që ka të bëjë me alfabetizimin funksional, si dhe, ndër të tjera, atë për të përfituar nga të gjitha shërbimet komunitare dhe vulgarizuese, sidomos për të shtuar aftësitë e saj teknike;
  - e. Të drejtën për të organizuar grupe të ndihmës së ndërsjellë dhe kooperativa në mënyrë që të realizohet barazia në veprimtaritë ekonomike, nëpërmjet zënies punë apo të ushtrimit të veprimtarisë së pavarur;
  - f. Të drejtën për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e bashkësisë;
  - g. Të drejtën për të përfituar kredi dhe ndihma bujqësore, lehtësi tregtimi, teknologji të përshatshme dhe trajtim të barabartë në fushën e reformave tokësore e agrare, si dhe në projektet e sistemit bujqësor;
  - h. Të drejtën për të pasur kushte jetese të përshatshme, sidomos lidhur me strehimin, shërbimin sanitar, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, transportin dhe komunikacionet.
- 

#### **14.1 Përputhja e nenit 14 me ligje**

---

Qëllimi i LKD-së është parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritja e shkallës së barazisë efektive dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para Ligjit.

Në pajtim me LKD-në, rregullimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mosdiskriminimin mbështetet edhe në Parimin e trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të përkatësisë sociale ose statuseve tjera, çka do të thotë se ndalohet edhe diskriminimi i grave rurale.<sup>219</sup>

Edhe pse, duhet cekur se Korniza Kushtetuese përcakton që "Të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut,"<sup>220</sup> çka do të thotë nuk ka ndarje ligjore të grave urbane dhe rurale.

Në Kosovë nuk ka ndarje ligjore të banorëve urban apo rural në këtë drejtim edhe të grave urbane dhe rurale. Çka do të thotë rregullimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mosdiskriminimin dhe me zbatimin e barabartë të të gjitha dispozitave të CEDAW, vlejnë për të gjithë banoret e Kosovës.

Rregullorja nr. 2005/15, e datës 16 mars 2005, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, në nenin 1.7 përcakton: "Gjatë kryerjes së përgjegjësisë dhe funksioneve të tyre, ministrat kujdesen që ministritë e tyre përkatëse: Të sigurojnë shërbime të besueshme, transparente dhe të

---

219 Shih Neni 2, LKD.

220 Neni 3.2, Korniza Kushtetuese.

përgjegjshme pa diskriminim mbi baza etnike apo të prejardhjes sociale, gjinore, paaftësisë fizike, religjionit, mendimit politik a ndonjë mendimi tjetër”.<sup>221</sup>

Në këtë drejtim ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural, duhet të kujdeset që në fushëveprimin e MBPZHR, i cili është përcaktuar në Shtojcën X të e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2005/15), d.m.th në sferën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural, të sigurojnë shërbime të besueshme, transparente dhe të përgjegjshme pa diskriminim mbi baza etnike apo të prejardhjes sociale, gjinore, paaftësisë fizike, religjionit, mendimit politik a ndonjë mendimi tjetër.

Në Shtojcën X të Rregullores së UNMIK-ut- Nr. 2005/15, 16 mars 2005, Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë është përcaktuar fushëveprimi i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural (MBPZHR), i cili ndër të tjera përfshin: Krijon politikën dhe zbaton ligjet për zhvillimin e bujqësisë, duke përfshirë edhe bagëtinë dhe prodhimin e bimëve, zhvillimin rural dhe vendosjen e standardeve të cilave duhet përmbajtur dhe Lehtëson zhvillimin e skemës kreditore për mbështetje të bujqësisë, pylltarisë dhe aktiviteteve për zhvillimin rural në sektorin privat.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural (MBPZHR), në bazë të legjislacioni në fuqi Lehtëson zhvillimin e skemës kreditore për mbështetje të bujqësisë, pylltarisë dhe aktiviteteve për zhvillimin rural në sektorin privat.<sup>222</sup>

## 14.2 Përputhja e nenit 14 me fakte

Sa i përket dallimit në punësim ndërmjet viseve rurale dhe urbane nuk ka të dhëna të ndara në baza gjinore për papunësinë e grave. Mirëpo, sipas informacioneve jozyrtare,<sup>223</sup> gratë në fshatra janë më tepër të angazhuara në tregun joformal. Punët në bujqësi, kopsht, shitja e produkteve në treg, pylltari, etj., janë disa nga aktivitetet e tyre të zakonshme. Në raste të rralla udhëheqin ndonjë agrobiznes.

Në viset rurale, mundësitë e vetme për punësim në sektorin publik zakonisht janë në arsim dhe shëndetësi.

221 Rregullorja e UNMIK –ut nr. 2005/15 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1.7 (c).

222 Shih-Shtojca X Rregullore e UNMIK-ut- Nr. 2005/15, 16 mars 2005, Për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë.

223 Puna në terren me OJQ-të lokale

## XV. NENI 15

### Neni 15

1. Shtetet palë i njohin gruas barazinë me burrin përpara ligjit
2. Shtetet palë i njohin gruas, në fushën civile, zotësi juridike të njëjtë me atë të burrit dhe mundësi të njëjta për ta ushtruar këtë zotësi. Ato i njohin asaj në mënyrë të veçantë të drejta të barabarta për të lidhur kontrata dhe për të administruar pasuri e i trajtojnë njësoj në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore.
3. Shtetet palë janë të mendimit se çdo kontratë ose çdo dokument tjetër privat, i çfarëdo lloji qoftë, që ka për efekt juridik të synojë kufizimin e zotësisë juridike të gruas, duhet të konsiderohet i paqenë.
4. Shtetet palë u njohin burrit edhe gruas të drejta të njëjta lidhur me legjislacionin që trajton të drejtën e personave për të lëvizur lirisht, si dhe për të zgjedhur vendbanimin dhe banesën e tyre.

### 15. Përputhja e nenit 15 me ligje

Marrëdhënia e detyrimeve është marrëdhënie juridike mes dy a më shumë subjekteve me cilësi të kreditorit dhe debitorit, me kërkesa dhe detyrime të ndërsjella, të cilët Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD) i cilëson si pjesëmarrës në marrëdhëniet e detyrimeve. Çdo marrëdhënie e detyrimeve supozon ekzistimin e dy anëve - palëve, prandaj do të ishte më e drejtë të flitet për palët e marrëdhënieve të detyrimeve, në cilësinë e të cilave paraqiten subjektet si pjesëmarrës, të cilët, sipas LMD, mund të jenë persona fizikë dhe persona juridikë (neni 2). Pjesëmarrës në marrëdhëniet e detyrimeve, sipas kësaj dispozite, janë personat juridikë shoqërorë, personat fizikë dhe personat juridikë civilë. Persona fizik mund të paraqiten gratë dhe burrat.<sup>224</sup>

Ligjet e Kosovës sigurojnë të drejta të barabarta në të gjitha fazat dhe procedurat e gjykatave dhe organe në të gjitha funksionet përkatëse.

Kandidatët për gjyqtarë duhet të jenë të ndershëm, kompetent dhe të njohin mirë të drejtën dhe zbatimin e saj. Kandidatët që i plotësojnë këto kushte duhet të kenë mundësi të barabarta për t'u zgjedhur gjyqtarë. Organi që bën përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë duhet ta bëjë këtë pa dallimi race, ngjyre, gjinie, gjuhe, besimi, prejardhjes kombëtare, opinioni politik, prejardhje shoqërore, pasurie, bindjeje a pozite.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, në pjesën 4 të saj (Sistemi juridik ), pika 9.4.7, thekson se gjykatësit e të gjitha gjykatave të Kosovës duhet të jenë juristë të dalluar, me karakterin më të lart moral dhe me kualifikime përkatëse. Anëtarësia e gjyqësorit, sipas kësaj dispozite të Kornizës

<sup>224</sup> Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve "Gazeta zyrtare e RSFJ", nr. 29/78 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra g.z. nr. 39/85, 45/89, 57/89 dhe 31/93.

Kushtetuese, duhet të reflektojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës.

Emërimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe ndihmësgjyqtarëve është i rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/8 (6 prill 2001) për themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës, i cili në Nenin 5 përcakton: Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë së Kosovës, përmes shpalljes publike, i fton kandidatët profesionistë Gjyqësor në Kosovë për të punuar si gjykatës ose prokurorë, si dhe kandidatët e kualifikuar në Kosovë për të punuar si ndihmësgjyqtarë. Këshilli mund të pranojë gjithashtu rekomandime nga autoritetet regjionale dhe komunale, ose autoritetet gjyqësore dhe organet e tjera të profesionit Gjyqësor, lidhur me personat e cilësuar si të përshtatshëm për t'u intervistuar si ndihmësgjykatës. Këshilli i shqyrton kërkesat e individëve të paraqitur dhe ia paraqet me shkrim rekomandimet e veta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për të shërbyer si gjyqtar, prokuror ose ndihmësgjyqtar udhëhiqen nga qëllimi për të krijuar një sistem gjyqësor dhe prokurori profesionale, të pavarur, të paanshme dhe shumetnike, dhe nuk ka pengesa gjinore. Këto kriterë janë të përcaktuar në Nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/8 (6 prill 2001) për themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës.<sup>225</sup>

Ndërsa Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26 (6 korrik 2003) mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (Neni 53) përcakton që : Sipas kushteve të parapara me këtë Kod, i dëmtuari në procedurë penale mund të paraqesë propozim për ndjekje penale, të veprorë si paditës privat apo si paditës subsidiar.

Me Ligjin për provimin e judikaturës përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat për dhënien e provimit të jurisprudencës me të cilin juristët e diplomuar fitojnë të drejtën për ushtrimin e punëve dhe detyrave profesionale në mënyrë të pavarur, kryerja e të cilave kushëtzohet me dhënien e provimit.

Kushtet e përgjithshme për dhënien e provimit të jurisprudencës, janë të përcaktuara në Nenin 2, të Ligjit për provimin e judikaturës: Personat të cilët mund t'i nënshtrohen provimit të jurisprudencës duhet të jenë të diplomuar në Fakultetin Juridik, sipas programit të vjetër katër vjeçar ose studimet master, pa

225 Nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/8 (6 prill 2001) për themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës. Neni 6.1-Kandidatët që do të shërbejnë si gjyqtarë dhe prokurorë duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme: ta kenë kryer fakultetin e drejtësisë; ta kenë dhënë provimin për kandidatët të organeve të gjyqësisë, në rastin e kandidatëve për postin e gjyqtarit në Gjykatën për Kundërvajtje, ta kenë dhënë provimin profesional; të kenë vlera të larta morale; ta mos kenë dosje penale; Neni 6.3-Kandidatët që duhet të shërbejnë si ndihmësgjyqtarë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme: duhet të jenë të paktën njëzetepesë (25) vjeç në datën e paraqitjes së kërkesës; të kenë vlera të larta morale; të mos kenë dosje penale dhe të kenë kualifikime profesionale dhe përvojë me të miturit, nëse ndihmësgjykatësit do të do angazhohen në gjykimin e veprimeve që kanë të bëjnë me të miturit.

## FAQE 85

dallim race, ngjyre, feje, gjinie, opiniononi politik, origjinë kombëtare, sociale, pasurie, lindjeje ose pozite.<sup>226</sup>

LBGJ në nenin 11.2. përcakton: Organet përgjegjëse dhe personat juridik me autorizime publike si dhe institucionet financiare në kushte të barabarta u sigurojnë femrave dhe meshkujve qasje në mjete dhe shpërndarje të mjeteve të ndara për nxitjen e krijimit të biznesit dhe vetëpunësimit.

Ligjet e Kosovës nuk i deklarojnë shprehimisht të pavlefshme të gjitha kontratat dhe instrumentet e tjera private të çdo lloji kur ato kanë efektin ligjor që synon kufizimin e zotësisë juridike te grave, por duke u nisur nga parimet e përgjithshme të LKD-së dhe përcaktimi në Nenin 18.2. të LBGJ-së i cili parashihet: Ndalohet diskriminimi gjinor me ligj në të gjitha fushat e jetës shoqërore në Kosovë<sup>227</sup>, mund të themi se janë të pavlefshme të gjitha kontratat dhe instrumentet e tjera private të çdo lloji kur ato kanë efektin ligjor që synon kufizimin e zotësisë juridike te grave.

Në bazë të Ligjit për Familjen: Bashkëshortët vendosin për vendin e banimit me marrëveshje dhe për udhëheqjen e ekonomisë së përbashkët familjare me marrëveshje. Po ashtu, secili bashkëshort është i pavarur në zgjedhjen e punës dhe profesionit.<sup>228</sup>

## XVI. NENI 16



### Neni 16

1. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare. Në mënyrë të veçantë ata i sigurojnë gruas mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas:
  - a. Të drejtën e njëjtë për të lidhur martesë;
  - b. Të drejtën e njëjtë për të zgjedhur lirisht bashkëshortin dhe për të lidhur martesë vetëm me pëlqimin e vet të lirë dhe të plotë;
  - c. Të drejtën dhe përgjegjësinë e njëjtë gjatë martesës dhe me rastin e prishjes së saj;
  - d. Të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta si prindër, pavarësisht nga gjendja martesore, për ato çështje që kanë të bëjnë me fëmijët. Në të gjitha rastet interesi i fëmijëve duhet të jetë në vend të parë;
  - e. Të drejtat e njëjta për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi për numrin dhe

<sup>226</sup> Rregullore UNMIK-ut nr. 2006/30 (2 maj 2006) Mbi shpalljen e Ligjit për provimin e judikaturës i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-40 për provimin e judikaturës.

<sup>227</sup> Neni 18.2. LBGJ

<sup>228</sup> Neni 44 (Vendbanimi, Ekonomia familjare, Profesionit), Ligji për Familjen.

- shkallëzimin e lindjeve e po ashtu për të marrë informacionin, arsimin dhe mjetet e nevojshme që bëjnë të mundur ushtrimin e këtyre të drejtave;
- f. Të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta për çështjet që kanë të bëjnë me tutelën, kujdestarinë, ruajtjen dhe birësimin e fëmijëve ose lidhur me institucionet e ngjashme, ku këto koncepte ekzistojnë në legjislacionin kombëtar. Në të gjitha rastet, interesi i fëmijëve duhet të jetë në vend të parë;
  - g. Të drejtat e njëjta vetjake si burrit ashtu edhe gruas, duke përfshirë edhe të drejtën për të zgjedhur mbiemrin, profesionin dhe llojin e punës;
  - h. Të drejtat e njëjta për secilin prej bashkëshortëve lidhur me pronësinë, blerjen, administrimin, gëzimin dhe disponimin e pasurisë, si falas ashtu edhe me pagesë.
2. Fejesat dhe martesat e fëmijëve të mitur nuk kanë efekt juridik, prandaj merren të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë legjislacionin, me qëllim që të caktohet një moshë minimale për martesë dhe të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i martesës në një regjistër zyrtar.
- 

## 16. Përputhja e nenit 16 me ligje

Ligji për Familjen i Kosovës rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësim), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare.<sup>229</sup>

Të gjithë personat gëzojnë trajtim të barabartë të të drejtave dhe detyrimeve të parapara me Ligjin për Familjen të Kosovës, i cili përcakton: Nuk do të ketë diskriminim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë ndaj asnjë personi apo personave në bazë të gjinisë, moshës, gjendje martesore, gjuhës, paaftësisë mendore apo fizike, orientimit seksual, përkatësisë apo bindjeve politike, prejardhjes etnike, kombësisë, religjionit apo besimit, racës, prejardhjes shoqërore, pasurisë, lindjes apo gjendjes tjetër.<sup>230</sup>

Një nga katër Parimet mbi të cilat bazohet rregullimi i marrëdhënieve familjare të parapara në Ligjin për Familjen të Kosovës, është edhe parimi lidhur me: Barazinë ndërmjet burrit dhe gruas, respektit dhe ndihmës së ndërsjellët ndërmjet tyre dhe anëtarëve të familjes;<sup>231</sup>

Sipas Ligjit për Familjen të Kosovës, mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimi të

229 Shih Neni 1- Ligji për Familjen i Kosovës (Ligji Nr. 2004/32)- Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë: VITI I / NR. 4 / 1 SHTATOR 2006, (Më 16 shkurt 2006, UNMIK/REG/2006/7)-Në vazhdim Ligji për Familjen i Kosovës

230 Neni 4 Ligji për Familjen i Kosovës.

231 Neni 3 (Pika 1) Ligji për Familjen i Kosovës.

martesës dhe zgjidhjes së saj.<sup>232</sup>

Ligji për Familjen i Kosovës në Nenin 14, përcakton: Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes.

Neni 15.2. i LBGJ-së parasheh: Martesa njihet me ligj me aktin e kurorëzimit dhe sjell të drejta dhe detyrime sipas ligjit nëse me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.

Ligji për Familjen i Kosovës në Nenin 14 (2) përcakton: Mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj.

Neni 68 i Ligjit për Familjen i Kosovës, përcakton: Martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës. Njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente

Parimet mbi rregullimin e marrëdhënieve Familjare, të përcaktuara në Nenin 3 të Ligjit për Familjen të Kosovës,, përcaktojnë:

1. Barazinë ndërmjet burrit dhe gruas, respektit dhe ndihmës së ndërsjellët ndërmjet tyre dhe anëtarëve të familjes;
2. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësia e të dy prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre, ku fëmijë nënkupton personin nën moshën 18 vjeçare;
3. Prindërit dhe fëmijët detyrohen në ndihmë dhe konsideratë të ndërsjellët gjatë tërë jetës së tyre;
4. Fëmijët e prindërve të cilët nuk kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre gëzojnë të drejtat e njëjta dhe kanë detyrime të njëjta sikurse fëmijët e lindur nga prindërit të cilët kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre.

Ligji për Familjen i Kosovës në Nenin 39 përcakton: (2) Bashkësia faktike (Bashkësia jashtëmartesore)<sup>233</sup> është e barabartë me statusin martesor nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje, mbështetje financiare reciproke, dhe të drejtat pasurore ashtu siç është specifikuar në këtë ligj. mbështesin financiarisht njeri tjetrin, posaçërisht në rastet kur njëri prej tyre nuk ka bazë të mjaftueshme materiale për jetesë. Bashkëshortët do të zhvillojnë dhe shprehin ndjenjën e solidaritetit reciprok, si dhe solidaritetin ndaj fëmijëve të tyre të lindur në martesë apo të adoptuar.

---

232 Neni 14 (Pika 2) Ligji për Familjen i Kosovës.

233 Neni 39 (1) Ligji për Familjen i Kosovës. -Bashkësia faktike (Bashkësia jashtëmartesore) konsiderohet marrëdhënia faktike midis burrit dhe gruas që jetojnë në çifte, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësia e të dy prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre (ku fëmijë nënkupton personin nën moshën 18 vjeçare), dhe detyrimi i Prindërve dhe fëmijëve në ndihmë dhe konsideratë të ndërsjellët gjatë tërë jetës së tyre, Janë dy nga katër Parimet mbi të cilat bazohet rregullimi i marrëdhënieve familjare të parapara në Ligjin për Familjen të Kosovës.<sup>234</sup>

Neni 125, i Ligjit për Familjen të Kosovës përcakton parimet për mbrojtjen e fëmijëve:

1. Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar.
2. Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë t'i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë;
3. Fëmijët me të meta të diagnostifikuara mendore ose fizike kanë të drejtë për kujdes të posaçëm, për një jetë të përshtatshme, në kushte të jetës që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën shoqërore.
4. Fëmijët kanë të drejtën e shkollimit fillorë falas, të marrjes së informimit për profesione të ndryshme si dhe për shkollat që ekzistojnë.
5. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi ekonomik, eksploatimit të fëmijëve, trafikimit dhe eksploatimit seksual dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cenon edukimin ose dëmton shëndetin e tyre.
6. Fëmijët duhet të mbrohen nga keqtrajtimi dhe dhunimi seksual. Fëmijëve të tyre të mitur.
7. Përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë.
8. Duke i zbatuar këto parime, prindërit duhet t'i kenë në konsiderim aftësitë, prirjet dhe dëshirat e fëmijëve të tyre.
9. Fëmijët duhet të mbrohen nga keqtrajtimi dhe dhunimi seksual.
10. Fëmijët duhet mbrojtur nga përdorimi i paligjshëm i drogave dhe substancave psikotrope dhe nuk duhet lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve për të jetuar.

Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë t'i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë; Prindërit janë të detyruar të sigurojnë në çdo kohë që parimet e përcaktuara në nenin 125 të këtij Ligji përdoren për mbrojtjen e fëmijëve të tyre të mitur.<sup>235</sup>

Neni 4 i Ligjit për Familjen përcakton: Bashkëshortët në martesë janë të

234 Neni 3 (Pika 3 dhe 4) Ligji për Familjen i Kosovës.

235 Neni 128-Ligji për Familjen i Kosovës



barabartë, në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore. Që të dy bashkëshortët kontribuojnë në mirëmbajtjen e familjes në proporcion me aftësitë e tyre individuale.

Ligji mbi Shëndetin Riprodhues përcakton (4.1): “Çdo individ, pavarësisht nga përkatësia gjinore, ideologjike, religjioze apo kulturore, i garantohet e drejta në informim dhe edukim lidhur me shëndetin seksual e riprodhues, gjatë gjithë ciklit jetësor të saj/tij.”<sup>236</sup>

Neni 5 i Ligjit mbi Shëndetin Riprodhues përcakton: “Çdo individ ka të drejtë në jetë të shëndoshë seksuale dhe riprodhuese që zgjedh me vullnetin e saj/tij. Asnjë femër nuk mund të detyrohet të mbetet shtatzënë.

Ligji për Familjen i Kosovës rregullon fejesën, martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin (birësim), kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës përkitazi me kontestet lidhur me marrëdhëniet familjare.<sup>237</sup>

Të gjithë personat gëzojnë trajtim të barabartë të të drejtave dhe detyrimeve të parapara me Ligjin për Familjen.

Ligji për Familjen i Kosovës në Nenin 42, përcakton: Bashkëshortët në martesë janë të barabartë, në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore. Martesa lidhet për tërë kohëzgjatjen e jetës. Bashkëshortët janë të detyruar të jenë besnik ndaj njëri tjetrit dhe në mënyrë reciproke ta ndihmojnë, respektojnë dhe mbështesin financiarisht njeri tjetrin, posaçërisht në rastet kur njëri prej tyre nuk ka bazë të mjaftueshme materiale për jetesë. Bashkëshortët do të zhvillojnë dhe shprehin ndjenjën e solidaritetit reciprok, si dhe solidaritetin ndaj fëmijëve të tyre të lindur në martesë apo të adoptuar.<sup>238</sup>

Ligji për Familjen, në Nenin 43, përcakton:

- (1) Bashkëshortët duhet të caktojnë mbiemrin e tyre të përbashkët.
- (2) Me rastin e lidhjes së martesës, bashkëshortët me marrëveshje mund të vendosin:
  1. që secili ta mbajë mbiemrin e vet;
  2. që i përbashkët të jetë mbiemri i njërit prej bashkëshortëve;
  3. që t’ia bashkëngjisin mbiemrin e vet mbiemrit të njërit prej bashkëshortëve.
- (3) Kombinimi i mbiemrit nuk do të jetë i mundur, nëse mbiemrat e bashkëshortëve

<sup>236</sup> Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2007/11, 7 shkurt 2007, për shpalljen e Ligjit mbi shëndetin riprodhues të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 02/L-76 Mbi Shëndetin Riprodhues. (Ligji Mbi Shëndetin Riprodhues)

<sup>237</sup> Neni 1. Fushëveprimi i rregullativës, Ligji për Familjen i Kosovës.

<sup>238</sup> Neni 42. Bashkëjetesa martesore Ligji për Familjen i Kosovës.

tanimë përbëhen nga mbiemri i dyfishtë. Në rast të tillë vetëm njëri nga mbiemrat mund të kombinohet me emrin e bashkëshortit tjetër dhe të bëhet mbiemër martesor.

(4) Në rast se bashkëshortët nuk vendosin lidhur me mbiemrin martesor, secili prej tyre mban mbiemrin e vet.<sup>239</sup>

Bashkëshorti i cili në rastin e martesës e ka ndryshuar mbiemrin, pas zgjidhjes së martesës mund të marrë mbiemrin e mëparshëm. Deklarata për marrjen e mbiemrit të mëparshëm duhet të jepet brenda afatit prej gjashtë muajve pas zgjidhjes së martesës. Deklarata i paraqitet ofiqarit i cili mban regjistrin amë të të martuarve për vendin në të cilin është lidhur martesa sipas vendbanimit të deklaratë dhënësit.<sup>240</sup>

Po ashtu, në bazë të Ligjit për Familjen: Secili bashkëshort është i pavarur në zgjedhjen e punës dhe profesionit.<sup>241</sup>

Në bazë të Ligjit për Familjen të Kosovës, asnjëri nga bashkëshortët nuk mund që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e tij.<sup>242</sup>

Pasuria e bashkëshortëve mund të jetë pasuri e veçantë ose e përbashkët.<sup>243</sup>

Bashkëshortët janë përgjegjës për detyrimet e tyre personale që rezultojnë nga pasuria e pjesëtuar dhe detyrimet e tyre që rezultojnë nga pjesa e tyre në pasurinë e përbashkët. Të dy bashkëshortët janë të ngarkuar me detyrimet e përbashkëta dhe individuale përmes pasurisë së tyre të përbashkët dhe të pjesëtuar, për detyrimet që njëri nga bashkëshortët duhet të përmbushë kundrejt personave të tretë si dhe detyrimet që duhet të përmbushen nga të dy bashkëshortët. Bashkëshorti, i cili përmes pasurisë së tij të veçantë e ka përmbushur detyrimin solidar, ka të drejtë të kërkojë që bashkëshorti tjetër t'ia shpërblejë pjesën e detyrimit që e ka përmbushur.<sup>244</sup>

Neni 46 i Ligjit për Familjen të Kosovës përcakton: Pasuria e cila i ka takuar bashkëshortit në çastin e lidhjes së martesës do të mbetet pasuri e veçantë e tij. Pasuria e veçantë është gjithashtu edhe pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës përmes trashëgimit, dhurimit apo ndonjë forme tjetër ligjore të fitimit të pasurisë. Pasuria që i takon bashkëshortit duke u bazuar në proporcionin e pasurisë së përbashkët është gjithashtu pasuri e veçantë. Një prodhim arti, punë intelektuale apo pronë intelektuale konsiderohet pasuri e ndarë e bashkëshortit/ës që e ka krijuar. Secili bashkëshort në mënyrë të pavarur e administron dhe e

239 Neni 43 (Mbiemri martesor), Ligji për Familjen.

240 Neni 96. Mbiemri), Ligji për Familjen.

241 Neni 44 –pika 5 (Vendbanimi, Ekonomia familjare, Profesionit), Ligji për Familjen.

242 Neni 52. Ligji për Familjen.

243 Shih Neni 45 (Parimet themelore) institucioni ligjor "Pronësia e përbashkët e pronës së fituar më vonë", Ligji për Familjen.

244 Neni 57. Ligji për Familjen.

## FAQE 91

posedon pasurinë e vet të veçantë gjatë gjithë kohës së martesës.<sup>245</sup>

Ndërsa Neni 47 i Ligjit për Familjen të Kosovës përcakton: Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë. Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve. Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët. Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh.<sup>246</sup>

Pasurinë e përbashkët bashkëshortore gjatë martesës bashkëshortët e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht dhe me marrëveshje.<sup>247</sup>

Sipas, Ligjit për Familjen, të drejtat e bashkëshortëve për sendet e paluajtshme, të cilat janë pasuri e tyre e përbashkët, regjistrohen në Regjistrin publik të pasurive të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesë të papërcaktuara. Kur vetëm njëri prej bashkëshortëve regjistrohet si bartës i së drejtës pronësore për pasurinë e përbashkët në regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve. Pasuria nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve, ashtu siç është përcaktuar me ligjin në fuqi. Në rastet kur që të dy bashkëshortët janë të regjistruar në Regjistrin publik të paluajtshmërive si pronarë të përbashkët në pjesë të caktuara, konsiderohet se ata në këtë mënyrë e kanë bërë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët.<sup>248</sup>

Sipas Nenit 51. të Ligjit për Familjen, bashkëshortët mund të kontraktojnë që administrimi dhe disponimi i pasurisë së përbashkët, në tërësi ose pjesë të saj, të bëhet nga njëri prej bashkëshortëve. Po ashtu, kontrata mund të kufizohet edhe vetëm në administrim ose vetëm disponim. Kur nuk është kontraktuar ndryshe, administrimi përfshin edhe posedimin në kuadër të aktiviteteve të rregullta. Kontrata po ashtu mund t'i referohet të gjitha akteve të veçanta të administrimit të rregullt ose akteve të veçanta të përcaktuara.<sup>249</sup>

Po ashtu edhe, pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve është rregulluar me Ligjin për Familjen, i cili përcakton: Bashkëshortët, në çdo kohë, mund të pjesëtojnë pasurinë e tyre të përbashkët me marrëveshje. Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet kur bashkëshortët caktojnë ose kërkojnë t'u caktohen pjesët e tyre në pasurinë e përbashkët dhe kështu bëhen pronarë në pjesë të caktuara. Marrëveshja duhet të bëhet medoemos me shkrim në pajtim me kërkesat formale, të përcaktuara me ligjin në fuqi mbi pasurinë për

245 Neni 46 (Pasuria e veçantë e bashkëshortëve) Ligji për Familjen.

246 Neni 47 (Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve) Ligji për Familjen. Ligjet në fuqi me të cilët rregullohen të drejtat dhe detyrimet në pasuri të patundshme do të zbatohen për pasurinë e përbashkët, përveç rasteve kur me Ligjin për familjen parashihet ndryshe.

247 Neni 49 (Administrimi i pasurisë së përbashkët), Ligji për Familjen.

248 Shih Neni 50 (Pasuria e paluajtshme), Ligji për Familjen.

249 Neni 51 (Marrëveshjet kontraktuese për posedim dhe administrim), Ligji për Familjen.

arritjen e marrëveshjeve të tilla.<sup>250</sup>

Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve.<sup>251</sup>

Bashkëshorti tjetër nuk është përgjegjës për detyrimet që njëri nga bashkëshortët i ka pasur para lidhjes së martesës, si dhe për detyrimet personale që i pranon gjatë martesës.<sup>252</sup>

Po ashtu Neni 11.1. i LBGJ-së përcakton: Në legjislacionin ekonomik, financiar, të punësimit dhe mirëqenies sociale si dhe në programet makro dhe mikro - ekonomike, financiare, privatizim, përfshirë edhe të drejtën për trashëgimi dhe pronësi, kredi dhe burime natyrore duhet të mundësohet qasje e plotë dhe e barabartë për femra dhe meshkuj.

LBGJ në Nenin 15, përcakton: Moshë madhore për të dy gjinitë në Kosovë është 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç. Martesa njihet me ligj me aktin e kurorëzimit dhe sjell të drejta dhe detyrime sipas ligjit nëse me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe. Kurorëzimi lejohet me arritjen e moshës madhore, nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe. Femra ose mashkulli, nuk mund të ketë më tepër se një kurorëzim në të njëjtën kohë. Martesat e kushtëzuara, të dhunshme dhe në kundërshtim me vullnetin e personave që do të lidhin martesë, dënohen me ligj.<sup>253</sup>

Ligji për Familjen i Kosovës në Nenin 16, përcakton: (1) Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë.

Ligji për Familjen i Kosovës në Nenin 16, përcakton: Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë. Për shkaqë të arsyeshme dhe sipas kërkesës së tij, gjykata kompetente mund t'i lejojë martesën personit të mitur më të vjetër se gjashtëmbëdhjetë vjet, nëse konstaton se personi i tillë ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për të ushtruar të drejtat e veta martesore dhe për të përmbushur detyrimet martesore.

250 Neni 53 (Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve), Ligji për Familjen.

251 Neni 54 (Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes), Ligji për Familjen.

252 Neni 97 (Kufizimet e përgjegjësisë), Ligji për Familjen.

253 Neni 15-LBGJ.

## FAQE 93

Para se të marrë vendimin, gjykata do të kërkojë mendimin e Organit të Kujdestarisë, do ta dëgjojë të miturin dhe prindërit përkatësisht kujdestarin e tij. Gjykata gjithashtu do të dëgjojë personin me të cilin i mituri ka për qëllim të lidhë martesë, mendimin e institucionit përkatës shëndetësor dhe do të hetojë rrethanat tjera të rëndësishme për vendimin.<sup>254</sup>

Ligji për Familjen i Kosovës në Nenin 16, përcakton: Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë.

Ofiqari është i detyruar të lejojë procedurën për lidhjen e martesës nëse nuk ekzistojnë pengesa dhe ndalesa. Ofiqari është i detyruar të refuzojë bashkëpunimin në procedurën e martesës nëse ekziston ndonjë pengesë apo ndalesë. Ofiqari nuk ka të drejtë të refuzojë bashkëpunimin nëse nuk ekzistojnë pengesa apo ndalesa.<sup>255</sup>

Lidhja e martesës fillon me raportin e paraqitur nga ofiqari, duke treguar prezencën e bashkëshortëve të ardhshëm dhe mosekzistimin e pengesave dhe ndalesave martesore të parapara me Ligjin për Familjen. Kjo konstatohet në bazë të dokumenteve të parashtruara dhe deklaratave të bashkëshortëve të ardhshëm, si dhe deklaratave të dëshmitarëve.<sup>256</sup>

Në qoftë se ofiqari konstaton ekzistimin e çfarëdo pengese apo ndalesa martesore, ai i komunikon gojarisht parashtruesve të kërkesës se nuk mund të lidhin martesë dhe harton procesverbalin lidhur me këtë.<sup>257</sup>

Sipas Ligjit për Familjen, Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërish në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes.<sup>258</sup> Lidhja e martesës bëhet në mënyrë solemne në lokalet posaçërisht të caktuara për këtë qëllim. Lidhja e martesës mund të bëhet edhe në lokale tjera, nëse kjo kërkohet nga bashkëshortët e ardhshëm dhe nëse kërkesa e tyre bëhet për shkaqe të arsyeshme.<sup>259</sup>

Për të lidhur martesë është e nevojshme që dy persona të gjinisë së kundërt, në prani të të tjerëve, të shprehin në mënyrë të lirë vullnetin dhe pajtimin e tyre për martesë përpara ofiqarit. Deklarata duhet të jetë e pakushtëzuar dhe e menjëhershme. Palët pjesëmarrëse gjatë lidhjes së martesës janë bashkëshortët, dy dëshmitarë dhe ofiqari. Secili person me aftësi për të vepruar mund të jetë

---

254 Nenin 16, Ligji për Familjen i Kosovës.

255 Neni 29 (Pajtimi i ofiqarit), Ligji për Familjen i Kosovës.

256 Neni 30 (Lidhja e martesës), Ligji për Familjen i Kosovës.

257 Neni 32 (Refuzimi për lidhjen e martesës), Ligji për Familjen i Kosovës.

258 Neni 14. Martesa Ligji për Familjen i Kosovës.

259 Neni 27. (Procedura për lidhjen e martesës- Vendi për lidhjen e martesës) Ligji për Familjen i Kosovës.

dëshmitar gjatë lidhjes së martesës.<sup>260</sup>

Në rast se ofiqari konstaton mosekzistimin e pengesave dhe ndalesave për lidhjen e martesës, ai i njofton bashkëshortët e ardhshëm mbi dispozitat e Ligjit për Familjen, përkitazi me të drejtat dhe detyrimet e tyre edhe gjithashtu ua lexon këto dispozita. Ofiqari duhet t'i pyes bashkëshortët e ardhshëm veç e veç nëse pajtohen të marrohen me njëri-tjetrin. Pasi t'i ketë siguruar deklaratat mbi pajtimin për hyrje në martesë, ofiqari e shpall martesën të lidhur.<sup>261</sup>

Ofiqari e regjistron lidhjen e martesës në Librin amzë të kurorëzuarve dhe i njëjti libër nënshkruhet nga bashkëshortët, dy dëshmitarët dhe ofiqari. Menjëherë pas lidhjes së martesës, bashkëshortëve u lëshohet certifikata nga Libri amzë i të kurorëzuarve.<sup>262</sup>

---

260 Neni 28. Procedura para ofiqarit (nëpunësit të gjendjes civile) Ligji për Familjen i Kosovës.

261 Neni 31. Lidhja e martesës, Ligji për Familjen i Kosovës.

262 Neni 35. Libri amzë i kurorëzimit, Ligji për Familjen i Kosovës.

**REKOMANDIMET**

- Qeveria e Kosovës të raportojë për shkallën e zbatimit të Konventës CEDAW në Kosovë, konform kërkesave të Komitetit të CEDAW në Kombet e Bashkuara.
- Organizatat joqeveritare të cilat merren me të drejtat e grave të përfshihen në përpilimin e raportit nga ana e Qeverisë së Kosovës për shkallën e implementimit të CEDAW.
- Të bëhet koordinimi i bashkëpunimit midis Qeverisë së Kosovës, OJQ-ve që merren me të drejtat e grave dhe Agjensioneve të Kombeve të Bashkuara me qëllim të informimit të grave kosovare për Konventën CEDAW dhe legjislacionin mbi të drejtat e tyre.
- Qeveria e Kosovës ta vazhdojë ngritjen e kapaciteteve me qëllim të funksionalizimit të plotë të mekanizmave institucionalë për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë.
- Qeveria e Kosovës ta sigurojë pjesëmarrjen e grave në procesin e krijimit dhe realizimit të politikave qeveritare.
- Agjensioni për Barazi Gjinore të organizojë trajnime për parlamentarët/et, gjyqësorin, shërbyesit/et civilë/e dhe përfaqësuesit/et e institucioneve të sigurisë për t'u njohur më mirë me Konventën CEDAW.
- Mekanizmat institucionalë për arritjen e barazisë gjinore dhe organizatat joqeveritare ta bëjnë monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe strategjive të hartuara për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave.
- Agjensioni për Barazi Gjinore dhe mekanizmat institucionalë për arritjen e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut, të hartojnë dhe zbatojnë programe dhe strategji afatgjata të cilat do të mund të ndikojnë në ndryshimin e skemave dhe modeleve paragjyquese të sjelljes për rolet e burrave dhe të grave në shoqëri.
- Komisioneri i Pavarur për Media të hartojë politika të ndjeshme në aspektin gjinor dhe të iniciojë trajnime për gazetarët të cilët raportojnë për çështjet gjinore.
- Qeveria e Kosovës të sigurojë përfaqësim më të madh të grave në politikë dhe në strukturat vendimmarrëse në institucionet e Kosovës.

## Arsimi

---

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ta bëjë mbledhjen, sistemimin dhe analizimin në aspektin gjinor të të dhënave të sakta për shkallën e vijueshmërisë dhe arsyet e braktisjes së mësimin nga vajzat në të gjitha nivelet e sistemit arsimor në Kosovë.

MASHT, në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit, ta regjistrojë numrin e saktë të analfabetëve në Kosovë dhe t'i analizojë të dhënat sipas përkatësisë gjinore.

MASHT të përpilojë dhe zbatojë politika dhe programe të veçanta për vajzat nga viset rurale, duke u siguruar atyre bursa për vazhdimin e mësimin të mesëm dhe të lartë.

MASHT të inkuadrojë në planprograme lëndën e Edukatës Seksuale, si lëndë obligative në nivelin e mesëm të ulët të shkollimit.

Organizatata joqeveritare dhe ato profesionale të bëjnë auditim të vazhdueshëm të planprogrameve dhe teksteve shkollore nga perspektiva gjinore, me qëllim të eliminimit të stereotipeve dhe paragjyqimeve për gjinitë dhe rolet gjinore në shoqëri.

MASHT të sigurojë zbatimin e ligjit mbi arsimin e detyrueshëm, duke krijuar mekanizma efektivë me anë të të cilëve do të bëhej realitet zbatimi i sanksioneve për ndërprerjen e shkollimit të fëmijëve, posaçërisht të vajzave.

## Punësimi i grave

---

Legjisllacioni kosovar të harmonizohet me direktivat e Bashkimit Evropian sa i përket ndihmesës së grave në punësim.

Të integrohet perspektiva gjinore në politikat e MPMS, si dhe të aplikohen politikat ekzistuese të cilat e avancojnë pozitën e grave në punësim.

MPMS dhe institucionet tjera përkatëse të organizojnë trajnime për aftësimin profesional të grave në ato fusha profesionale për të cilat ka kërkesë më të madhe në tregun e punës.

Të organizohen fushata informimi nga ana e MPMS për programet dhe mundësitë e punësimit për gratë, me kujdes të veçantë për gratë në viset rurale dhe ato minoritare.

Ministria e Bujqësisë të ofrojë veprime afirmative dhe kushte me të favorshme për gratë në agrobiznes.

MPMS ta sigurojë zbatimin e ligjit të punës dhe ligjin për barazi gjinore, me theks të veçantë në dispozitat të cilat kanë të bëjnë me punësimin e grave pa



## FAQE 97

diskriminim, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Të sigurohet përkujdesja e fëmijëve nën moshën njëvjeçare nga ana e institucioneve përkatëse publike dhe private, ashtu që të rritet mundësia e qasjes së grave në aftësim profesional dhe punësim.

Sindikatat ta bëjnë monitorimin e nivelit të zbatimit të ligjit të punës nga ana e punëdhënësve dhe të punësuarve në bizneset e vogla dhe të mesme, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve.

Të krijohen politika të cilat parashohin që me rastin e lindjes së fëmijës të ketë pushim prindëror edhe për burrat, si dhe të përkrahen burrat për marrjen e më shumë përgjegjësiwe familjare gjatë rritjes së fëmijëve.

Qeveria e Kosovës të zhvillojë programe edukative të cilat në mënyrë të veçantë do t'i përfshijnë gratë në viset rurale dhe gratë të cilat kanë qenë refugjate, në mënyrë që ato të mund ta realizojnë potencialin e tyre ekonomik.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, në bashkëpunim me bankat në Kosovë, t'u mundësojë grave marrjen e kredive të volitshme dhe fillimin e bizneseve të tyre, duke i ndihmuar ato me politika afirmative ekonomike në forma të ndryshme të bashkëkreditimit dhe mikro-kredive me kamata më të ulëta.

Punëdhënësit në sektorin publik dhe atë privat të sigurojnë pushime adekuata dhe të rregullta gjatë orarit të punës, në mënyrë që nënat të cilat punojnë të mund t'i ushqejnë foshnjat e tyre me gji.

Të ndryshohet legjislacioni sa i përket pushimit të lehonisë, nga 12 javë në minimum 6 muaj.

## Shëndeti i grave

---

Ministria e Shëndetësisë të zhvillojë politika dhe strategji që kanë të bëjnë me përmirësimin e kujdesit të shëndetit të grave.

Parlamenti i Kosovës ta përshpejtojë aprovimin e ligjit të ri që ka të bëjë me çështjen e ndërprerjes së shtatzënisë.

Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet relevante ta krijojnë një sistem të qëndrueshëm dhe të besueshëm të mbledhjes së të dhënave për numrin e saktë të shkaqeve të abortit në institucionet shëndetësore publike dhe private.

Institucionet shëndetësore dhe OJQ-të të organizojnë fushata vetëdijesimi dhe informimi për kujdesin shëndetësor të grave dhe vajzave për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë.

Ministria e Shëndetësisë të krijojë infrastrukturë shëndetësore për trajtimin e kancerit të gjirit (funktionalizimi i Institutit Onkologjik).

Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet përgjegjëse ta adresojnë urgjentisht çështjen e mungesës së të dhënave statistikore lidhur me numrin e rasteve me kancer të gjirit në Kosovë.

Institucionet shëndetësore dhe OJQ-të të organizojnë fushata të vetëdijesimit për HIV/AIDS-in dhe mënyrat e infektimit me virusin HIV, si dhe për rëndësinë e testimit vullnetar për HIV/AIDS.

## Trafikimi

---

Mekanizmat institucionalë, në bashkëpunim me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, të kenë rol më aktiv në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Të zbatohet Plani i Veprimit Kundër Trafikimit me qenie njerëzore.

Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, në bashkëpunim me mekanizmat tjerë institucionalë, të zhvillojë programe që kanë për qëllim rehabilitimin dhe reintegrimin e grave dhe vajzave të cilat kanë qenë viktime të trafikimit.

Të përmirësohet bashkëpunimi dhe koordinimi në mes të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore në adresimin e çështjes së trafikimit të qenieve njerëzore.

Qeveria e Kosovës të nxitë bashkëpunimin rajonal në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

## Dhuna në familje dhe dhuna ndaj gruas

---

Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me OJQ-të, ta hartojë Planin Kombëtar të Veprimit për Luftimin e Dhunës Ndaj Grave.

Qeveria e Kosovës ta krijojë një sistem financiar që do ta bënte kompensimin e dëmeve të cilat iu shkaktohen grave si pasojë e dhunës në familje.

Agjensioni për Barazi Gjinore dhe mekanizmat tjerë institucionalë të hartojnë programe për trajtimin e kundërvajtësve.

Strehimoret e viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore të kenë mbështetje të rregullt financiare nga ana e institucioneve qeveritare.

Agjensioni për Barazi Gjinore ta monitorojë zbatimin e rregullores 2003/12 mbi dhunën në familje.

Agjensioni për Barazi Gjinore dhe mekanizmat tjerë institucionalë për arritjen e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut, në bashkëpunim me OJQ-të, të organizojnë fushata vetëdijesimi dhe informimi për Rregulloren 2003/12 mbi dhunën në familje.

## **E drejta në trashëgimi**

---

Ministria e Drejtësisë, Agjensioni për Barazi Gjinore dhe mekanizmat tjerë institucionalë për arritjen e barazisë gjinore dhe drejtat e njeriut, ta monitorojnë zbatimin e ligjit të trashëgimisë.

OJQ-të, në bashkëpunim me mekanizmat institucionalë për arritjen e barazisë gjinore, të iniciojnë fushata vetëdijesimi dhe informimi për të drejtat e grave në trashëgimi.

Agjensioni për Barazi Gjinore dhe OJQ-të e grave të organizojnë trajnime për gjykatësit/et me qëllim të rritjes së ndjeshmërisë ndaj rasteve të cilat kanë të bëjnë me çështjet gjinore.

Ministria e Drejtësisë t'i mbështesë organizatat profesionale në zhvillimin e studimeve dhe hulumtimeve të cilat do ta pasqyronin gjendjen reale të shkallës së realizimit të së drejtës së grave në trashëgimi.

## **Pakicat**

---

Ministria e Kthimit dhe e Komuniteteve ta monitorojë zbatimin e ligjeve dhe strategjive ekzistuese që kanë të bëjnë me përmirësimin e pozitës së grave të komuniteteve pakicë që jetojnë në Kosovë.

Agjensioni për Barazi Gjinore të ndërmarrë fushata informuese në lidhje me moshën e lejuar me ligj për martesë.

Qeveria e Kosovës t'i përkrahë organizatat joqeveritare të grave nga komuniteti serb, RAE, boshnjak, turk, etj., në përpjekjet e tyre për adresimin e problemeve të grave dhe vajzave të këtyre komuniteteve.

Të rritet bashkëpunimi dhe koordinimi i OJQ-ve të grave RAE dhe institucioneve qeveritare në trajtimin e problemeve me të cilat ballafaqohen gratë dhe vajzat e këtij komuniteti.

MASHT të mbështesë institucionet hulumtuese që të zhvillojnë studime dhe hulumtime të cilat do t'i identifikojnë shkaqet e mosvijimit të shkollimit nga ana e vajzave të reja të komunitetit RAE në Kosovë.

MASHT të monitorojë zbatimin e strategjisë afatgjate e cila e adreson çështjen e arsimimit të komunitetit RAE, në veçanti të vajzave.

## **Sporti**

---

Ministra e Kulturës dhe e Sportit të krijojë politika të cilat mundësojnë qasje dhe mundësi të barabarta të grave në aktivitetet kulturore dhe sportive.

## LEGJISLACIONI I KONSULTUAR

1. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/9 (15 maj 2001) për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë;
2. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/18 (7 qershor 2004) mbi shpalljen e Ligji për barazi gjinore në Kosovë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/2 për barazi gjinore. (LBGJ);
3. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/32 (20 gusht 2004) mbi shpalljen e Ligji kundër diskriminimit, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/3 kundër diskriminimit. (LKD);
4. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/45 (11 gusht 2000) mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës.
5. Rregullore e UNMIK-ut nr.2000/54 (27 shtator 2000) ndryshim i Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/1,të ndryshuar mbi autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë;
6. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2006/6 (16 shkurt 2006) mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë;
7. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2006/48, (24 gusht 2006) Për shpalljen e Ligji mbi lirinë e fesë në Kosovë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-31 mbi lirinë e fesë në Kosovë. (Ligji mbi lirinë e fesë);
8. Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2003/12 mbrojtja kundër dhunës në familje;
9. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/25 (6 korrik 2003), Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës;
10. Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë;
11. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/39, 8 korrik 2000, mbi zgjedhjet komunale në Kosovë.
12. Rregullore e UNMIK-ut NR. 1999/22 (15 nëntor 1999) për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare ne Kosovë.
13. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil.
14. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2000/18 (29 mars 2000) Për Dokumentet e Udhëtimit
15. Rregullore e UNMIK -ut nr. 2005/15 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë.
16. Urdhëresa Administrative Nr. 2003/2 Zbatim i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës
17. Rregullore nr. 2006/33 për shpalljen e Ligji mbi Procedurën Administrative të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
18. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/31, 20 gusht 2004, Për shpalljen e Ligji për shëndetësi në Kosovë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/4 për shëndetësi. (Ligji për shëndetësi).
19. Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2007/11, 7 shkurt 2007, për shpalljen e

- Ligji mbi shëndetin riprodhues të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 02/L-76 Mbi Shëndetin Riprodhues. (Ligji Mbi Shëndetin Riprodhues)
20. Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës
  21. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2001/27 - 8 tetor 2001 për Ligjin themelor të punës në Kosovë.
  22. Rregullore e UNMIK -ut nr. 2005/46 (14 tetor 2005) Për shpalljen e Ligji mbi shërbimet sociale dhe familjare të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare.
  23. Rregullore e UNMIK -ut nr.2004/47 (19 nëntor 2004) për shpalljen e Ligji mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror.
  24. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2005/20 (29 prill 2005) për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë,
  25. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/33 (6 nëntor 2003) Për shpalljen e Ligji të miratuar nga Kuvendi i Kosovës lidhur me Ligjin mbi sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës.
  26. Rregullore e UNMIK -ut nr.2004/47 për shpalljen e Ligji mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës në sistemin e kujdesit shoqëror të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
  27. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2007/7 (31 janar 2007) Mbi shpalljen e Ligji për inkurajimin dhe mbrojtjen e të ushqyerit të fëmijëve me qumësht gjiri të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-81 për inkurajimin dhe mbrojtjen e të ushqyerit të fëmijëve me qumësht gjiri.
  28. Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve "Gazeta zyrtare e RSFJ", nr. 29/78 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra g.z. nr. 39/85, 45/89, 57/89 dhe 31/93.
  29. Rregullore UNMIK-ut nr. 2002/2120 dhjetor 2002 për shpalljen e Ligji mbi hipotekat të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
  30. Rregullore e UNMIK-ut nr. 2004/26 (28 korrik 2004) mbi shpalljen e Ligji për sportin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
  31. Neni 2 (Qëllimi i Ligji) Rregullore e UNMIK -ut nr. 2006/44 (18 gusht 2006) Mbi shpalljen e Ligji për institucionet e kulturës të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-57 për institucionet e kulturës.
  32. Rregullore e UNMIK -ut nr. 2005/15 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë;
  33. Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/8 (6 prill 2001) për themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës.
  34. Rregullore UNMIK-ut nr. 2006/30 (2 maj 2006) Mbi shpalljen e Ligji për provimin e judikaturës i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-40 për provimin e judikaturës.
  35. Ligji për Familjen i Kosovës (Ligji Nr. 2004/32)- Gazeta Zyrtare e

Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë / Prishtinë:  
VITI I / NR. 4 / 1 SHTATOR 2006, (Më 16 shkurt 2006, UNMIK/  
REG/2006/7)

36. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2003/2 (25 janar 2003) zbatim i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.
37. Urdhëresa administrative Nr. 2005/3 (11 shkurt 2005) për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë,
38. Udhëzimi Administrativ Nr.MSHP/DAShC 2003/10 , datë 20.05.2003 Procedura e Pushimeve
39. Udhëzim Administrativ Nr.MSHP/DAShC 2003/12, (12.09.2003) Procedurat e Mundësive të Barabarta.
40. Udhëzim Administrativ nr. 2007/03-MSHP masat për arritjen e barazisë gjinore në institucionet e administratës publike gjatë vitit 2007.
41. Raporti i Progresit të Kosovës (nën RKSKB-së 1244) për vitin 2005 Komisioni Evropian-Bruksel, 9 nëntor 2005, SEC (2005) 1423, fq..21 ).
42. Plani i Veprimit Gjithëpërfshirës për Zbatimin e Ligji kundër diskriminimit. Qeveria e Kosovës, tetor 2005.
43. Plani kombëtar I veprimit për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, Qeveria e Kosovës, Prishtinë, 2004.
44. Kontrata e Përgjithshme Kolektive në Kosovë.
45. Projektligji për Shtetësinë e Kosovës (qershor 2007).

**LISTA E TË INTERVISTUARVE**

---

- Visare Gashi - Gorani - Shefe e Agjencionit për Barazi Gjinore, 7 qershor 2007.
- Flora Macula - Drejtore e programit të UNIFEM-it në Kosovë, 12 shtator 2007.
- Claire Hutchenson - Zyrtare për çështje gjinore në UNMIK, 19 qershor 2007.
- Ariana Qosja - Këshilltare Ligjore Nacionale për Gratë dhe Fëmijët dhe pjesë e Njësitit kundër Trafikimit në OSBE, 26 qershor 2007.
- Frode Muring - përfaqësues i Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 22 qershor 2007.
- Tahire Haxholli - Zyrtare për Dhunë në Familje në Shërbimin Policor të Kosovës, 3 korrik 2007.
- Adile Basha - Udhëheqëse e Sektorit për Mbrojtjen e Familjes, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 11 korrik 2007.
- Cyme Mahmutaj - Zyrtare e lartë për Mundësi të Barabarta dhe Barazi Gjinore - zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit, 20 shtator 2007.
- Behxhet Shala - Drejtor Ekzekutiv i KLMDNJ-së, 16 korrik 2007.
- Violeta Krasniqi - Zyrtare për barazi gjinore në kuadër të zyrës së Ombudspersonit, 26 qershor 2007.
- Virgjina Dumnica - Zyra e UNDP-së në Kosovë, 22 qershor 2007.
- Igbalte Rogova - Drejtore ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës 18 shtator 2007.
- Afërdita Jaha - Zyrtare për edukim joformal në Zyrën Rajonale të Arsimit në Prishtinë, 6 qershor 2007.
- Teuta Hadri - Gjinekologe, 4 shtator 2007.

**Takimi me grupin e ekspertëve**

---

- Valbona Salihu - Drejtore Ekzekutive e OJQ-së Norma.
- Flora Macula - Drejtore e programit të UNIFEM-it në Kosovë.
- Nazmie Krasniqi - Koordinatorë e të drejtave të njeriut në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Behxhet Shala - Drejtor Ekzekutiv i KLMDNJ-së.
- Fatmire Mulhaxha - Shefe e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie.
- Luljeta Vuniqi - Drejtore Ekzekutive, Qendra Kosovare për Studime Gjinore.
- Medi Geci - Agjensioni për Barazi Gjinore.
- Besim Kajtazi - Ekspert ligjor për çështje gjinore.

